




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Raporti Vjetor i Monitorimit Menaxhimi i Financave Publike 2025



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i monitorimit

Ky raport vjetor i monitorimit mbi zbatimin e reformave në Menaxhimin e Financave Publike mbulon periudhën nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025. Ai përshkruan ecurinë e aktiviteteve të planifikuara dhe arritjet kundrejt treguesve të performancës dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e re sektoriale të MFP-së për vitet 2023-2030 dhe planin e veprimit për vitet 2023-2026. Strategjia sektoriale e MFP-së është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), Udhërrëfyesin e Reformës së Administratës Publike, Programin e Reformave Ekonomike dhe axhendën më të gjerë të Integritimit Evropian. Strategjia dhe plani i veprimit u miratuan zyrtarisht me VKM 390, datë 12 qershor 2024, për “Miratimin e Strategjisë Sektoriale të MFP-së 2023-2030”.

Strategjitë nënsektoriale

Gjatë periudhës raportuese, plani i veprimit të MFP-së u zbatua krahas disa strategjive nënsektoriale, duke përfshirë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare, Strategjinë e Prokurimit, Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).


Bashkëpunimi me partnerët e zhvillimit


Qeveria vazhdoi bashkëpunimin produktiv me partnerët e zhvillimit për zbatimin e strategjisë. Kjo përfshinte vlerësime të rregullta për të vlerësuar gjendjen e politikave dhe sistemeve të MFP-së, të tilla si konsultimet e Nenit 4 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe përgatitja e një Vlerësimi të Performancës lidhur me Llogaridhënien për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA) me BE-në, si dhe një vlerësim mbi Parimet e Administratës Publike me SIGMA-n. Mbështetjet e shumta në formën e Asistencës Teknike dhe Projekteve ndihmëse të financuara nga partnerët e zhvillimit vazhdojnë të përmirësojnë sistemet e MFP-së, me partnerë kryesorë FMN, Bankën Botërore, BE, SIGMA dhe SECO.

Ecuria e përgjithshme

Plani i veprimit të MFP-së për vitin 2025 përfshin 69 tregues të performancës dhe 133 aktivitete të shpërndara në gjashtë shtylla. **Zbatimi i planit të veprimit është në rrugën e duhur**, me 92 nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2025 të përfunduara ose duke përparuar sipas parashikimeve, dhe shumica e objektivave të treguesve të performancës janë arritur, siç paraqitet në grafikët e mëposhtëm.

Grafiku 1. Statusi i objektivave të treguesve të performancës



Grafiku 2. Statusi i aktiviteteve


Zhvillimet kryesore të shtyllave

Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut

Ministria e Financave (MF) ka ruajtur dhe ka përmirësuar sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të shëndosha fiskale, të udhëhequra nga rregullat fiskale, parashikimet e forta makroekonomike dhe menaxhimi solid i risqeve fiskale. Pajtueshmëria me rregullat fiskale është raportuar në mënyrë transparente në dokumentet kryesore, përfshirë “Kadri Makroekonomik dhe Fiskal”, “Programin e Reformave Ekonomike” dhe “Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale”. Rregullat fiskale për parashikimin e PBB-së nominale dhe balancën primare janë zbatuar plotësisht. Ekipit iu vu në dispozicion një model të dhënash për prezantimin e një kuadri bazë të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit, për t’u plotësuar si hap përgatitor. Gjatë vitit 2025 u finalizua përgatitja e Deklaratës së Risqeve Fiskale për vitin fiskal 2024. Dokumenti i finalizuar, i miratuar nga Ministri i Financave, i është dorëzuar zyrtarisht Këshillit të Ministrave dhe është publikuar në faqen e internetit të MF-së. Përveç kësaj, është përgatitur një dokument teknik me opsione për krijimin e një Këshilli Fiskal.

Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent

Përputhshmëria e dokumenteve të reja strategjike me Udhëzimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) është përmirësuar ndjeshëm. Sipas vlerësimit të Indeksit të Buxhetit të Hapur (OBI) për vitin 2023, Shqipëria ka marrë 9/100 pikë për Pjesëmarrjen Publike dhe 57/100 pikë për Transparencën, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021. Metodologjia për kryerjen e analizës së shpenzimeve sipas sektorëve është përgatitur dhe do t’i paraqitet Ministrit për miratim. Metodologjitë për buxhetimin e gjelbër dhe analizën e hendeut gjinor janë pilotuar. Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP) janë zbatuar në mënyrë efektive, duke reflektuar progres në forcimin e praktikave të menaxhimit të investimeve publike. Në vitin 2025, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 887, datë 27 dhjetor 2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, u ndryshua më tej me VKM nr. 180, datë 20 mars 2025, me qëllim forcimin dhe disiplinimin e mëtejshëm të Procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike. Kuadri ligjor i përcaktuar me VKM nr. 887 u plotësua më tej përmes nxjerrjes së Udhëzimit nr. 11 të Ministrit të Financave, datë 28 maj 2025, “Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit”. Gjithashtu, u miratua Udhëzimi nr. 22, datë 15 shtator 2025, “Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit”, duke forcuar kështu rolin “gatekeeper” të Ministrisë së

Financave dhe duke rritur kapacitetin e saj mbikëqyrës mbi proceset e investimeve publike. Nxjerrja e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC nr. 446, datë 23.12.2025, “Për miratimin e formës, afatit dhe mënyrës së plotësimit të formularit të përditësimit të ecurisë së projekteve të investimit që janë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare”, e plotëson më tej kuadrin ligjor dhe procedural.

Formula për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026 u përditësua duke përdorur të dhënat e reja të Censurit. Skema e Grantit të Bazuar në Performancë u zbatua. 100% e bashkive përdorën software-in e ri SMBV. Në vitin 2025, sistemi i ri online është plotësisht funksional dhe është prezantuar në të gjitha bashkitë. Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit Faktik për Qytetarët për vitin 2024 është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave¹. Sa i përket treguesit “Numri i kontratave të PPP-ve të përfshira në raportin vjetor të përmbledhur mbi PPP-të dhe kontratat koncesionare”, për vitin 2024, Raporti Përmbledhës Vjetor përmban 199 kontrata koncesionare.

Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave

Gjatë vitit 2025, zbatimi i Shtyllës 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave” shënoi progres të qëndrueshëm dhe rezultate që tejkaluan pritshmëritë, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave. Objektivi për rritjen e të ardhurave u tejkalua, duke arritur në 0.76% të PBB-së (duke përfshirë administratën tatimore dhe doganore), krahasuar me nivelin e planifikuar prej 0.62%. Kjo performancë e fortë u nxit kryesisht nga rritja e të ardhurave të brendshme nga TVSH-ja dhe nga kontributet më të larta të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si rezultat i iniciativave të suksesshme që synojnë uljen e hendekut të pajtueshmërisë së TVSH-së dhe frenimin e punësimit të padeklaruar dhe të nënraportuar. Në të njëjtën kohë, shumica e treguesve të performancës u arritën ose u tejkaluan, përfshirë zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, rritjen e numrit të deklaruesve të TVSH-së në sektorë kyç si turizmi, si dhe të ardhura më të larta nga pagat dhe kontributet shoqërore. Reformat strukturore dhe masat e planifikuara ecën në mënyrë të kënaqshme, me disa angazhime kryesore të realizuara në kohë, përfshirë forcimin e kapaciteteve institucionale për analizën dhe zhvillimin e politikave fiskale, përdorimin e zgjeruar të të dhënave nga palë të treta në hetimin e aseteve të pajustificuara, si dhe zbatimin e planit të integritetit brenda administratës tatimore. Paralelisht, u vu re një përshpejtim i reformave përmes përfundimit të parakohshëm të disa masave, si paraplotësimi i deklaratave tatimore, rritja e hetimeve për mashtrim tatimor dhe avancimi i auditimeve të bazuara në risk. Në përgjithësi, performanca e kësaj shtylle në vitin 2025 dëshmon për forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e eficiencës në mbledhjen e të ardhurave dhe progres të prekshëm në modernizimin dhe transparencën e sistemit fiskal.

Përdorimi i kanalit të gjelbër u rrit nga 30.73% në vitin 2024 në 33% në vitin 2025. Numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar u rrit nga 16 në vitin 2024 në 18 në vitin 2025. Projektligji “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” parashikohet t’i paraqitet për shqyrtim Këshillit të Ministrave brenda muajit qershor 2026. Pas miratimit të projektligjit nga Kuvendi dhe hyrjes në fuqi, puna do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve përkatëse nënligjore.

Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit

Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit ka shënuar përmirësim të ndjeshëm, ku shumica e objektivave të treguesve të performancës (TP) të planifikuar për vitin 2025 janë arritur. *Progresi në Statistikat Financiare të Qeverisë* (SFQ) dhe në raportimin EDP ishte i dukshëm, me përmirësim të cilësisë së të dhënave, zgjerim të mbulimit dhe transmetim në kohë të tabelave të përafruara me SELL 2010. Për herë të parë, në tetor 2025, seritë kohore 2021–2024 u transmetuan me statusin “të autorizuar

¹ <https://financa.gov.al/buxheti-faktik-per-qytetaret/>

për publikim”. INSTAT avancoi punën për mbledhjen e të dhënave për PPP-të dhe koncesionet, bazuar në të dhënat e ATRAKO-s dhe burime të tjera, ndonëse përfshirja e plotë pritet pas përfundimit të vlerësimeve metodologjike. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në hartimin e Ligjit të ri për Kontabilitetin e Sektorit Publik dhe të metodologjisë së kontabilitetit të bazuar në SNKSP, të përgatitur me mbështetjen e Bankës Botërore, duke shënuar një moment kyç drejt kalimit të Shqipërisë në kontabilitetin mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve vijuan, përfshirë trajnimet e zhvilluara për kontabilistët e sektorit publik, audituesit e brendshëm dhe punonjësit e administratës publike, duke siguruar gatishmërinë për reformën e ardhshme të kontabilitetit. Në menaxhimin e borxhit, u përgatitën dhe u publikuan Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2026 dhe Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, duke rritur transparencën dhe komunikimin me palët e interesuara. Ministria e Financave avancoi gjithashtu kuadrin analitik për garancitë dhe nën-huadhënien përmes aplikimit të Modelit të Vlerësimit të Riskut të Kredisë, të zhvilluar nga Banka Botërore. Përgatitjet për instrumente të mundshme financimi të gjelbër, social ose të qëndrueshmërisë vijuan, ndonëse instrumentet alternative mbeten jashtë prioritetëve të strategjisë së borxhit për periudhën 2026–2030. Praktikrat e menaxhimit të likuiditetit vijuan të forcohen. Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit arriti në 94%, e mbështetur nga një klasifikim më i detajuar i hyrjeve dhe daljeve dhe nga zbatimi i mjeteve të parashikimit të mbështetura nga FMN-ja. Krijimi i Grupit Teknik për Parashikimin e Flukseve të Likuiditetit (GTPFL) përmirësoi koordinimin institucional. Shpërblimi ditor i gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (LIUTH) pranë Bankës së Shqipërisë dhe rritja e tavanit të depozitave në lekë nga 15 miliardë lekë në 30 miliardë lekë përmirësuan më tej menaxhimin e likuiditetit. Politika e rezervës së likuiditetit u rishikua për të prezantuar si rezervat transaksionale, ashtu edhe ato të sigurisë, në përputhje me praktikrat e mira ndërkombëtare. Në prokurimin publik, progresi vijoi drejt zbatimit të prokurimit të gjelbër dhe të qëndrueshëm. Një draft manual teknik mbi Koston e Ciklit të Jetës (KCJ) u përgatit me mbështetjen e Bankës Botërore dhe do të shërbejë për ofrimin e mbështetjes praktike si për autoritetet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të theksohet se gjatë vitit 2025 u konstatua se, në përgjithësi, metodologjia MEAT (kriteret e vlerësimit të bazuara në kosto) u përdor nga autoritete të ndryshme kontraktore edhe në procedurat e llojit “Punë” dhe “Shërbime”. Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) avancoi Prokurimin Publik të Gjelbër përmes miratimit të Planit të Veprimit për Prokurimin e Qëndrueshëm dhe Ekonominë Qarkulluese, duke integruar kriteret mjedisore dhe shoqërore në procedurat e prokurimit, në përputhje me standardet e BE-së. Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik përparoi nismat e digjitalizimit lidhur me përmirësimet e sistemit elektronik të ankesave dhe zhvillimin e një arkivi digjital.

Në vitin 2025, Shqipëria hartoi dhe miratoi Ligjin nr. 88/2025 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit të saj ligjor për PPP-të me standardet e BE-së dhe forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës në menaxhimin e PPP-ve. Edhe reforma e menaxhimit të aseteve avancoi, e mbështetur nga faza e dytë e projektit SNKSP. Puna përparoi në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe metodologjik për vlerësimin, regjistrimin dhe raportimin e aseteve publike, ndërkohë që vijoi migrimi i aktiveve të qëndrueshme në SIFQ. Një regjistër i konsoliduar i aseteve në nivel njësie kontrolluese është në përgatitje dhe do të bëhet funksional pas miratimit të plotë të kuadrit SNKSP.

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Gjatë vitit 2025, u shënuar progres i rëndësishëm në forcimin e kuadrit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP), me arritje të dukshme në Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), Auditimin e Brendshëm, Inspektimin Financiar Publik dhe Shërbimeve të Koordinimit Kundër Mashtrimit, si dhe Menaxhimin të Fondeve të BE-së. Megjithatë disa të dhëna për treguesit e

performancës të MFK-së nuk ishin të disponueshme në momentin e raportimit, u arritën përparime të konsiderueshme në përmirësimin e kuadrit rregullator.

Një arritje e rëndësishme ishte rishikimi dhe miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njërive të Qeverisjes së Përgjithshme, përmes Urdhrit nr. 49/1 (21 tetor 2025). Kjo metodologji prezanton tregues të strukturuar të performancës, standardizon procesin e vlerësimit dhe rrit llogaridhënien dhe konsistencën në vlerësimin e kontroleve të brendshme në të gjitha institucionet. Zbatimi i përgjegjshmërisë menaxheriale avancoi përmes mbështetjes të shënjestruar për 20 institucione të përzgjedhura, me fokus të shtuar te delegimi i detyrave si një parim thelbësor i MFK-së. Praktikatat e menaxhimit të riskut u përmirësuan përmes sesioneve të shumta të trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me ASPA-n dhe partnerë të tjerë. Përpos kësaj, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe rritjen e kapaciteteve u intensifikuan, përfshirë trajnime të përshtatura për institucione të përzgjedhura dhe programe trajnimi në shkallë të gjerë mbi MFK-në, menaxhimin e riskut dhe delegimin e detyrave. Ministria e Financave vijoi të mbështesë profesionalizimin e praktikave bazë të auditimit të brendshëm, përmes hartimit të udhëzimeve dhe zhvillimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Gjithsej, u finalizuan 155 raporte vjetore të auditimit të brendshëm, nga të cilat 135 institucione kanë njësi funksionale të auditimit të brendshëm dhe 20 institucione iu nënshtruan ciklit të dytë të vlerësimit. Qeverisja e auditimit u përmirësua me krijimin e 10 Komiteteve funksionale të Auditimit në 2025. Ngritja e kapaciteteve mbeti një arritje parësore, me 100% të audituesve të brendshëm që përmbushën kërkesat për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional dhe morën pjesë në më shumë se 40 orë trajnimi. DHAB, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, zhvilloi trajnime të specializuara mbi tema që përfshijnë Trajnimin e Trajnerëve (TT), raportimin financiar të ndërmarrjeve shtetërore, auditimin në praktikë, si dhe auditimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në qeverisjen vendore. Gjithashtu, u miratua Manuali i ri i Auditimit të Brendshëm (Urdhri nr. 134, datë 17 tetor 2025) plotësisht i përafëruar me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe i hartuar me ekspertizën e SIGMA. Ky manual ofron një kuadër metodologjik të unifikuar dhe forcon harmonizimin ndërmjet njërive të auditimit të brendshëm. Sa i përket Inspektimit Financiar Publik dhe Shërbimeve të Koordinimit Kundër Mashtrimit, një arritje e rëndësishme ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit (VKM nr. 275, datë 9 maj 2025). Krijimi i Komitetit Drejtues të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit (Urdhri nr. 89, datë 30 qershor 2025), siguroi koordinim të nivelit të lartë për zbatimin. Gjatë vitit 2025, grupet teknike të punës u mbledhën për të operacionalizuar instrumentet e monitorimit, për të përgatitur planet e punës dhe për të nisur raportimin mbi zbatimin e masave kundër mashtrimit. U zhvilluan me sukses mbledhjet e para të Komitetit Drejtues dhe të Grupit Teknik të Punës, ndërkohë që hartimi i Raportit të parë të Monitorimit të SKKM është në proces.

Lidhur me Menaxhimin e Fondeve të BE-së, një arritje e rëndësishme ishte ratifikimi i Marrëveshjeve të Financimit për tre Programe Operacionale shumëvjeçare të IPA III për periudhën 2024–2027, me një vlerë totale prej 182 milionë euro. Një mision auditimi pasues nga DG NEAR u zhvillua në qershor 2025, ndërsa raporti përfundimtar u publikua në korrik 2025. Ngritja e kapaciteteve për strukturat IPA avancoi ndjeshëm. U përfundua një Vlerësim gjithëpërfshirës i Nevojave për Trajnim, i cili çoi në miratimin e një Plani të Konsoliduar Trajnimi për periudhën 2025–2026. U zhvilluan trembëdhjetë sesione trajnimi shumëdisiplinore dhe disa seminare tematike, që mbuluan prokurimin, menaxhimin e riskut, procedurat PRAG, menaxhimin e parregullsive dhe treguesit kryesorë të performancës.

Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme

Kontrolli i Lartë i Shtetit po punon në mënyrë aktive drejt përmbushjes së prioritetëve të tij strategjike, siç përcaktohen në Strategjinë e tij të Zhvillimit për periudhën 2023–2027, duke forcuar rolin e tij si një mbështetës kyç i Kuvendit në promovimin e llogaridhënies efektive dhe shqyrtimit të plotë të përdoruesve të fondeve publike, si dhe duke rritur ndikimin e punës së tij audituese në mirëqeverisje

përmes përmirësimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Gjatë vitit 2025, KLSH-ja zgjeroi planin e saj vjetor të auditimit përmes Vendimit nr. 218 (15.11.2024), duke rritur numrin dhe shumëllojshmërinë e auditimeve dhe duke forcuar angazhimin e saj strategjik për rritjen e llogaridhënies institucionale. U arrit progres i rëndësishëm në forcimin e shqyrtimit parlamentar dhe të efektivitetit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Pas krijimit të Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin Publik në korrik 2024, gjatë vitit 2025 u zhvilluan dy seanca dëgjimore, ku u shqyrtua zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë e saj vendore. KLSH gjithashtu i dërgoi Kuvendit dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin raporte përmbledhëse të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve. Ecuria në profesionalizimin e praktikave të auditimit vijoi me institucionalizimin e plotë të metodologjisë së auditimit të PPP-ve dhe koncesioneve. Pas miratimit të saj në dhjetor 2024, KLSH zhvilloi sesione të specializuara trajnimit në korrik dhe shtator 2025, duke siguruar që rreth 48 auditues të jenë tashmë në gjendje ta zbatojnë metodologjinë në mënyrë konsistente në angazhimet audituese. Po ashtu, treguesi për përdorimin e Teknikave të Auditimit të Asistuar nga Kompjuteri (TAAK) u arrit me sukses. Më shumë se 100 auditues përfituan nga sesionet e trajnimit online mbi analizën e të dhënave masive dhe sigurinë e informacionit. Aktivitetet e vlerësimit me SIGMA-n përparuan gjatë vitit 2025, ku KLSH paraqiti komente formale mbi draft raportin, duke kontribuar kështu në përmirësimin e procedurave të auditimit, standardeve të dokumentimit dhe praktikave të sigurimit të cilësisë. Mekanizmat e komunikimit dhe raportimit u përmirësuan më tej në përputhje me strategjinë e komunikimit të KLSH-së, duke rezultuar në një monitorim më të strukturuar të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve. Komisioni Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Punësimin hartoi Planin e Zhvillimit përmes një procesi të strukturuar konsultimi me IDK-në, i cili u miratua formalisht në dhjetor 2025. Gjithashtu, Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik u rikrijua pas riorganizimit parlamentar të vitit 2025, duke shënuar një hap konkret në zbatimin e aktiviteteve prioritare të Planit.

Menaxhimi i riskut

Risqe të shumta që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e planit të veprimit janë materializuar, përfshirë vonesat në ndryshimet ligjore dhe rregullatore, parashikimet e pamjaftueshme financiare, disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore të kualifikuara, zhvillimin jo të qëndrueshëm të kapaciteteve, sfidat në zhvillimin e TI-së dhe në prokurim, aksesin e kufizuar dhe jo në kohë në asistencë teknike, si dhe koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet palëve të interesuara. Masat e ndërmarra dhe të planifikuara për t'iu përgjigjur këtyre risqeve përfshijnë rishpërndarje të brendshme afatshkurtra të stafit për të siguruar mbulimin e funksioneve thelbësore analitike dhe koordinuese; zhvillimin e vazhdueshëm të trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit; përgatitjen dhe publikimin e manualeve që shpjegojnë dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore; si dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional. Detyrat u rishpërndanë përkohësisht dhe produktet kritike u prioritetizuan për të zbutur ndikimin e boshllëqeve në staf, ndërkohë që stafi ekzistues mori përsipër përgjegjësi shtesë për të mbuluar pozicionet vakante.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË 2023-2030	9
1.1 HYRJE	9
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT	9
1.3 VIZIBILITETI DHE KONSULTIMET E MFP-SË	10
2. ECURIA E STRATEGJISË NË 2025.....	10
2.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E SHTYLLAVE TË STRATEGJISË MFP PËR 2025.....	10
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË MFP-SË NË PËRPUTHJE ME AXHENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	12
2.3 NDIKIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT NË RAJON DHE/OSE MË GJERË	15
2.4 AKTIVITETET E SHTYLLAVE QË NUK PËRPARUAN SIPAS PLANIT	16
2.5 ZBATIMI I BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM	17
3 PROGRESI NË ZBATIMIN E SHTYLLAVE TË STRATEGJISË SË MFP-SË	17
3.1 PROGRESI NË SHTYLLËN 1 “PROGRAMIMI MAKROEKONOMIK DHE MONITORIMI I RISKUT”	17
3.2 PROGRESI NË SHTYLLËN 2 “PLANIFIKIMI I INTEGRUAR STRATEGJIK DHE BUXHETOR, MONITORIMI DHE RAPORTIMI TRANSPARENT”	22
3.3 PROGRESI NË SHTYLLËN 3 “MENAXHIMI DHE MOBILIZIMI I TË ARDHURAVE”	33
3.4 PROGRESI NË SHTYLLËN 4 “KONTABILITETI DHE MENAXHIMI I ZBATIMIT TË BUXHETIT”	39
3.5 PROGRESI NË SHTYLLËN 5 “KONTROLLI I BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK”	51
3.6 PROGRESI NË SHTYLLËN 6 “MBIKËQYRJA E JASHTME”	59
4 RISQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE	63
5 KOSTOJA E STRATEGJISË TË MFP-SË	68
6 PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	69
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	71
ANEKS 1: STATUSI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË MFP	73

1 Vështrim i përgjithshëm i zbatimit të Strategjisë 2023-2030

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i njëmbëdhjetë Vjetor i Monitorimit për Zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), i cili mbulon periudhën nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025. Ai përfshin një tjetër vit përpjekjesh reformash dhe u ofron informacion të detajuar Komitetit Drejtues dhe Komitetit Teknik të MFP-së mbi progresin e arritur dhe sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave dhe masave të Strategjisë.

Ky raport paraqet një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë në fushën e MFP-së në mënyrë që Bashkimi Evropian (BE) të ofrojë mbështetje buxhetore për Shqipërinë, si dhe për Axhendën e Reformave. Kriteri i pranueshmërisë për MFP-në kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe relevant për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e këtij programi. Sipas vetëvlerësimit tonë, progresi në fushën e MFP-së ka qenë i kënaqshëm, me 78.26% të objektivave të Treguesve të Performancës të arritura dhe pjesërisht të arritura, si dhe me 69.17% të aktiviteteve të përfunduara plotësisht dhe në rrugën e duhur.

Qeveria e Shqipërisë (QSh) ka shënuar progres të mirë në zbatimin e Strategjisë të Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Zhvillimet për secilën shtyllë përshkruhen në seksionet e mëposhtme.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Drejtoria e Strategjive të Financave Publike dhe Mbështetjes Buxhetore udhëheq procesin e përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të MFP-së dhe dërgon kërkesën për raportim të të gjithë drejtuesit e shtyllave, të cilët janë strukturat drejtuese përgjegjëse për raportimin mbi zbatimin e Strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancën kundrejt objektivave, çdo vonese, apo ndryshimesh, identifikimin e risqeve të materializuara, risqeve të reja dhe masave zbutëse. Ky raport është përgatitur bazuar në instrumentin e rishikuar të monitorimit, të miratuar nga Komiteti Drejtues nr. 19, datë 11 nëntor 2025, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”. Struktura e raportit vjetor të monitorimit për vitin 2025 është hartuar në përputhje me metodologjinë SIPI, bazuar në VKM-në nr. 290, datë 11.4.2020.

Vlerësimi i progresit në fushën e MFP-së kryhet në dy nivele: në nivelin e treguesve të performancës dhe në nivelin e zbatimit të aktiviteteve. Për sa i përket vlerësimit të treguesve të performancës, metodologjia e përdorur është si vijon: një TP shënohet me të gjelbër (i arritur) kur përmbush objektivin e vitit 2025 sipas planit; me të kuqe (nuk është arritur) kur nuk arrin të përmbushë objektivin e vitit 2025; dhe me të verdhë (i arritur pjesërisht) për të gjitha rastet e tjera. Për vlerësimin në nivel aktiviteti, aktivitetet shënohen me të gjelbër kur kanë nisur në vitin 2023, 2024 ose 2025 dhe janë përfunduar sipas planifikimit brenda vitit 2025; me ngjyrë blu janë ato aktivitete që kanë nisur në vitin 2023, 2024 ose 2025 dhe janë në rrugën e duhur sipas planit, por kanë një datë përfundimi përtej vitit 2025 (me përjashtim të aktiviteteve me objektiva periodikë vjetorë, që konsiderohen të përfunduara për vitin dhe shënohen me të gjelbër). Aktivitetet shënohen me të verdhë kur, pavarësisht datës së planifikuar të përfundimit, nuk kanë përparuar sipas pritshmërive gjatë vitit 2025. Aktivitetet e shënuara me të kuqe janë ato që ende nuk kanë filluar, si dhe ato që “nuk po ecin sipas planit”, të cilat klasifikohen si aktivitete që nuk po përparojnë në mënyrë të përshtatshme dhe janë mundësisht në rrezik dështimi.

1.3 Vizibiliteti dhe konsultimet e MFP-së

Strategjia e Reformës së MFP-së shërben si kuadër për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile aktive në këtë sektor. Kuadri institucional për menaxhimin e reformave të MFP-së përbëhet nga Komiteti Drejtues (KD), Komiteti Teknik dhe Drejtoria për reformën e MFP-së.


Më 20 qershor 2025, u organizua Komiteti Teknik i 13-të i Menaxhimit të Financave Publike. Fokusi i mbledhjes ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2024, sfidat dhe progresi i arritur, si dhe diskutimi i raporteve vlerësuese nga partnerët ndërkombëtarë. Mbledhja e 14-të e Komitetit Teknik të MFP-së u zhvillua më 30 tetor 2025, për të shqyrtuar dhe diskutuar Raportin Gjashtëmujor të Monitorimit për vitin 2025. Në vijim, më 11 nëntor 2025, të dy raportet u diskutuan dhe u miratuan në mbledhjen e 19-të të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Komiteti Drejtues, i kryesuar nga Zëvendësministri i Financave, mbledhi së bashku të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin dhe mbikëqyrjen e reformës së MFP-së, përfshirë anëtarët e Komitetit Teknik dhe Komitetit Drejtues, partnerët ndërkombëtarë për zhvillim dhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile. Mbledhja e 15-të e Komitetit Teknik të MFP-së u zhvillua më 27 mars 2026, për të shqyrtuar dhe diskutuar Raportin Vjetor të Monitorimit për vitin 2025. Më 22 maj 2026, Raporti Vjetor i Monitorimit të MFP-së u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e 20-të të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe do të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, Ministria e Financave publikon në faqen e saj zyrtare çdo raport vjetor monitorimi, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze.

2. ECURIA E STRATEGJISË NË 2025

2.1 Arritjet në zbatimin e Shtyllave të Strategjisë MFP për 2025

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progress të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Progresi në fushën e MFP-së ka qenë i kënaqshëm, me 71.01% të objektivave të Treguesve të Performancës të arritura plotësisht. Në përgjithësi, grafiku më poshtë paraqet një pasqyrë të nivelit të arritjes për secilën shtyllë, në nivelin e treguesve të performancës.

Grafiku 3. Niveli i arritjeve të TP-ve për secilën shtyllë



Gjatë vitit 2025, u përmbushën objektivat e mëposhtëm të treguesve të performancës: (1) PBB-ja nominale: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero; (2) Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero; (3) Përfundimi i asistencës teknike për analizën e qëndrueshmërisë së borxhit; (4) Krijimi i kuadrit të analizës së qëndrueshmërisë së borxhit; (5) Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal; (6) Krijimi i Këshillit Fiskal; (7) Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së; (8) Vlerësimi i Indeksit të Buxhetit të Hapur – pikët e pjesëmarrjes publike; (9) Vlerësimi i Indeksit të Buxhetit të Hapur – transparenca; (10) Prezantimi i rishikimeve të shpenzimeve; (11) Prezantimi i analizës së hendekut gjinor si pjesë e BPGJ-së; (12) Prezantimi i buxhetimit të gjelbërt të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike; (13) Miratimi i DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP); (14) Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes); (15) Pjesa e projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioriteteve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar); (16) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara, shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime; (17) Formula e grantit e rregulluar bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë; (18) Prezantohet skema shtesë e granteve të bazuara në performancë (SGBP); (19) PEFA Treguesi i Performancës 7: Transferrat tek qeveria vendore; (20) Përqindja e bashkive që përdorin software-in e ri SMBV; (21) Përqindja e bashkive që publikojnë planet e performancës për ofrimin e shërbimeve; (22) Përqindja e bashkive që publikojnë informacion mbi performancën e arritur nga ofrimi i shërbimeve; (23) Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe e-Platformës; (24) Treguesi i Performancës PEFA 28 “Raportet e buxhetit gjatë vitit”; (25) Publikimi i raporteve të zbatimit të buxhetit për qytetarët; (26) Numri i kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare; (27) Rritja e të hyrave nga SAA-ja (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së); (28) Rritja e të hyrave nga TVSh-ja (e matur në bazë jokumulative); (29) Rritja e të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeclaruar dhe të padeclaruar (e matur në bazë jokumulative) si rezultat i futjes së 40 mijë punonjësve të rinj në skemë dhe rritja e deklarimit të pagës së 120 mijë punonjësve, sipas kalendarit të rritjes në SAA; (30) Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjelbër; (31) Numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar; (32) Prodhimi i kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor bazuar në SNKSP sipas planit; (33) Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP; (34) Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit të SAMB-së i përgatitur dhe publikuar; (35) Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit; (36) Zërat e detajuara të hyrjeve dhe daljeve në parashikimin e flukseve të likuiditetit të përfshira; (37) Rritja e numrit të instrumenteve për menaxhim aktiv të likuiditetit; (38) Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të aseteve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese; (39) Ligji dhe aktet nënligjore të MFK-së janë ndryshuar dhe miratuar; (40) Përqindja e institucioneve publike që mbulohen nga auditimet e brendshme vjetore; (41) Numri i institucioneve publike që kanë një komitet funksional auditimi; (42) Përqindja e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC-në, në përputhje me standardet në fuqi; (43) Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP-së; (44) Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit (SKKM) për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është miratuar dhe monitoruar; (45) Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III; (46) SIGMA Treguesi 4.3.1.5: Efektiviteti i kontrollit të autoriteteve publike nga institucionet e pavarura mbikëqyrëse (zbatimi i rekomandimeve të ISA); (47) Mjet i auditimit me ndihmën e kompjuterit (software) është në përdorim; (48) Metodologjia e auditimit të PPP-ve dhe koncesioneve e institucionalizuar; (49) Plani zhvillimor i përgatitur dhe zbatuar.

2.2 Ndikimi i zbatimit të strategjisë së MFP-së në përputhje me axhendën e Integrimit Evropian

Reforma e menaxhimit të financave publike vijon të jetë prioritet i Qeverisë Shqiptare, jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në BE në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP), por edhe me synimin për të mbështetur një ekonomi më të zhvilluar dhe shërbime më të mira për qytetarët. Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si dhe vijimësia e rëndësisë dhe besueshmërisë së programit të reformës, përbëjnë një nga kushtet e përgjithshme për disbursimin e kësteve të mbështetjes buxhetore në kuadër të fondeve IPA, si dhe për Axhendën e Reformave. Në këtë kontekst, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 adreson disa nga sfidat me të cilat përballlet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së. Për më tepër, progresi në fushën e MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit, si: raporti i Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike (GP RAP), Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, Raporti i Monitorimit SIGMA, Vlerësimi i PEFA-s dhe Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë.

Sa i përket **Grupit të Posaçëm BE–Shqipëri për Reformën në Administratën Publike (GP RAP)**, ai shërben si platforma kryesore për të shtyrë përpara punën për RAP-in. Raporte periodike mbi ndjekjen e konkluzioneve të GP RAP përgatiten nga Qeveria Shqiptare dhe, në çdo mbledhje vjetore, miratohen konkluzione mbi fushat që duhen përmirësuar. Mbledhja e 13-të e GP RAP u zhvillua në tetor 2025, gjatë së cilës u lanë disa konkluzione operacionale, si më poshtë: (1) Shqipëria të përgatisë dhe publikojë rregullisht, në tremujorin e parë të vitit pasardhës, raportet e zbatimit për strategjitë e PAR, Decentralizimit dhe MFP-së, si dhe të sigurojë që ato të jenë publikisht të aksesueshme; (2) Shqipëria të miratojë kuadrin ligjor për ngritjen e një institucioni të pavarur të mbikëqyrjes fiskale (Këshillit Fiskal) dhe të sigurojë krijimin dhe operacionalizimin e tij në kohë; (3) Shqipëria të sigurojë zbatimin e rregullave fiskale dhe gjithëpërfshirjen e raportimit të saj financiar, përmes vendosjes së rregullimeve të qarta për mbledhjen, konsolidimin dhe publikimin e qëndrueshëm të raporteve financiare nga të gjitha njësitë e kontrolluara nga qeveria, përfshirë të gjitha njësitë jashtëbuxhetore, në koordinim me ministritë e linjës dhe INSTAT-in; (4) për të forcuar transparencën dhe mbikëqyrjen parlamentare në menaxhimin e buxhetit, Shqipëria të kufizojë përdorimin e akteve normative për ndryshimet buxhetore vetëm në situata realisht të jashtëzakonshme dhe të kryejë rregullimet kryesisht përmes procesit të rregullt të rishikimit të buxhetit; (5) Shqipëria të vijojë forcimin e monitorimit të risqeve fiskale, përfshirë përmes përgatitjes dhe publikimit të rregullt të një deklarate gjithëpërfshirëse të risqeve fiskale si pjesë e dokumenteve buxhetore. Në këtë kuadër, fokusi duhet të mbahet në fushat me risk të lartë fiskal (ndërmarrjet shtetërore, PPP-të dhe sektori gjyqësor); (6) Shqipëria të forcojë më tej menaxhimin e investimeve publike, përmes zbatimit të plotë dhe të qëndrueshëm të dispozitave të vendimit për MIP-në. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së projekteve PPP në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, në përputhje me angazhimet e Axhendës së Reformave; (7) Shqipëria të vijojë reformat për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, me fokus të veçantë te detyrimet e prapambetura në qeverisjen vendore dhe ato që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si nga çështjet civile, ashtu edhe nga ato administrative; (8) Shqipëria të rregullojë siç duhet kriteret dhe tipologjinë për krijimin e organeve të varësisë, të përcaktojë më mirë organizimin dhe funksionet, si dhe të qartësojë linjat e llogaridhënies dhe rregullimet e qeverisjes ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre të varësisë, përmes miratimit dhe zbatimit efektiv të ndryshimeve në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore; (9) Shqipëria të sigurojë që masat legjislative të miratuara për forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe delegimit të vendimmarrjes të zbatohen efektivisht në praktikë. Shqipëria të raportojë dy herë në vit pranë

Komisionit dhe organeve përkatëse kombëtare mbikëqyrëse mbi delegimin e përgjegjësisë në institucionet e administratës shtetërore; (10) Shqipëria të vendosë praktikën e rregullt të monitorimit të përputhshmërisë së autoriteteve publike në nivel qendror me të gjitha kërkesat e nenit 7 të Ligjit për të Drejtën e Informimit. Këto konkluzione do të monitorohen dhe ndiqen nga Ministria e Financave, ndërsa progresi i tyre do të raportohet në mbledhjen e ardhshme të PAR SG-së.

Në lidhje me Udhërrëfyesin e RAP, pas takimit dypalësh ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë për Reformën në Administratën Publike (Grup Kapitulli 1), i mbajtur më 12 dhjetor 2022, Departamenti i Administratës Publike, si institucioni udhëheqës në këtë fushë, nisi procesin për përgatitjen e Udhërrëfyesit të RAP për 6 fusha tematike në kuadër të RAP, ku “Menaxhimi i Financave Publike” është një nga këto fusha tematike. Udhërrëfyesi i RAP u miratua me VKM Nr. 737, datë 13.12.2023. Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave vazhdoi të monitorojë zbatimin e masave dhe të raportojë progresin në baza tremujore.

Në lidhje me vlerësimin e SIGMA-s, ushtrimi më i fundit i monitorimit u krye në vitin 2024. Gjatë mbledhjes së Komitetit Drejtues të MFP-së, të mbajtur më 11 nëntor 2025, vëmendja e pjesëmarrësve u tërhoq mbi rëndësinë e marrjes në konsideratë të gjetjeve të këtij raporti gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit të MFP-së 2027–2030. Për më tepër, duke qenë se metodologjia e vlerësimit SIGMA 2024 është rishikuar, raportimi i ardhshëm mbi treguesit SIGMA të përfshirë në planin e veprimit të MFP-së do të harmonizohet dhe përshtatet sipas metodologjisë së re.

Në maj 2024 filloi Vlerësimi PEFA 2024 për Shqipërinë. Vlerësimi mbuloi të dhënat për vitet fiskale 2021, 2022 dhe 2023. Qëllimi i Vlerësimit PEFA 2024 ishte t’i japë Qeverisë së Shqipërisë një diagnozë objektive të përditësuar mbi performancën e Menaxhimit të Financave Publike në nivel qendror, bazuar në metodologjinë PEFA dhe në 31 tregues të performancës. Fushat e MFP-së që iu nënshtruan këtij vlerësimi ishin si më poshtë: (i) planifikimi dhe zbatimi i buxhetit; (ii) marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare; (iii) informacioni mbi performancën për ofrimin e shërbimeve; (iv) aksesit publik në informacionin fiskal; (v) menaxhimi i investimeve publike; (vi) monitorimi i aseteve publike; (vii) parashikimet makroekonomike; (viii) menaxhimi i borxhit; (ix) administrimi i të ardhurave; (x) parashikueshmëria e alokimit të burimeve brenda vitit; (xi) shpenzimet për detyrimet e prapambetura; (xii) kontrollet e listëpagesave dhe kontrollet e brendshme mbi shpenzimet jopaga; (xiii) sistemi i prokurimit; auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; si dhe integriteti i të dhënave financiare. Ky proces u menaxhua dhe u mbikëqyr nga Qeveria e Shqipërisë, Delegacioni i Bashkimit Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SECO dhe SIDA. Ministria e Financave, në këtë proces, luajti rolin e koordinatorit dhe mbështetësit për ekipin e konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Delegacioni i BE-së. Draft raporti i vlerësimit u finalizua në dhjetor 2024 dhe eventit i lançimit të raportit përfundimtar të Vlerësimit PEFA 2024 për Shqipërinë u mbajt më 15 korrik 2025. Raporti përfundimtar është publikuar gjithashtu në faqen e internetit të PEFA².

Vlerësimi PEFA 2024 u krye duke përdorur të njëjtën metodologji si vlerësimi PEFA i vitit 2016. Gjetjet e raportit tregojnë një panoramë të përzier, ku 18 nga 31 Treguesit e Performancës (TP) kanë marrë vlerësime të mira në intervalin A-B, ndërsa 13 prej tyre janë vlerësuar me C-D.

Pikat e forta të identifikuara në këtë vlerësim janë:

- Stabiliteti në zbatimin e buxhetit, me devijime të ulëta të shpenzimeve, si sipas klasifikimit ekonomik ashtu edhe atij funksional, ndërmjet buxhetit fillestar dhe realizimit faktik;
- Një proces buxhetor i rregullt dhe një kuadër i mirëzhvilluar i planifikimit fiskal afatmesëm;
- Një theks i fortë mbi kontrollin e brendshëm financiar dhe rregullime të kënaqshme për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Administrim dhe mbledhje efektive e taksave direkte dhe indirekte;
- Funksionim i mirë i menaxhimit të borxhit dhe likuiditetit;

² <https://www.pefa.org/country/albania>

- Objektiva të qarta për funksionimin e shërbimeve publike, me tregues performance të përcaktuar në kohë.

Dobësitë e identifikuar janë:

- Paplotësia e raportimit dhe monitorimit financiar: mospërputhje në të dhënat e publikuara, mungesë e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara për Qeverisjen Qendrore (QQ), raportim shumë i kufizuar i konsoliduar gjatë vitit për shpenzimet, mungesë e raportimit të konsoliduar për Ndërmarrjet Shtetërore (NSH) ose e monitorimit të risqeve të lidhura me të gjitha PPP-të/koncesionet, si dhe mungesë e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të organeve rregullatore dhe organeve të tjera që i përkasin QQ-së, por që nuk përfshihen drejtpërdrejt në buxhet;
- Mbulim i kufizuar nga sistemet e TI-së, ku shumë transaksione kryhen jashtë sistemit automatik të Thesarit, si dhe mbajtje e tepriceve të konsiderueshme të mjeteve monetare jashtë Llogarisë së Vetme të Thesarit;
- Vëmendje e kufizuar ndaj aktiveve jofinanciare, pa informacion mbi vlerën e tyre;
- Mosshfrytëzimi deri më tani nga Kuvendi i raporteve të auditimit për t'i kërkuar llogari Ekzekutivit.

Dobësitë e identifikuar në Vlerësimin PEFA 2024 do të jenë në fokusin e ardhshëm të njëjësive përgjegjëse, për t'u përfshirë dhe monitoruar në Planin e Veprimit të MFP-së 2027–2030.

Përsa i përket **raportit të BE-së për 2025 për Shqipërinë**³, gjetjet kryesore janë paraqitur në kutinë e mëposhtme.

- **Strukturat e menaxhimit të financave publike (MFP) janë përgjithësisht të ngritura, por kanë nevojë të përmirësohen.** Baza ligjore për MFP-në është kryesisht e konsoliduar, me një ligj organik të buxhetit gjithëpërfshirës. Në dhjetor 2024, qeveria miratoi Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027, e cila detajon politikën tatimore, përfshirë rishikimin e përjashtimeve tatimore, administrimin tatimor dhe reformat doganore, me objektivin për të rritur raportin të ardhura fiskale/PBB me 2.5% deri në vitin 2027.
- **Dispozitat e ligjit organik të buxhetit ndiqen në masë të madhe.** Megjithatë, rishikimet e buxhetit vijnë të kryhen ekskluzivisht përmes akteve normative të miratuara nga ekzekutivi. Nevojitet veprim më vendimtar për t'u rikthyer te proceset e rregullta të rishikimit të buxhetit përmes Kuvendit. Disa reforma buxhetore kanë vijuar, përfshirë përpjekjet e vazhdueshme për të integruar më mirë buxhetet afatmesme me listën unike të projekteve. Lidhja ndërmjet prioritetëve strategjike dhe programeve buxhetore duhet të forcohet më tej. Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor vijoi edhe në vitin 2024, me rreth 9.3% të buxhetit të dedikuar për politika publike me bazë gjinore. Gjurmueshmëria e alokimeve buxhetore me bazë gjinore duhet të forcohet.
- **Niveli i detyrimeve të prapambetura ka rënë,** por përpjekjet e vazhdueshme për të forcuar respektimin e angazhimeve duhet të vijojnë. Strategjia e borxhit po zbatohet përmes uljes së raportit borxh publik/PBB, zgjatjes së maturitetit të borxhit dhe reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të kursit të këmbimit.
- **Monitorimi i risqeve fiskale është forcuar.** Megjithatë, raportimi mbi risqet fiskale dhe vlerësimi i risqeve fiskale të lidhura me ndërmarrjet shtetërore dhe partneritetin publik privat mbeten për t'u përmirësuar më tej. Ka nevojë të krijohet një institucion i pavarur i mbikëqyrjes fiskale (Këshilli Fiskal).
- **Transparenca buxhetore** është kryesisht e kënaqshme, me të gjitha dokumentet kryesore buxhetore të publikuara rregullisht. Megjithatë, nevojiten përmirësime të mëtejshme në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, si dhe në raportimin e thelluar mbi njësitë jashtëbuxhetore.

³ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

Për më tepër, bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë përgjegjëse të MFP-së, rezulton se 11 nga 24 komponentët e reformës së MFP-së lidhen me kapitujt e SKZHIE-së, përfshirë grupimet themelore.

2.3 Ndikimi i zhvillimit të sektorit në rajon dhe/ose më gjerë

Ky seksion ofron një vështrim krahasues të treguesve kryesorë makroekonomikë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, me fokus në financat publike dhe performancën ekonomike. Supozohet se vendet e Ballkanit Perëndimor ndjekin kryesisht një agjendë të ngjashme reformash në fushën e MFP-së, të lidhur me objektivin e përgjithshëm të anëtarësimit në BE. Bazuar në të dhënat e paraqitura në Raportin e Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor, dhe siç tregohet në tabelën më poshtë, performanca e Shqipërisë paraqet një panoramë të përzier krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Gjatë viteve, vërehet një rënie e rritjes reale të PBB-së, nga 4.8% në vitin 2022 në 3.7% në vitin 2025. Kosova dhe Shqipëria kanë nivelet më të larta të rritjes në rajon. Të ardhurat si përqindje e PBB-së janë më të ulëtat në rajon, ndërsa balanca primare luhet dhe arrin në 0.5% në vitin 2025. Borxhi si përqindje e PBB-së ka shënuar rënie gjatë viteve të fundit dhe mbetet në nivelin 52.2% në vitin 2025, më i ulët se në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, por më i lartë se në vendet e tjera të rajonit.

Tabela 1. Treguesit fiskalë në shtetet e Ballkanit Perëndimor 2022 - 2025

Treguesit makro	Rritja reale e PBB-së (%)			Të ardhura (% e PBB)			Balanca Primare (% e PBB)			Borxhi (% e PBB)		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Shqipëria	4.8	4.0	4.0	26.6	27.2	28.2	-1.8	0.7	1.4	61.7	55.9	52.9
Bosnja dhe Hercegovina	4.2	2.0	3.0	39.9	40.7	41.9	0.2	-0.4	-0.8	29.3	26.4	26.3
Kosova	4.3	4.1	4.4	27.9	29.3	29.9	-0.1	0.1	0.1	19.7	17.2	16.9
Mali i Zi	7.7	6.5	3.2	39.1	41.6	41.7	-2.1	2.4	-1.1	69.0	58.4	59.8
Maqedonia e Veriut	2.8	2.1	2.8	31.6	32.7	33.9	-3.2	-2.9	-2.7	49.6	49.7	53.8
Serbia	2.6	3.8	3.9	41.6	39.4	41.0	-1.6	-0.4	-0.1	50.5	46.6	45.4

Treguesit makro	Rritja reale e PBB-së (%) 2025 f	Të ardhura (% e PBB) 2025 f	Balanca Primare (% e PBB) 2025 f	Borxhi (% e PBB) 2025 f ⁴
Shqipëria	3.7*	28.3*	0.5*	52.2*
Bosnja dhe Hercegovina	2.6	42.4	-0.6	24.5
Kosova	3.8	29.1	-0.5	16.8
Mali i Zi	3.3	40.6	-1.6	59.4
Maqedonia e Veriut	3.1	35.2	-1.9	55.2
Serbia	2.8	41.3	-1.5	44.7

Burimi: Grupi i Bankës Botërore⁵


⁴ Vlerat e parashikuara për 2025

⁵<https://www.google.com/url?sa=t&source=web&rct=j&opi=89978449&url=https://documents.worldbank.org/en/publication/documents->


2.4 Aktivitetet e shtyllave që nuk përparuan sipas planit

Bazuar në vetë-vlerësimin, progresi i MFP-së ka qenë i kënaqshëm, me 69.17% të progresit në nivel aktiviteti (kjo përfshin “26.32% të përfunduar” dhe “42.86% në rrugën e duhur”). Grafiku më poshtë paraqet një vështrim të statusit të aktiviteteve për të gjashta shtyllat.

Grafiku 4. Niveli i përgjithshëm i aktiviteteve të strategjisë së MFP



Ndërkohë, ka disa aktivitete që nuk kanë ecur sipas planit. Në total 23.31% të aktiviteteve janë pjesërisht në rrugën e duhur, 5.26% e aktiviteteve nuk kanë filluar gjatë vitit 2025, 0.75% të aktiviteteve nuk po ecin dhe për 1.5% të tyre nuk kishte të dhëna të disponueshme në momentin e raportimit. Puna do të vazhdojë në vitin e ardhshëm për këto aktivitete.

Grafiku 5. Aktivitetet që nuk kanë përparuar sipas planit gjatë 2025

2.5 Zbatimi i buxhetit të përgjithshëm

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma politikash. Puna për formalizimin e këtyre reformave në trajtën e legjislacionit të ri apo të amenduar dhe rregulloreve, në përgjithësi nuk ka kërkuar burime financiare shtesë. Stafi ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për arritjen e rezultateve të synuara. Plani i Veprimit 2023–2026 parashikon që kostoja totale shtesë për zbatimin e aktiviteteve të jetë 11.58 milionë euro, nga të cilat 811,152 euro do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit dhe 10.77 milionë euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim. Ndërkohë, buxheti i planifikuar për Planin e Veprimit të vitit 2025 ishte 3.031 milionë euro (177,257 euro nga Buxheti i Shtetit dhe 2,854,624 euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim). Gjatë vitit 2025, burimet totale të përdorura për zbatimin e reformës ishin 131,029 euro nga Buxheti i Shtetit dhe 1,033,920 euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim.

3 Progresi në zbatimin e Shtyllave të Strategjisë së MFP-së

Në seksionet më poshtë janë përshkruar detajet specifike të zhvillimeve për secilën shtyllë.


3.1 Progresi në Shtyllën 1 “Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut”

Gjatë vitit 2025, janë ruajtur dhe përmirësuar më tej sistemet për: (i) zhvillimin dhe monitorimin e politikave fiskale të shëndosha të bazuar në rregulla fiskale; (ii) parashikimet e avancuara makroekonomike; dhe (iii) praktikatat solide të menaxhimit të risqeve fiskale. Të gjithë objektivat e përcaktuar për vitin 2025 janë arritur ose janë tejkaluar dhe paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela 2. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 1

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik (Komponenti) 1.1 Programim makroekonomik i matur dhe realist				
1	PBB nominale: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero.	0.0 miliardë Lek (2022)	≤ 0	-19.5
2	Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero.	-1.8 % e PBB (2022)	≥ 0	0
Objektivi specifik (Komponenti) 1.2 Krijimi i një Analize gjithëpërfshirëse të Qëndrueshmërisë së Borxhit				
1	Përfundimi i asistencës teknike për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit.	- (2022)	Vazhdimi i asistencës teknike	Vazhdimi i asistencës teknike
2	Krijimi i kuadrit të analizës së qëndrueshmërisë së borxhit.	- (2022)	Prezantimi i një kuadri bazë të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit	Prezantuar një kuadër i brendshëm bazë për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale				
1	Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal.	-	E përfunduar	E përfunduar
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.4: Këshilli Fiskal				
1	Krijimi i Këshillit Fiskal.	-	Hartimi i kuadrit ligjor të Këshillit Fiskal	Hartimi i kuadrit ligjor të Këshillit Fiskal & në proces shqyrtimi të brendshëm

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025. Shumica e aktiviteteve (82.35%) ishin ose në rrugën e duhur ose të përfunduara, 5.88% u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur, ndërsa 11.76% e aktiviteteve nuk kishin filluar akoma.

Grafiku 6. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në Shtyllën 1


Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 1.1 Programimi Makroekonomik i Matur dhe Realist

Treguesit e Performancës

Objektivat për treguesit e performancës të këtij komponenti janë arritur dhe tregojnë përputhshmëri të plotë me rregullat fiskale për vitin 2025.

Treguesi i parë i performancës për këtë komponent kërkon që diferenca midis parashikimit vjetor të PBB-së nga Ministria e Financave, siç paraqitet në dokumentacionin vjetor të buxhetit që i dorëzohet Kuvendit, dhe parashikimit vjetor të PBB-së nga FMN, siç publikohet në raportin “World Economic Outlook”, të mos jetë më e madhe se zero. Vlera nominale e PBB-së e parashikuar nga MF për vitin 2025 ishte 2,624.5 miliardë lekë, ndërsa PBB-ja e parashikuar nga FMN-ja në “World Economic Outlook”, publikimi më i fundit në momentin kur ligji vjetor i buxhetit paraqitet për miratim në Kuvend (tetor 2025), ishte 2,662.0 miliardë lekë. Për vitin 2025, kjo diferencë arrin në -19.5 miliardë lekë.

Treguesi i dytë i performancës i referohet treguesit makroekonomik të balancës primare, vlera e synuar e të cilit nuk duhet të jetë negative. Siç përcaktohet në LOB, duke filluar nga viti 2024 dhe për çdo vit pasues, kërkohet që balanca primare të mos jetë më e vogël se zero, duke siguruar një pozicion të balancuar ose pozitiv. Balanca primare shënoi një përmirësim të konsiderueshëm në vitin 2024, duke arritur në 1.4% të PBB-së, nga 0.7% e PBB-së në vitin 2023, duke respektuar kështu rregullin fiskal një vit më herët. Për vitin 2025, balanca primare pritet të jetë në një nivel neutral.

Masat dhe aktivitetet

Parashikimi i kujdesshëm dhe real i treguesve makroekonomikë, krahasimi i vazhdueshëm i projeksioneve (analizë krahasuese) me ato të parashikuesve të pavarur ndërkombëtarë, si dhe përputhshmëria me rregullat fiskale ka përfunduar.

Parashikimet e treguesve makroekonomikë të Ministrisë së Financave janë krahasuar publikisht për vitin 2025. Kjo analizë krahasuese është bërë publike përmes *Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) 2027–2029 dhe Programit të Reformave Ekonomike (PRE) 2026–2028*. Të dy dokumentet janë finalizuar dhe janë në proces miratimi nga Këshilli i Ministrave brenda muajit janar 2026.

Procesi i plotësimit të vendeve vakante për staf të specializuar, si dhe zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të specializuara për stafin e DPPMF-së, **ka qenë në rrugën e duhur**. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, Banka Botërore zhvilloi tre trajnime të rëndësishme për stafin e Ministrisë së Financave, përkatësisht: Kuadrin e Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit, Paketën për Simulimin e Opsioneve të Reformës së Pensioneve (PROST) dhe Ekonometrinë e Aplikuar. Përveç kësaj, katër specialistë të rinj u rekrutuan në DPPMF, duke forcuar më tej kapacitetet teknike dhe institucionale të saj.

Lidhur me parashikimin e kujdesshëm dhe realist afatmesëm të të ardhurave, në përputhje me parashikues të pavarur dhe ndërkombëtarë, aktiviteti që lidhet me krahasimin e vazhdueshëm dhe publikimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave të MF-së kundrejt parashikuesve të pavarur dhe ndërkombëtarë **ka qenë në rrugën e duhur**. Parashikimet afatmesme të të ardhurave të MF-së janë krahasuar në mënyrë të vazhdueshme me parashikimet e FMN-së në çdo cikël të programimit financiar të përdorur për përgatitjen e “Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal 2027–2029” dhe “Programit të Reformave Ekonomike 2026–2028”.

Ruajtja e financave publike të shëndosha dhe kuadrit fiskal të qëndrueshëm përmes respektimit rigoroz të rregullave fiskale të përcaktuara me ligj ka përfunduar. Në vitin 2025, Shqipëria ka respektuar në mënyrë rigoroz rregullat fiskale të përcaktuara me ligj. Përputhshmëria me rregullat fiskale për vitin 2025 analizohet përmes publikimit të rregullt në një seksion të dedikuar, *Kuadrati Shpjegues: Përputhshmëria me rregullat fiskale, në kuadër të dokumenteve të KMF-së, PRE-së dhe në Raportin*

Zbatimin të Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale, siç është specifikuar më sipër. Nuk ka vonesa në zbatim.

Objektivi Specifik 1.2 Krijimi i një Analize gjithëpërfshirëse të Qëndrueshmërisë së Borxhit

Treguesit e Performancës

Objektivi për vitin 2025 lidhur me treguesin për përfundimin e asistencës teknike për Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit është përmbushur. Në prill 2025, stafi i Ministrisë së Financave, përkatësisht nga DPPMF dhe DPBSh, mori pjesë në një trajnim të ofruar nga Banka Botërore mbi Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit. Trajnimi përfshiu si prezantime, ashtu edhe zbatimin praktik të instrumentit. Gjithashtu, ekipit iu vu në dispozicion një format/template të dhënash për t'u plotësuar si hap përgatitor.

Sa i përket treguesit për ngritjen e kuadrit të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit, ekipit iu vu në dispozicion një model të dhënash për t'u plotësuar si hap përgatitor. Ky model është plotësuar me të dhëna nga stafi i MF-së dhe aktualisht po përdoret brenda institucionit.

Masat dhe aktivitetet

Ofrimi i asistencës teknike për procesin e Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit është në rrugën e duhur. Në prill 2025, stafi i Ministrisë së Financave, përkatësisht nga DPPMF dhe DPBSh, mori pjesë në një trajnim të ofruar nga Banka Botërore mbi Analizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit. Trajnimi përfshiu si prezantime, ashtu edhe zbatimin praktik të instrumentit.

Prezantimi i kuadrit të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit si instrument i programimit makroekonomik është përfunduar, në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga ekipi i Bankës Botërore, financuar nga Fondi i Mirëbesimit i BE-së dhe për rrjedhojë, mbetemi në rrugën e duhur për ngritjen e një procesi sistematik të Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit brenda institucionit deri në vitin 2026, siç synohet në treguesin përkatës të performancës të Strategjisë së MFP-së. Një model të dhënash i është dorëzuar ekipit për t'u plotësuar si hap përgatitor. Afati për këtë tregues është tremujori i katërt i vitit 2026; ndaj, gjatë vitit 2025, modeli është plotësuar me të dhëna nga stafi i MF-së dhe po përdoret brenda institucionit.

Objektivi Specifik 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale

Treguesit e Performancës

Treguesi i performancës “Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal” është përfunduar. Deklaratat e Risqeve Fiskale për vitet 2024 dhe 2023 janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

Masat dhe aktivitetet

Në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e risqeve fiskale, gjatë vitit 2025 Drejtoria e Risqeve Fiskale (DRF) përfundoi procesin e rekrutimit, duke arritur konsolidimin e saj në përputhje me strukturën e miratuar (1 drejtor dhe 4 specialistë). Asistenca teknike u ofrua nga partnerët ndërkombëtarë, përkatësisht Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, me fokus në përgatitjen dhe përmirësimin e Deklaratës së Risqeve Fiskale (DRF), forcimin e monitorimit të risqeve fiskale që burojnë nga ndërmarrjet shtetërore (NSH), si dhe përmirësimin e analizës së risqeve fiskale të lidhura me fatkeqësitë natyrore.

Në lidhje me zhvillimin, pilotimin dhe publikimin çdo vit të Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal, në fund të muajit maj 2025 u finalizua Deklarata e Risqeve Fiskale për vitin 2024 dhe më pas iu paraqit Këshillit

të Ministrave për qëllime informimi. Deklaratat e Risqeve Fiskale për vitet 2024 dhe 2023 janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

Lidhur me zgjerimin e fushës së risqeve fiskale të raportuara në Deklaratën e Risqeve Fiskale (DRF), duke përfshirë edhe risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike, risqet nga fatkeqësitë natyrore janë tashmë të përfshira në DRF-në e finalizuar për vitin 2024. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar takime me Bankën Botërore për të përcaktuar hapat e ardhshëm në lidhje me analizën dhe zgjerimin e saj në kontekstin e risqeve të lidhura me fatkeqësitë natyrore, ku Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile mbetet institucioni përgjegjës për monitorimin, analizimin dhe raportimin e këtyre risqeve. Sa i përket risqeve të lidhura me ndryshimet klimatike, vlen të theksohet se jo vetëm Shqipëria, por edhe vendet e tjera të rajonit ndodhen ende në fazat fillestare të këtij procesi. Banka Botërore ka parashikuar misione dhe trajnime të mëtejshme në këtë fushë; megjithatë, ende nuk është përcaktuar një kalendar konkret. Asistenca teknike e ardhshme nga partnerët ndërkombëtarë do të përmirësojë më tej analizën e risqeve nga fatkeqësitë natyrore, veçanërisht ato të kryera nga Agjencia e Mbrojtjes Civile, me synimin për t'u zgjeruar drejt analizës së risqeve që lidhen me ndryshimet klimatike.

*Forcimi i menaxhimit të risqeve fiskale në lidhje me PPP-të dhe kontratat koncesionare **nuk ka filluar akoma.***

Sa i përket forcimit të mbikëqyrjes fiskale të Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH), gjatë vitit 2025 Drejtoria e Risqeve Fiskale ka vijuar monitorimin rigoroz të Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH), në përputhje me nenin 4/2 të Ligjit Organik të Buxhetit, Udhëzimin Plotësues nr. 2/2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, si dhe Udhëzimin nr. 35/2022 për procedurat e raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale. Rezultatet e Instrumentit të Kontrollit të Shëndetit Financiar për NSH (HCT) janë integruar në Deklaratën e Risqeve Fiskale (DRF) për vitin 2024, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë në vlerësimin e risqeve fiskale që burojnë nga NSH-të. Aplikimi i Instrumentit të Kontrollit të Shëndetit Financiar të NSH-ve (HCT) është kryer, me mbështetjen e Departamentit të Çështjeve Fiskale (DÇF) të FMN-së, për vlerësimin e 12 NSH-ve që operojnë në sektorët e energjisë dhe ujësjellës-kanalizimeve, bazuar në treguesit kryesorë financiarë të tyre, si likuiditeti, niveli i borxhit dhe përfitueshmëria.

Sa i përket konsolidimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të metodologjisë për monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit bën me dije se, përmes integritetit të SIFQ me Sistemin e Fiskalizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të mundësohet marrja e informacionit në kohë reale mbi faturat e lëshuara për pagesa nga operatorët ekonomikë drejt institucioneve buxhetore, të lidhura me shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Objektivi Specifik 1.4 Këshilli Fiskal

Treguesit e Performancës

Projektligji për Këshillin Fiskal gjatë vitit 2025 ka qenë në proces shqyrtimi të brendshëm. Janë zhvilluar një sërë takimesh të dedikuara për diskutimin e dispozitave të tij, me fokus të veçantë në mandatin e Këshillit, strukturën e qeverisjes, pavarësinë dhe detyrimet e raportimit. Këto diskutime të brendshme synojnë të sigurojnë përafrimin me praktikën më të mira ndërkombëtare, të garantojnë transparencën fiskale dhe të krijojnë një bazë të qëndrueshme institucionale për rolin e ardhshëm të Këshillit.

Masat dhe aktivitetet

Një dokument lidhur me opsionet dhe mënyrat e mundshme për zhvillimin e një Këshilli Fiskal të përshtatur për Shqipërinë është përgatitur nga Banka Botërore dhe është përcaktuar opsioni i preferuar për Shqipërinë.

Projektligji për Këshillin Fiskal, gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, ka qenë në proces shqyrtimi të brendshëm. Janë zhvilluar një sërë takimesh të dedikuara për diskutimin e dispozitave të tij, me fokus të veçantë në mandatin e Këshillit, strukturën e qeverisjes, pavarësinë dhe detyrimet e raportimit. Këto diskutime të brendshme synojnë të sigurojnë përafrimin me praktikën më të mira ndërkombëtare, të garantojnë transparencën fiskale dhe të krijojnë një bazë të qëndrueshme institucionale për rolin e ardhshëm të Këshillit.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Gjatë vitit 2025 nuk janë hasur sfida kryesore.

3.2 Progresi në Shtyllën 2 “Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent”

Është punuar për të përmirësuar më tej praktikën e planifikimit buxhetor dhe të monitorimit të zbatimit të buxhetit. Deri në fund të vitit 2025, u arritën 76.92% e objektivave të treguesve të performancës nën Shtyllën 2, 15.38% nuk u arritën, ndërsa për 7.69% të objektivave të dhënat nuk ishin të disponueshme në momentin e raportimit. Në përgjithësi, analiza tregon progres pozitiv në shumicën e fushave.

Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 2: Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent.

Tabela 3. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 2

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar				
1	Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së.	65% (2022)	85%	85%
2	Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të monitoruara përmes SIPI-t.	ND	40%	0%
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.2: Planifikimi Buxhetor Afatmesëm				
1	Treguesi PEFA 16 Perspektiva Afatmesme në buxhetimin e shpenzimeve	C+	B	C+
2	Treguesi SIGMA 6.7.1 Funksionimi i kontrollit të brendshëm (Lidhja ndërmjet strukturave menaxheriale dhe buxhetore) (%)	0/3 (2021)	Trend rritës	ND
3	Treguesi SIGMA 6.2.1 – Cilësia e procesit të buxhetit vjetor dhe besueshmëria e buxhetit (përafrimi operacional ndërmjet kuadrit buxhetor afatmesëm dhe procesit buxhetor vjetor)	2/4 (2021)	Trend rritës	ND
4	Vlerësimi i indeksit të buxhetit të hapur – pikët e pjesëmarrjes publike	6/100 (2021)	Trend rritës	9/100
5	Vlerësimi i indeksit të buxhetit të hapur – transparenca	52/100 (2021)	Trend rritës	57/100
6	Prezantimi i rishikimeve të shpenzimeve	-	Metodologjia është zhvilluar mbi bazë sektoriale.	Metodologjia përgatitur

			6	
7	Prezantimi i analizës së hendeikut gjinor si pjesë e BPGJ-së	-	BPGj pilotuar ⁷	BPGj pilotuar
8	Prezantimi i buxhetimit të gjelbërt të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike	-	Pilotimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm ndaj Ndryshimeve Klimatike ⁸	Pilotimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm ndaj Ndryshimeve Klimatike
9	Miratimi i DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare	(2022)	Bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe miratimi me VKM çdo fillim viti	Bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe miratimi me VKM çdo fillim viti
Objekti i Specifik (Komponenti) 2.3: Menaxhimi i Investimeve Publike				
2	Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes)	-	Zbatimi dhe përmirësimi i procedurave të MIP-së	Zbatimi dhe përmirësimi i procedurave të MIP-së
3	Pjesa e projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioritetëve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar)	82% (2020)	≥ 82%	96%
4	Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara, shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime	98% (2022)	≥ 98%	98.5%
5	Raporti i investimeve të reja publike të paraqitura brenda ciklit të PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit	74.2% (2022)	≥ 85%	82.4%
Objekti i Specifik (Komponenti) 2.4: Financat Vendore				
1	Formula e grantit e rregulluar bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë	n/a	Formula e grantit zbatohet për të gjitha NJVQV-të	Formula e përshtatur.
2	Prezantohet skema shtesë e granteve të bazuara në performancë (SGBP).	n/a	SGBP i pilotuar	Zbatuar në 2025
3	PEFA Treguesi i Performancës 7: Transferrat tek qeveria vendore	C+ (2017)	B	A
4	Përqindja e bashkive që përdorin <i>software</i> -in e ri SMBV	-	100%	100%
5	Përqindja e bashkive që publikojnë planet e performancës për ofrimin e shërbimeve	-	50%	80%
6	Përqindja e bashkive që publikojnë informacion mbi performancën e arritur nga ofrimi i shërbimeve.	-	50%	80%
7	Prezantimi nga MF i <i>Software</i> -it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe <i>e-Platformës</i>	-	<i>E-platforma</i> e mirëmbajtur	E-platforma plotësisht funksionale dhe gati për përdorim.
Objekti i Specifik (Komponenti) 2.5: Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit				

⁶ Rishikuar dhe miratuar në Takimin e 18-të të Komitetit Drejtues, mbajtur më 31 tetor 2024.


⁷ Rishikuar dhe miratuar në Takimin e 18-të të Komitetit Drejtues, mbajtur më 31 tetor 2024.

⁸ Rishikuar dhe miratuar në Takimin e 18-të të Komitetit Drejtues, mbajtur më 31 tetor 2024.

1	Treguesi i Performancës PEFA 28 “Raportet e buxhetit gjatë vitit”	D+ (2017)	B+	B+ ⁹
2	Publikimi i raporteve të zbatimit të buxhetit për qytetarët	-	Publikimi i raportit	Publikimi i raportit
3	Zhvillimi i një sistemi informacioni të dedikuar për monitorimin dhe raportimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare	-	Kontraktimi i sistemit të informacionit	Nuk ka filluar akoma
4	Numri i kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare	-	150	199

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025. Shumica e aktiviteteve (57.14%) ishin në rrugën e duhur ose të përfunduara, 34.29% u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur, ndërsa 8.57% e aktiviteteve nuk kishin filluar akoma.

Grafiku 7. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në shtyllën 2



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar

Treguesit e Performancës

Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të hartuara në përputhje me udhëzimet e SPI është rritur nga 75% në vitin 2024 në 85% në vitin 2025. Sa i përket përqindjes së strategjive dhe planeve të veprimit të monitoruara përmes SIPI, vlera e synuar nuk është arritur. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) ende nuk është plotësisht funksional, çka vijon të paraqesë sfida të konsiderueshme për monitorimin dhe raportimin sistematik të strategjive kombëtare dhe sektoriale.

Masat dhe aktivitetet

Aktivitetet që synojnë përmirësimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar, të mbështetur nga teknologjia e informacionit, për hartimin dhe monitorimin e strategjive, kanë qenë pjesërisht në rrugën e duhur. SPI është funksional dhe në masë të madhe efektiv, duke siguruar një cikël të rregullt

⁹ Vetëvlerësimi i DMB-së, i kryer në përputhje me metodologjinë PEFA, tregon një vlerësim B+ për vitin fiskal 2025 për raportet nën përgjegjësinë e DMB-së.

të planifikimit të politikave, koordinimit, raportimit dhe vendimmarrjes. Gjatë vitit 2025, Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) është mbledhur tetë (8) herë, duke miratuar çështje kyçe që lidhen me: Agjendën e Reformave të Shqipërisë në kontekstin e zbatimit dhe përgjigjes ndaj Instrumentit të ri të BE-së për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor 2024–2027; prezantimin e Planit të Buxhetit 2025 dhe tavanëve buxhetore për vitet 2026–2027; miratimin e objektivave kryesorë dhe afateve të përgatitjes së strategjive sektoriale; miratimin/rishikimin afatmesëm të Dokumentit të Politikave Prioritare dhe Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) 2026–2028; përfshirjen e projekteve strategjike në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP); si dhe miratimin e projekteve që do të financohen përmes instrumentit WBIF. SASPAC, në cilësinë e Sekretariatit Teknik, ka siguruar koherencën e politikave. Në nivel administrativ, GMIP-të, si mekanizma koordinimi, kanë qenë pjesërisht funksionale gjatë vitit 2025. SPI ka lidhur në mënyrë efektive prioritetet e politikave me procesin buxhetor përmes DPP-së dhe Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), si dhe ka siguruar përafrimin me SKZHIE 2022–2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), mbështetur nga udhëzimi metodologjik i vazhdueshëm i SASPAC.

Është përfunduar një shqyrtim paraprak i ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Shqyrtimi analizoi dispozitat kryesore që lidhen me programimin strategjik, monitorimin, përgjegjësitë e raportimit, si dhe lidhjet me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). Ai identifikoi boshllëqe dhe mbivendosje specifike që ndikojnë në konsistencën e planifikimit dhe raportimit ndërmjet institucioneve. Këto gjetje po përdoren për të përcaktuar përshtatje të synuara dhe masa vijuese, me qëllim forcimin e kuadrit të planifikimit të integruar.

Puna teknike për përmirësimin e SIPI është aktualisht në proces. Këto përpjekje synojnë të përmirësojnë integrimin e të dhënave në sistem, si dhe cilësinë e përgjithshme të monitorimit dhe raportimit strategjik. Gjatë periudhës së raportimit, është aplikuar monitorimi manual i strategjive për të siguruar vijimësinë e raportimit dhe përputhshmërinë me kërkesat e SPI-së. Kjo qasje u ka mundësuar institucioneve të vijnë ndjekjen e progresit dhe raportimin mbi objektivat strategjike, pavarësisht mungesës së përkohshme të një sistemi plotësisht funksional.

Gjatë periudhës së raportimit, u përfundua vlerësimi i nevojave për trajnim të nëpunësve civilë mbi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI). Vlerësimi identifikoi gjithashtu institucionet përkatëse dhe grupet e synuara me të cilat do të zbatohen aktivitetet e trajnimit gjatë periudhës pasuese të raportimit. Puna e SASPAC me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) vijon të jetë në proces, me qëllim mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të SIMAJ dhe të strukturës/planit të tij të raportimit, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përfutuese dhe komunitetin e donatorëve.

Progresi në zgjerimin e rishikimeve afatmesme dhe vlerësimeve ex-post të strategjive dhe planeve të veprimit ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur. SASPAC po harton manualin metodologjik për kryerjen e rishikimeve afatmesme dhe vlerësimeve ex-post të strategjive dhe planeve të veprimit.

Objektivi Specifik 2.2 Planifikimi Buxhetor Afatmesëm

Treguesit e Performancës

Sa i përket treguesit PEFA 16: “Perspektiva afatmesme në buxhetimin e shpenzimeve”, vlera faktike për vitin 2025 është vlerësuar me C+. Arsytet për këtë vlerësim janë si më poshtë: (i) Miratimi i tavanëve për fazën e parë të PBA-së pas miratimit të udhëzimit të buxhetit. Duke qenë se tavanet në nivel ministrie u miratuan nga Këshilli i Ministrave vetëm pasi ato ishin nxjerrë nga MF-ja, rezultati për këtë tregues është C. Nëse miratimi do të ishte dhënë përpara nxjerrjes së tyre, siç kërkohet nga kalendari i LOB-së, rezultati do të ishte A. Kjo është jashtë përgjegjësisë së MF-së, pasi tavanet u dorëzuan në kohë nga MF-ja dhe u vonuan nga KM-ja; (ii) Konsistenca e buxheteve me vlerësimet e

vitit të mëparshëm. Kjo lidhet kryesisht me ndryshimet në mjedisin makroekonomik dhe në performancën fiskale, si në anën e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve.

Sa i përket treguesit SIGMA 6.7.1 - Funksionimi i kontrollit të brendshëm (lidhja ndërmjet strukturave menaxheriale dhe buxhetore), të dhënat nuk ishin të disponueshme.

Treguesi SIGMA 6.2.1 - Cilësia e procesit të buxhetit vjetor dhe besueshmëria e buxhetit (përafrimi operacional ndërmjet kuadrit buxhetor afatmesëm dhe procesit buxhetor vjetor), nuk mund të vlerësohet më, pasi SIGMA ka ndryshuar metodologjinë e përdorur në vitin 2021. Ndërkohë, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor (DAPB) po punon për hartimin e udhëzimeve për publikimin e devijimeve të vlerësimeve buxhetore gjatë procesit buxhetor dhe do ta përdorë këtë qasje në raportet e ardhshme për vlerësimin e përputhshmërisë operationale ndërmjet PBA-së dhe buxhetit vjetor.

Sa i përket vlerësimit të Indeksit të Buxhetit të Hapur – pikët e pjesëmarrjes publike, Shqipëria shënoi një përmirësim të lehtë, duke u rritur nga 6 pikë në vitin 2021 në 9 pikë në vitin 2023. Ky progres pasqyron përparime graduale në krijimin e mundësive për angazhimin e publikut gjatë procesit buxhetor, megjithëse mekanizmat e pjesëmarrjes mbeten të kufizuar dhe vetëm pjesërisht funksionalë. Për të forcuar më tej përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, nevojiten përpjekje shtesë për institucionalizimin e praktikave pjesëmarrëse në të gjitha fazat e ciklit buxhetor dhe për të siguruar një angazhim më gjithëpërfshirës, të strukturuar dhe transparent me qytetarët dhe shoqërinë civile.

Sa i përket vlerësimit të Indeksit të Buxhetit të Hapur – transparenca, në Anketën e Buxhetit të Hapur 2023, rezultati i transparencës për Shqipërinë u rrit nga 52 në vitin 2021 në 57, duke pasqyruar progres të moderuar në përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit buxhetor, veçanërisht përmes publikimit në kohë të Raportit të Auditimit. Pavarësisht këtij përmirësimi, niveli i transparencës mbetet nën pragun prej 61 pikësh, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për të mundësuar debat publik të informuar. Për të forcuar më tej transparencën, Shqipëria duhet të rikthejë publikimin në kohë për publikun të Buxhetit për Qytetarët, të përmirësojë Projektbuxhetin e Ekzekutivit me parashikime gjithëpërfshirëse makroekonomike, informacion të detajuar mbi borxhin dhe shpenzimet tatimore, si dhe të përmirësojë plotësinë e Raporteve të Mesvitet dhe të Fundvitet, duke përfshirë krahasime më të qarta ndërmjet rezultateve fiskale dhe jofinanciare të planifikuara dhe atyre faktike.

Treguesi i performancës lidhur me prezantimin e rishikimeve të shpenzimeve është arritur. Metodologjia është përgatitur nga ekipi i asistencës teknike dhe aktualisht është në fazën e përkthimit. Ka pasur vonesa në përditësimin e saj nga asistencë teknike, për shkak të diskutimeve teknike, si dhe komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nga strukturat e brendshme të Ministrisë. Pavarësisht këtyre sfidave, drafti u finalizua nga ekipi i asistencës teknike brenda muajit dhjetor 2025. Menjëherë pas përfundimit të procesit të përkthimit, do të vijohet me shqyrtimin dhe përshtatjen e saj me legjislacionin kombëtar dhe më pas do t'i paraqitet Ministrit për miratim.

Metodologjia e **Analizës së Hendekut Gjinator u pilotua.** Të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet kryesore qendrore janë trajnuar dhe duhet të përgatisin analizën gjinore si pjesë e PBA-së së tyre.

Buxhetimi i gjelbër i përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike u pilotua. Pesë ministri të linjës janë trajnuar me mbështetjen e GIZ-it për të zbatuar masa për ndryshimet klimatike në kuadër të kërkesave të tyre buxhetore.

Sa i përket treguesit për miratimin e DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), është arritur bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe miratimi me VKM në fillim të çdo viti.

Masat dhe aktivitetet

Sa i përket masës “Përmirësimi i mëtejshëm i metodave, procedurave dhe llogaridhënies menaxheriale për formulimin e PBA-së”, një aktivitet është përfunduar, ndërsa tre janë në rrugën e duhur. Aktiviteti për Forcimin e konceptit të llogaridhënies menaxheriale në formulimin e

PBA-së është në vijim. Termat e referencës për përmirësimin e sistemit SIMFSh janë duke u hartuar. Megjithatë, aktiviteti që lidhet me Përhapja e kuadrit të përditësuar të llogaridhënies menaxheriale përmes pilotimeve, rritjes së aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe trajnimeve do të përfundojë pas përmirësimit të SIMFSh-it dhe ndryshimeve përkatëse në legjislacionin dytësor. Aktiviteti që synon përmirësimin e procedurave për seancat dëgjimore të buxhetit, ndërmjet MF-së dhe institucioneve buxhetore dhe përditësimin e kuadrit rregullator, ka përfunduar. Udhëzimi standard i rishikuar i buxhetit nr. 12, i miratuar më 18.10.2024, ka përmirësuar procesin e seancave dëgjimore buxhetore duke krijuar një procedurë standarde për dokumentimin e tyre, me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij procesi. Aktiviteti lidhur me prezantimin dhe rregullimin si pjesë e procedurave të PBA-së dhe dokumentacionit buxhetor i një pasqyre të devijimeve ndërmjet taveve të PBA-së dhe taveve buxhetore të miratuara nga parlamenti është pjesërisht në proces. Udhëzimi është përgatitur dhe koordinuar brenda Ministrisë së Financave me drejtoritë e tjera të përgjithshme në dhjetor 2025. Aktualisht, udhëzimi po koordinohet me BE-në. Përfaqësues nga DG ECFIN kanë dhënë komente dhe sugjerime, të cilat janë duke u diskutuar. Ky udhëzim do të përfshijë devijimet ndërmjet taveve të Buxhetit 2026 dhe taveve të PBA-së 2026-2028, së bashku me shpjegimet përkatëse, dhe pritet të miratohet.

Masa për përmirësimin e dokumentacionit buxhetor dhe në veçanti elementit të informacionit të performancës, është përfunduar gjatë periudhës mars-prill 2025, përmes një serie trajnimesh të organizuara në bashkëpunim me UN Women. Objektivi kryesor i seminareve ishte prezantimi i ndryshimeve në udhëzimin e ri lidhur me Analizën Gjinore, rritja e kapaciteteve të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore në këtë proces, si dhe përmirësimi i cilësisë së informacionit mbi performancën të paraqitur nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore gjatë planifikimit buxhetor.

Aktiviteti lidhur me prezantimin e rishikimeve të shpenzimeve është në rrugën e duhur¹⁰. Me mbështetjen e asistencës teknike të ofruar në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, është përfunduar hartimi i udhëzimit metodologjik për kryerjen e analizave të shpenzimeve në Shqipëri. Udhëzimi është pasuruar më tej me një paketë të detajuar instrumentesh analitike, e cila përcakton metodat dhe qasjet që mund të zbatohen gjatë proceseve të analizës së shpenzimeve, me qëllim standardizimin e praktikave analitike në të gjitha institucionet qeveritare.

Dokumenti aktualisht është në proces përkthimi, për të mundësuar rishikimin gjuhësor dhe teknik, si dhe për të siguruar përputhshmërinë e plotë me kuadrin ligjor kombëtar dhe praktikën administrative. Pas finalizimit të draftit, do të organizohet një prezantim i metodologjisë së propozuar për Ministrin e Financave, me qëllim sigurimin e miratimit paraprak dhe vijimin drejt miratimit formal të saj.

Sa i përket masës për zhvillimin dhe prezantimin e mëtejshëm të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm ndaj klimës, aktiviteti lidhur me rishikimin e metodologjisë buxhetore për të përfshirë analizën gjinore ex ante dhe ex post si një procedurë që duhet të ndërmerret nga ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore në procesin e propozimit të Nismave të Reja Politike është në rrugën e duhur¹¹. Udhëzimi standard i rishikuar për përgatitjen e PBA-së, i miratuar në tetor 2024, është në përputhje me ndryshimet e ligjit të ri për barazinë gjinore. Ky ligj e bën të detyrueshme Vlerësimin e Ndikimit Gjinor për të gjitha nismat e reja politike. Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore” u miratua nga Kuvendi më 6 nëntor 2025. Aktiviteti që synon ngritjen e kapaciteteve të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore për kryerjen e analizës gjinore ex ante dhe ex post u përfundua gjatë muajit tetor 2025. Me asistencën e UN Women, është organizuar një tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

¹⁰ Afatet kohore të aktiviteteve të lidhura me treguesit e performancës, të rishikuara në Mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së (31 tetor 2024), janë ndikuar në përputhje me rrethanat.

¹¹ Afatet kohore të aktiviteteve të lidhura me treguesit e performancës, të rishikuara në Mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së (31 tetor 2024), janë ndikuar në përputhje me rrethanat.

Sociale, me qëllim rritjen e kapaciteteve të ministrive udhëheqëse në procesin e kryerjes së analizës gjinore ex ante dhe ex post.

Objektivi Specifik 2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike

Treguesit e Performancës

Treguesi i performancës “Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes)” është arritur. Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP) janë zbatuar në mënyrë efektive, duke pasqyruar progres në forcimin e praktikave të menaxhimit të investimeve publike. Konkretisht, në vitin 2025, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 887, datë 27 dhjetor 2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, u ndryshua më tej me VKM nr. 180, datë 20 mars 2025, me qëllim forcimin dhe disiplinimin e mëtejshëm të procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike. Kuadri ligjor i përcaktuar me VKM nr. 887 u plotësua më tej përmes nxjerrjes së Udhëzimit nr. 11 të Ministrit të Financave, datë 28 maj 2025, “Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit”. Gjithashtu, u miratua Udhëzimi nr. 22, datë 15 shtator 2025, “Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit, duke forcuar kështu funksionin e kontrollit paraprak të Ministrisë së Financave dhe duke rritur kapacitetin e saj mbikëqyrës mbi proceset e investimeve publike.

Sa i përket pjesës së projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioriteteve strategjike të qeverisë (vlera e projekteve në një vit të caktuar), vlera faktike për vitin 2025 është 96%. Ky tregues matet si raport ndërmjet shumës totale të investimeve publike që pasqyrojnë prioritetet strategjike dhe shumës totale të projekteve të investimeve.

Sa i përket disbursimeve aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara, shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime, vlera faktike për vitin 2025 është 98.5%. Ky tregues matet si raport ndërmjet disbursimit total vjetor të projekteve të investimeve dhe buxhetit total vjetor të planifikuar për projektet përkatëse.

Sa i përket Raporti i investimeve të reja publike të paraqitura brenda ciklit të PBA-së kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit, vlera faktike për vitin 2025 është 82.4%.

Masat dhe aktivitetet

Sa i përket masës “Operacionalizimi i procedurave për përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike”, aktiviteti “Përmirësimi i modulit MIP të SIMFSH-së për të pasqyruar ndryshimet në procedurat e reja MIP (VKM nr. 887)” ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur. Moduli i MIP-it në SIMFSH do të përditësohet, duke mundësuar mbikëqyrjen e aktiviteteve brenda sistemit. Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t nr. 359, datë 05.11.2024, është ngritur një grup pune dhe po ndiqen kërkesa konkrete për ndryshime (Gov-Tech2). Aktiviteti “Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve për zbatimin e procedurave të MIP-së (VKM nr. 887)” ka qenë në rrugën e duhur. Të gjitha sesionet e trajnimit me ministrinë e linjës dhe institucionet buxhetore u përfunduan plotësisht (100%) deri në muajin janar, dhe u arrit një marrëveshje me Bankën Botërore për vijimin e këtij cikli trajnimesh gjatë gjithë vitit 2025, në bashkëpunim me ASPA dhe Bankën Botërore. Gjatë periudhës janar–maj 2025, u zhvilluan dy sesione trajnimi me temën “Procedurat e reja në fushën e investimeve publike”, përmes të cilave u trajnuan 57 pjesëmarrës, me gjithsej 24 orë trajnimi të ofruara. Gjithashtu, gjatë periudhës korrik–gusht 2025, u zhvilluan dy sesione të tjera trajnimi me institucione të ndryshme të administratës publike, në bashkëpunim me ASPA-n, me fokus menaxhimin e investimeve publike. Në bashkëpunim me ASPA-n dhe Bankën Botërore, u ra dakord gjithashtu që ky cikël aktivitetesh trajnimi të vijojë edhe gjatë vitit 2026. Aktiviteti “Monitorimi i zbatimit të procedurave të MIP-së; rishikimi dhe përditësimi i

vendimit për procedurat e MIP-së nëse është e nevojshme” është përfunduar. Njësitë e qeverisjes qendrore raportojnë pranë strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në Ministrinë e Financave, sipas aneksit nr. 2 të Vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i cili u ndryshua më tej me VKM nr. 180, datë 20 mars 2025, me qëllim forcimin dhe disiplinimin e mëtejshëm të procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike.

Sa i përket masës për Forcimi i Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) dhe rritja e rolit gatekeeper të Ministrisë së Financave, aktiviteti për zhvillimin dhe zbatimin e një plani për të përmirësuar më tej konceptin e Listës Unike të Projekteve dhe rolin gatekeeper të MF-së është përfunduar. Kuadri ligjor i VKM-së nr. 887 u plotësua me nxjerrjen e Udhëzimit nr. 11 të Ministrit të Financave, datë 28 maj 2025, “Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit”. Kjo masë prezantoi kufij më të lartë financiarë për përfshirjen e projekteve në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), duke e përafuar kështu përzgjedhjen e projekteve më ngushtë me prioritetet sektoriale dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). Konkretisht, 25 milionë euro për projektet e transportit dhe 15 milionë euro për projektet në sektorë të tjerë strategjikë, si energjia, digjitalizimi, zhvillimi social dhe mjedisi. Kjo siguron që portofoli i projekteve të mbetet i fokusuar në operacione strategjike me ndikim të lartë. Më tej, u miratua Udhëzimi nr. 22, datë 15 shtator 2025, “Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit”, duke forcuar rolin “gatekeeper” të Ministrisë së Financave dhe duke rritur kapacitetin e saj mbikëqyrës mbi investimet publike.

Gjithashtu, nxjerrja e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC nr. 446, datë 23.12.2025, “Për miratimin e formës, afatit dhe mënyrës së plotësimit të formularit të përditësimit të ecurisë së projekteve të investimit që janë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare”, plotëson më tej kuadrin ligjor dhe procedural.

Në kuadër të integritetit të projekteve të financuara përmes PPP-ve në procedurat e menaxhimit të investimeve publike, është miratuar Ligji nr. 88/2025 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”. Për më tepër, bashkëpunimi me projektin EU4GG është në vijim, me qëllim përmirësimin e formateve ekzistuese të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) dhe përafrimin e tyre me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Objektivi Specifik 2.4 Financat Vendore

Treguesit e Performancës

Në vitin 2025, formula për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026 u përditësua duke përdorur të dhënat e reja nga Censi. DFV do të vijojë të punojë edhe gjatë vitit 2026 për rishikimin dhe përmirësimin e formulës.

Sa i përket prezantimit të skemës shitesë të granteve të bazuara në performancë (SGBP), në vitin 2025 u zbatua SGBP-ja. Skema e grantit është pjesë e ligjit të buxhetit për vitin 2025. Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor “Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025” është miratuar.

Sa i përket treguesit “**Treguesi i Performancës PEFA 7: Transfertat tek qeveria vendore**”, sipas vlerësimit më të fundit PEFA, rezultati është A.

Përqindja e bashkive që përdorin software-in e ri SMBV është 100%. 61 bashki dhe 12 qarqe kanë përdorur sistemin online të menaxhimit të buxhetit vendor. Në vitin 2025, DFV-ja ka punuar gjithashtu për modulin e monitorimit në SMBV, i cili do të jetë pjesë e sistemit online.

.3Sa i përket treguesit “**Përqindja e bashkive që publikojnë planet e performancës për ofrimin e shërbimeve**”, në dokumentin e PBA-së 2026-2028, rreth 80% e bashkive kanë paraqitur informacion për treguesit e performancës, për të gjitha programet buxhetore që lidhen me ofrimin e shërbimeve.

Sa i përket treguesit **“Përqindja e bashkive që publikojnë informacion mbi performancën e arritur nga ofrimi i shërbimeve”**, në dokumentin e PBA-së 2026-2028, rreth 80% e bashkive kanë paraqitur informacion për treguesit e performancës, për të gjitha programet buxhetore që lidhen me ofrimin e shërbimeve.

Në lidhje me treguesin **“Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe e-Platformës”**, në vitin 2025, sistemi i ri online është plotësisht funksional dhe është prezantuar në të gjitha bashkitë. Janë zhvilluar takime rajonale për trajnimin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve lidhur me përdorimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Buxhetit për përgatitjen e PBA-së 2026-2028.

Masat dhe aktivitetet

Sa i përket masës për **përmirësimin e formulës së granteve dhe sistemit të llogaritjes për qeverisjen vendore**, në vitin 2025 u përfundua aktiviteti **“Rishikimi dhe përditësimi i formulës së transfertave të pakushtëzuara, duke përdorur të dhëna të reja të bazuara në regjistrimin e popullsisë”**. Në vitin 2025, formula për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026 u përditësua me të dhënat e reja të Censit. DFV-ja do të vijojë të punojë edhe gjatë vitit 2026 për rishikimin dhe përmirësimin e formulës, në varësi të vendimeve të Komisionit Parlamentar për reformën e re administrativo-territoriale. Aktiviteti **“Zhvillimi dhe zbatimi gradual i një sistemi shtesë grantesh të bazuara në performancë, të bazuar në tregues të matshëm dhe të verifikueshëm”** ishte në rrugën e duhur. Skema e grantit është pjesë e ligjit të buxhetit për vitin 2025. Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor **“Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”** është miratuar. Në fund të muajit shtator, bashkitë aplikuan sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzim për përfitim të grantit. Në dhjetor 2025, granti iu transferua bashkive. Aktiviteti **“Rishikimi dhe nëse është e nevojshme përditësimi i mekanizmit/formulës së grantit, në lidhje me qeverisjen vendore dhe reformat e decentralizimit”** ishte pjesërisht në rrugën e duhur. Ai është në fazë diskutimi lidhur me treguesit që mund të ndryshojnë në llogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar.

Sa i përket **“Forcimi i formulimit dhe monitorimit të zbatimit të PBA-së në bashki”**, të gjitha aktivitetet ishin në proces. Udhëzimi për PBA-në 2026-2028 është përgatitur, pjesë e të cilit është edhe sistemi i ri online për përgatitjen e PBA-së në nivel vendor, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV). Është hartuar gjithashtu lista e produkteve standarde për bashkitë pilot. Përshkrimi i programeve të klasifikimeve buxhetore është standardizuar përmes sistemit të ri online. Moduli i monitorimit për ekzekutimin e buxhetit në SMBV është pjesë e sistemit online në vitin 2025. Bashkitë kanë filluar të përgatisin raportet e monitorimit për vitin 2025 përmes sistemit online dhe formateve përkatëse. Në vitin 2025, në procesin e PBA-së 2026-2028, të gjitha bashkitë kanë përdorur tregues të performancës. Janë përfshirë 5 bashki të reja dhe 3 qarqe për buxhetimin dhe hartimin e PBA-së me metodologjinë e re deri në nivel produkti. Me shtimin e 6 bashkive të reja për vitin 2025, 18 bashki dhe 3 qarqe do të zbatojnë metodologjinë e re të buxhetimit. MF-ja ka organizuar sesione trajnimi rajonale me të gjithë drejtorët e buxhetit të bashkive.

Sistemi i ri i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) është zhvilluar dhe testuar. Bashkitë kanë vijuar të përdorin software-in SMBV edhe në përgatitjen e PBA-së 2026-2028. Përdorimi i formateve dhe proceseve standarde do t'i ndihmojë ato për zbatimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSH) në të ardhmen.

Masa për Përmirësimin e nivelit të burimeve financiare nga taksat e ndara ende nuk ka filluar.

Objektivi Specifik 2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit

Treguesit e Performancës

Sa i përket treguesit “**Treguesi i Performancës PEFA 28 “Raportet e buxhetit gjatë vitit”**”, bazuar në Vlerësimin PEFA, për vitin financiar 2025 vlera faktike që lidhet vetëm me raportet nën përgjegjësinë e Departamentit të Buxhetit do të ishte B+, bazuar në argumentet e detajuara të paraqitura më poshtë:

- Sa i përket Dimensionit 28.1 – Mbulimi dhe krahasueshmëria e raporteve, rezultati i përshtatshëm duhet të jetë A, pasi për Drejtorinë e Buxhetit përmbushet kriteri i mëposhtëm: “Mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave mundëson krahasimin e drejtpërdrejtë me buxhetin fillestar. Informacioni përfshin të gjithë zërat e vlerësimeve buxhetore. Shpenzimet e kryera nga transfertat për njësitë e dekoncentruara brenda qeverisjes qendrore përfshihen në raporte”. Ky vlerësim mbështetet në faktin se DMB-ja publikon raporte tremujore të konsoliduara, të cilat përmbushin plotësisht kërkesat për rezultatin A sipas këtij dimensionit.
- Sa i përket Dimensionit 28.2 – Afatet e raporteve buxhetore gjatë vitit, vlerësimi mbetet B, në përputhje me vlerësimin e mëparshëm.
- Sa i përket Dimensionit 28.3 – Saktësia e raporteve buxhetore gjatë vitit, rezultati duhet të jetë B, pasi përmbushen kriteret e mëposhtme: “Mund të ketë shqetësime lidhur me saktësinë e të dhënave. Problematikat e të dhënave evidentohen në raport, dhe të dhënat janë të qëndrueshme dhe të dobishme për analizën e ekzekutimit të buxhetit. Një analizë e ekzekutimit të buxhetit ofrohet të paktën në bazë gjashtëmujore. Shpenzimet regjistrohen të paktën në fazën e pagesës”.

Në këto kushte dhe duke marrë në konsideratë se metodologjia PEFA aplikon metodën M1 (hallka më e dobët) për agregimin, rezultati i përgjithshëm për këtë tregues është me siguri B+.

Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit koordinoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Tatimore, Drejtorinë e Përgjithshme të Programimit Makroekonomik dhe Fiskal dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për mbledhjen e raporteve periodike relevante për ekzekutimin e buxhetit. Bazuar në kontributet e marra, u përgatit një tabelë e konsoliduar e përditësuar, me qëllim sigurimin e një raportimi gjithëpërfshirës në të ardhmen.

Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët 2024 është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.¹²

Zhvillimi i një sistemi informacioni të dedikuar për monitorimin dhe raportimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare nuk është arritur.

Sa i përket treguesit “**Numri i kontratave PPP të mbuluara në raportin vjetor të përmbledhur për PPP-të dhe kontratat koncesionare**”, për vitin 2024, Raporti Vjetor Përmbledhës përmban 199 kontrata koncesionare.

Masat dhe aktivitetet

Masa për përmirësimin e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe prezantimin e raportit të Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët është përfunduar. Për herë të parë këtë vit, Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët për vitin 2024 është përgatitur dhe publikuar si pjesë e Raportit Vjetor të Zbatimit të Buxhetit. Në vijim, ky raport do të përgatitet dhe publikohet çdo vit.

Është e rëndësishme të sqarohet se për këtë masë nuk nevojiten ndryshime ligjore. Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët është hartuar për të komunikuar informacionin financiar thelbësor që paraqitet në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit. Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarët për vitin 2024 është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.¹³

Për monitorimin dhe raportimin për projektet e investimeve publike, aktiviteti për përshtatjen e SIMFSH për të pasqyruar ndryshimet në lidhje me procedurat e MIP të miratuara rishtazi ka qenë pjesërisht në rrugën e duhur. Fillimisht, përfundimi i tij ishte planifikuar brenda vitit 2024. Megjithatë, gjatë vitit 2024, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 887/2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” u ndryshua, duke krijuar nevojën për përmirësime në modulën MIP (Menaxhimi

¹² <https://financa.gov.al/buxheti-faktik-per-qytetaret/>

¹³ <https://financa.gov.al/buxheti-faktik-per-qytetaret/>

i Investimeve Publike). Gjithashtu, gjatë gjithë vitit 2024, u zhvilluan negociata të vazhdueshme me Bankën Botërore lidhur me zbatimin e kësaj mase. Pas marrëveshjes së arritur me Bankën Botërore, finalizimi i këtij procesi do të realizohet në kuadër të projektit GovTech-2. Në këtë kontekst, është negociuar një kredi me Bankën Botërore për mbështetjen e projektit, e cila mbulon disa fusha, përfshirë edhe ndryshimet në modulën MIP–SIMFSH. Që nga fillimi i vitit 2025, diskutimet me Bankën Botërore kanë vijuar për të siguruar zbatimin me sukses të këtij programi. Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike ka përcjellë kërkesat përkatëse të anëtarët e grupit të punës të ngritur me qëllim analizimin e problematikave të identifikuara dhe propozimin e rishikimeve. Sa i përket aktiviteteve të Planifikimit dhe ofrimit të aktiviteteve trajnuese për monitorimin dhe raportimin e projekteve të investimeve publike, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe ASPA-n, është rënë dakord që sesionet e trajnimit, të cilat kanë qenë në vijim që prej vitit 2024, të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 2026.

Sa i përket masës për përmirësimin e monitorimit dhe raportimit për PPP-të dhe kontratat koncesionare, Ligji nr. 88/2025 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” u miratua nga Kuvendi më 12 dhjetor 2025. Ndryshimet në Udhëzimin nr. 35/2019 duhet të përfundojnë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit dhe puna paraprake për hartimin e projektudhëzimit është në vijim.

Të dy aktivitetet: zhvillimi i një sistemi informacioni të dedikuar për monitorimin dhe raportimin për PPP-të dhe kontratat koncesionare; si dhe planifikimi dhe ofrimi i aktiviteteve trajnuese për nëpunësit civilë përgjegjës, për monitorimin dhe raportimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare, ende nuk kanë filluar. Sa i përket aktiviteteve të trajnimit, ato do të realizohen pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe miratimit të Udhëzimit nr. 35.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nën Shtyllën 2, janë identifikuar disa sfida në zbatimin e masave të planifikuara. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) nuk është ende plotësisht funksional, gjë që vijon të paraqesë sfida të konsiderueshme për monitorimin dhe raportimin sistematik të strategjive kombëtare dhe sektoriale. Në mungesë të një SIPI funksional, institucionet mbeten kryesisht të varura nga procese manuale dhe të fragmentuara raportimi, çka rrit riskun e mospërfundimit, boshllëqeve në të dhëna dhe vonesave në konsolidimin e informacionit strategjik. Kjo situatë kufizon besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave të performancës ndërmjet institucioneve dhe dobëson bazën e përgjithshme të evidencave për monitorimin e zbatimit të politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Statusi jofunksional i SIPI-t ka gjithashtu ndikime të drejtpërdrejta në cilësinë e lidhjes ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetimit afatmesëm. Pa një platformë digjitale të integruar, monitorimi i objektivave strategjikë dhe përputhshmëria e tyre me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) nuk mund të realizohen në mënyrë sistematike dhe të automatizuar. Si rezultat, raportimi i bazuar në performancë mbetet i dobët dhe përdorimi i të dhënave të monitorimit strategjik për të informuar vendimmarrjen buxhetore është i kufizuar. Kjo krijon risqe brenda kuadrit të Menaxhimit të Financave Publike (MFP), veçanërisht sa i përket sigurimit të koherencës ndërmjet prioritetëve të politikave, shpërndarjes së burimeve dhe rezultateve të arritura.

Në këtë kontekst, zhvillimi i sistemeve ekzistuese, si Sistemi Informatik për Menaxhimin e Asistencës së Jashtme (SIMAJ), është me rëndësi kritike. Vizioni përpara për SIMAJ është që të shkojë përtej rolit aktual si bazë të dhënash raportimi dhe të zhvillohet në një platformë gjithëpërfshirëse për vendimmarrje strategjike dhe koordinim. Ky transformim do të përfshinte integrimin e plotë me sistemin kombëtar të planifikimit dhe buxhetimit, mbështetje të përmirësuar për koordinimin dhe besimin e donatorëve, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë. Një peizazh sistemesh më i integruar dhe ndërveprues, i mbështetur në një SIPI plotësisht funksional dhe në një SIMAJ të përmirësuar, do të përmirësonte ndjeshëm monitorimin strategjik, planifikimin fiskal dhe vendimmarrjen e informuar në të gjithë qeverinë. Përmirësimi i modulit MIP në SIMFSH, i planifikuar fillimisht për vitin 2024, është shtyrë. Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

AKSHI-t nr. 359, datë 05.11.2024, është ngritur një grup pune dhe po ndiqen kërkesa konkrete për ndryshime (Gov-Tech2). Në fushën e financave vendore, aktiviteti “Rishikimi dhe, nëse është e nevojshme, përditësimi i mekanizmit/formulës së grantit në lidhje me reformat e qeverisjes vendore dhe decentralizimit” ishte pjesërisht në rrugën e duhur, pasi është në fazë diskutimi lidhur me treguesit që mund të ndryshojnë në llogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar. Masa për përmirësimin e nivelit të burimeve financiare nga taksat e ndara ende nuk ka filluar. Në fushën e monitorimit dhe raportimit të ekzekutimit të buxhetit, të dyja aktivitetet: zhvillimi i një sistemi të dedikuar informacioni për monitorimin dhe raportimin mbi PPP-të dhe kontratat koncesionare; si dhe planifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit për nëpunësit civilë përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e kontratave PPP dhe koncesionare, ende nuk kanë filluar.

3.3 Progresi në Shtyllën 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave”

Reformat që synojnë përmirësimin e sistemeve për mobilizimin dhe menaxhimin e të ardhurave kanë vazhduar gjatë vitit 2025 në përputhje me planin e veprimit të MFP-së, Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) dhe Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare. Deri në fund të vitit 2025, **62.5%** e objektivave të treguesve të performancës për Shtyllën 3 u arritën, **25%** u arritën pjesërisht dhe **12.5%** nuk u arritën. Tabela më poshtë përmbledh statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave.

Tabela 4. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 3

Treguesi		Viti bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.1: Menaxhimi i taksave				
1	Rritja e të hyrave nga SSA (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së)	(2023) 0.57% e PBB	0.62% e PBB rritje në krahasim me vitin 2024	0.76% rritje në krahasim me vitin 2024
2	Rritja e të hyrave nga TVSH-ja (e matur në bazë jokumulative)	(2023) 1,98% e PBB	0.2% e PPB rritje në krahasim me vitin 2024	0.35% të PBB-së rritje në krahasim me vitin 2024
3	Rritja e të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeklaruar dhe të padeklaruar (e matur në bazë jokumulative) si rezultat i futjes së 40 mijë punonjësve të rinj në skemë dhe rritja e deklarimit të pagës së 120 mijë punonjësve, sipas kalendarit të rritjes në SAA	(2023) 0.08 e PBB	0.05% të PBB-së rritje në krahasim me vitin 2024	0.26% të PBB-së rritje në krahasim me vitin 2024
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.2: Menaxhimi i taksës së pasurisë				
1	Hartimi dhe miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë ¹⁴	-	Miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë ¹⁵	Projektligji parashikohet t'i paraqitet për shqyrtim Këshillit të Ministrave brenda muajit qershor 2026.


¹⁴ Ligji “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” i përgatitur dhe i miratuar.

¹⁵ Ligji për taksën mbi pasurinë e paluajtshme i miratuar.

2	Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për taksën mbi pasurinë ¹⁶	-	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore	Pasi projektligji të miratohet nga Kuvendi dhe të hyjë në fuqi, puna do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve përkatëse nënligjore. Ndërkohë, për të përmirësuar dhe qartësuar më tej kuadrin ligjor aktual në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë hartuar ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese. Deri në fund të vitit 2025, u miratua vetëm një nga projekt VKM-të ndryshuese, ndërkohë që projekt VKM-të e tjera ndryshuese ishin në proces miratimi.
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.3: Menaxhimi Doganor				
1	Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjellbër	-	33%	33.13%
2	Koha e përpunimit të deklaratës doganore	-	Trend rënës	101 min
3	Numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar	-	Trend rritës	18

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifiluara për vitin 2025. Pjesa më e madhe e aktiviteteve (80.95%) ishin ose në rrugën e duhur ose të përfunduara, ndërsa 19.05% u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur.

Grafiku 8. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në shtyllën 3



¹⁶ Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme” të miratuara.

Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 3.1 Menaxhimi i Taksave

Treguesit e Performancës

Qeveria vijoi të çojë përpara reformat në administratën tatimore dhe zbatimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) gjatë gjithë vitit 2025.

Sa i përket rritjes të të hyrave nga SSA-ja (në total nga administrata tatimore dhe doganore sipas SAA-së), të ardhurat shtesë nga SAA-ja, që mbulojnë si administratën tatimore ashtu edhe atë doganore, arritën në 0.76% të PBB-së, duke tejkaluar parashikimin fillestar prej 0.62%. Kjo performancë e fortë u nxit kryesisht nga progresi në uljen e hendekut të pajtueshmërisë së TVSH-së dhe zbatimi i masave për frenimin e informalitetit në tregun e punës, përfshirë uljen e punësimit të padeklaruar dhe të nëndeklaruar. Këto përpjekje kontribuan në rritjen e të ardhurave nga TVSH-ja vendase, si dhe në rritjen e të ardhurave nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Treguesit kryesorë lidhur me TVSH-në dhe kontributet shoqërore performuan ndjeshëm mbi pritshmëritë, të mbështetur nga përmirësimi i pajtueshmërisë dhe zgjerimi i bazës së tatimpaguesve.

Sa i përket rritjes së të hyrave nga TVSH-ja, për vitin 2025, strategjia parashikonte një rritje prej rreth 0.21% të PBB-së në të ardhurat e brendshme neto nga TVSH-ja krahasuar me vitin e mëparshëm. Ky objektivi jo vetëm që u arrit, por edhe u tejkalua, me të ardhurat e brendshme neto nga TVSH-ja që u rritën me rreth 0.35% të PBB-së në terma vjetorë.

Sa i përket rritjes së të ardhurave nga reduktimi i punës së nëndeklaruar dhe të padeklaruar, të ardhurat nga kontributet shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat personale u rritën me rreth 0.26% të PBB-së, krahasuar me një parashikim fillestar prej rreth 0.05%.

Masat dhe aktivitetet

Me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale për të analizuar dhe zhvilluar politikat tatimore dhe për të menaxhuar reformat tatimore, u arrit progres i konsiderueshëm përmes asistencës teknike nga FMN-ja dhe Banka Botërore. Një arritje kryesore ishte përgatitja e Raportit të Shpenzimeve Tatimore në qershor 2025, si dhe pjesëmarrja për herë të parë në projektin e BE-së për Hendekun e TVSH-së, duke kontribuar në përafrimin me standardet evropiane.

Me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave për të reduktuar hendekun e pajtueshmërisë së TVSH-së, funksionaliteti i plotë i Komitetit të Riskut u vendos me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 42, datë 23.02.2023. Gjatë vitit 2025, u zhvilluan 13 mbledhje të Komitetit të Riskut, ku u diskutuan 143 fenomene dhe u shqyrtuan mesatarisht 11 çështje për çdo vendimmarrje. Plani Sektorial i Turizmit u miratua dhe u zbatua gjatë periudhës qershor-shtator 2025. Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të informalitetit në tregun e punës dhe riskut të evazionit të TVSH-së, me qëllim zgjerimin e bazës së tatueshme të tatimpaguesve të TVSH-së. Të dhënat e fiskalizimit përdoren periodikisht dhe gjithnjë e më shumë për identifikimin e mospaguesve të TVSH-së. Në prill 2025, u bë e mundur paraplotësimi i deklaratave të TVSH-së me të dhënat e fiskalizimit dhe, pas paraplotësimit të Librave të Blerjeve/Shitjeve në vitin 2024, u finalizua i gjithë procesi nga faturimi elektronik deri te gjenerimi paraprak i deklaratës së TVSH-së. Krahasimi i të ardhurave nga TVSH-ja për vitin 2024 kundrejt vitit 2025 rezulton në një rritje prej rreth 14.43%, ose rreth 122 milionë euro më shumë.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar ka kryer detyrat funksionale, në përputhje me objektivat strategjike të administratës tatimore, **me qëllim sigurimin e taksimit të çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit.** Vlerësimet për 911 individë (informacion nga DMR) i janë dërguar çdo DRT-je lidhur me DIVA 2023 për të gjithë individët që kanë shmangur tatimin e paguar.

Pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. 1873, datë 05.02.2025, dhe analizimit të informacionit, u hartua dhe u miratua një plan për kontrollin e 100 individëve deri në fund të vitit 2025. Gjithashtu, janë dërguar vlerësime për individët që zotërojnë automjete luksoze dhe nuk rezultojnë në sistemin tatimor.

Të gjitha aktivitetet që kontribuojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit kanë qenë në rrugën e duhur. Në bashkëpunim me AST – Agjencia Suedeze e Taksave, DPT ka përfunduar hartimin e Strategjisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, e cila u miratua nga Komiteti i Reformës së Administratës Tatimore me Vendimin nr. 38, datë 8 janar 2026. Qendra e thirrjeve është plotësisht funksionale dhe është përfshirë në të gjitha nismat e administratës tatimore që lidhen me nxitjen e vetëpërbushjes nga tatimpaguesit, kryesisht në uljen e borxhit tatimor, zgjerimin e bazës së tatueshme të TVSH-së dhe zbatimin e planit sektorial të turizmit. DPT po punon me Agjencinë Suedeze të Taksave në një projekt që do të rrisë cilësinë e këtij shërbimi në të ardhmen. Administrata tatimore ka një sërë nismash të vazhdueshme trajnimi lidhur me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Këto përfshijnë programe trajnimi të ofruara nga QTATD, CEF, FMN, AIOTA dhe TAIEK; bashkëpunimin me AST (Agjencia Suedeze e Taksave); si dhe projektin e financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar.

Objektivi Specifik 3.2 Menaxhimi i Taksës së Pasurisë

Treguesit e Performancës

Lidhur me Menaxhimin e Taksës së Pasurisë, të dy treguesit e performancës janë arritur pjesërisht.

Sa i përket hartimit dhe miratimit të ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme, bazuar në vendimmarrjen e niveleve më të larta drejtuese në Ministrinë e Financave, projektligji parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave brenda muajit qershor 2026. Pas miratimit të projektligjit nga Kuvendi dhe hyrjes së tij në fuqi, do të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse. Për më tepër, me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 39, datë 11.02.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit ‘Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme’”, është ngritur një grup pune i cili do të shqyrtojë versionin e mëparshëm të projektligjit *(të hartuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe projektin “ProTax Albania”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA))*, si dhe do të bëjë ndryshimet e nevojshme në të. Gjithashtu, grupi i punës do të hartojë ndryshimet që ky projektligj mund të pësojë pas vendimmarrjes përfundimtare të Ministrisë së Financave dhe pas përfundimit të procesit të konsultimit të brendshëm me institucionet shtetërore. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë sqaron se Ministria e Financave është institucioni përgjegjës për vendimmarrjen e mëtejshme lidhur me procesin e konsultimit të brendshëm me institucionet shtetërore dhe miratimin e projektligjit “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”.

Sa i përket miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme, pasi projektligji të miratohet nga Kuvendi dhe hyjë në fuqi, puna do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse.

Ndërkohë, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e mëtejshëm të kuadrit aktual ligjor në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë hartuar ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese. Deri në fund të vitit 2025, vetëm një nga projektvendimet ndryshuese të Këshillit të Ministrave ishte miratuar, ndërkohë që projektvendimet e tjera ndryshuese të Këshillit të Ministrave ishin në proces miratimi.

Masat dhe aktivitetet

Të gjitha aktivitetet që kontribuojnë në përmirësimin e kadastrës fiskale dhe të sistemit të mbledhjes së taksës mbi pasurinë e paluajtshme kanë qenë në rrugën e duhur, me përjashtim të

aktivitetit që lidhet me zhvillimin dhe miratimin e kuadrit ligjor (ligj dhe akte nënligjore) për kadastrën fiskale dhe taksën mbi tokën dhe pasurinë e paluajtshme, si dhe aktit nënligjor për vlerësimin e tokës dhe pasurisë së paluajtshme, që është pjesërisht në rrugën e duhur. Bazuar në vendimmarrjen e niveleve më të larta drejtuese në Ministrinë e Financave, projektligji parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave brenda muajit qershor 2026. Pas miratimit të projektligjit nga Kuvendi dhe hyrjes së tij në fuqi, do të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse. Për më tepër, me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 39, datë 11.02.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit ‘Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme’”, është ngritur një grup pune, i cili do të shqyrtojë versionin e mëparshëm të projektligjit (*të hartuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe projektin “ProTax Albania”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA)*), si dhe do të bëjë ndryshimet e nevojshme në të. Gjithashtu, grupi i punës do të hartojë ndryshimet që ky projektligj mund të pësojë pas vendimmarrjes përfundimtare të Ministrisë së Financave dhe pas përfundimit të procesit të konsultimit të brendshëm me institucionet shtetërore. DPTP sqaron se Ministria e Financave është institucioni përgjegjës për vendimmarrjen e mëtejshme lidhur me procesin e konsultimit të brendshëm me institucionet shtetërore dhe miratimin e projektligjit “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”. Pas miratimit të projektligjit nga Kuvendi dhe hyrjes së tij në fuqi, puna do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse. Ndërkohë, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e mëtejshëm të kuadrit aktual ligjor në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë hartuar ndryshime në aktet nënligjore ekzistuese. Deri në fund të vitit 2025, vetëm një nga projektvendimet ndryshuese të Këshillit të Ministrave ishte miratuar, ndërkohë që projektvendimet e tjera ndryshuese të Këshillit të Ministrave ishin në proces miratimi.

Finalizimi i sistemit të informacionit të kadastrës fiskale, ndërveprueshmëria e tij me sistemet e tjera, si dhe shtrirja e tij në bashki kanë qenë në rrugën e duhur. Kadastra Fiskale është një komponent i rëndësishëm i reformës për zbatimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme bazuar në vlerën e tregut. Ajo përmban të dhëna në nivel kombëtar për qëllime të llogaritjes së taksës mbi pasuritë e paluajtshme. Versioni 4.0 i Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale është zhvilluar dhe mbështet funksionalitetet e mëposhtme: (i) Regjistrimin e njërive të ndërtesave dhe të taksapaguesve; (ii) Llogaritjen e taksës; (iii) Gjenerimin e faturave të taksës së ndërtesës; (iv) Pagesën e faturës; (v) Regjistrimin e pagesave; (vi) Aplikimin e gjobave dhe kamatëvonesave; (vii) Aksesin përmes Single Sign-On (SSO); (viii) Lëshimin e vërtetimit për shlyerjen e detyrimit tatimor; (ix) Dërgimin e njoftimeve dhe faturave në “Hapësira ime” (“Mesazhet e mia” dhe “Dokumentet e mia”) në e-Albania: për çdo taksapagues me NID të vlefshëm, dërgohet një mesazh përmes e-Albania lidhur me gjenerimin e faturës, e cila mund të shkarkohet nga seksioni i dokumenteve; (x) Zbatimin e vulosjes elektronike: integrimi për vulosjen elektronike të faturave është përfunduar dhe është plotësisht funksional për të 61 bashkitë. Faturat e reja të taksës së ndërtesës vulojnë elektronikisht; (xi) Në kuadër të zhvillimeve në Sistemin Informatik të Kadastrës Fiskale dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, është realizuar integrimi me Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) për identifikimin e saktë të njërive të pasurisë, si dhe me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) për identifikimin dhe kërkimin e taksapaguesve; (xii) Sistemi Informatik të Kadastrës Fiskale (SIKF) ndërvepron me Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për qëllime të identifikimit të njërive të biznesit; (xiii) Është përfunduar integrimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për akses në të dhënat identifikuese të ndërtesave dhe parcelave, si dhe në informacionin mbi pronësinë e ndërtesave dhe parcelave; (xiv) Importimin e regjistrave vendorë për ndërtesat që përdoren për veprimtari ekonomike.

Sa i përket aktivitetit “Pilotimi, ndërtimi i kapaciteteve dhe institucionalizimi i procedurave për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme, popullimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të pasurisë së paluajtshme në SIKF.”, sistemi është zhvilluar dhe përditësuar në përputhje me nevojat dhe fazën

tranzitore për periudhën 2026–2027, dhe mbështet proceset e kërkimit, regjistrimit, llogaritjes së detyrimeve tatimore dhe gjenerimit të faturave.

Një nga përgjegjësitë kryesore të DPTP-së është asistenca e vazhdueshme për stafin e njësive të vetëqeverisjes vendore. **Me qëllim përmirësimin e proceseve për mbledhjen e taksës mbi pasurinë e paluajtshme dhe rritjen e ndërgjegjësimin të taksapaguesve**, DPTP ka ngritur një njësi “Help Desk”, e cila ka mbajtur komunikim të drejtpërdrejtë me punonjësit e bashkive për çdo sqarim apo çështje që lidhet me taksën mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe për problematikat e hasura në sistemin e Kadastrës Fiskale. Gjithashtu, DPTP ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme trajnime për stafin e NJQV-ve lidhur me funksionimin dhe përdorimin e Kadastrës Fiskale, si dhe me zbatimin uniform të kuadrit ligjor në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Për më tepër, DPTP ka përgatitur materiale informuese për të asistuar bashkitë në zbatimin uniform të kuadrit ligjor në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe për të informuar taksapaguesit për çdo paqartësi apo pyetje lidhur me taksën mbi pasurinë e paluajtshme. Këto materiale janë publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të DPTP-së.

Objektivi Specifik 3.3 Menaxhimi i Doganave

Tregursit e Performancës

Qeveria vijoi reformat në Menaxhimin Doganor, duke rezultuar në rritjen e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) dhe në përmirësimin e përdorimit të kanalit të gjelbër.

Shfrytëzimi i kanalit të gjelbër në vitin 2025 u rrit në 33.13%, krahasuar me objektivin prej 33% për atë vit. Në vitin 2024, niveli i përdorimit ishte 31%.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) pati një rritje të lehtë të kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut, e cila në përgjithësi lidhet me problematikat në kapacitetet përpunuese të sistemit IT. Koha mesatare e përpunimit të deklaratave doganore u rrit në 101 minuta në vitin 2025, krahasuar me 90 minuta në vitin 2024.

Treguesi i performancës lidhur me numrin e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar u arrit. Në vitin 2024, numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar ishte 16, si rezultat i aplikimeve të suksesshme të vazhdueshme nga operatorët ekonomikë, si dhe i inspektimeve dhe miratimeve në kohë nga grupi i punës i Doganave. Gjatë vitit 2025, dy kompani të tjera përfituan statusin OEA nga Doganat. **Numri i OEA-ve u rrit nga 16 në vitin 2024 në 18 gjatë vitit 2025.**

Masat dhe aktivitetet

Sa i përket përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve, trajnimet për punonjësit ekzistues dhe ata të rekrutuar rishtazi zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme. **Sa i përket investimit në sistemet IT për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave (SIMT)**, modulet u zhvilluan plotësisht gjatë vitit 2025. Komisioni Evropian tashmë duhet të prokurorjshërbimin e mirëmbajtjes.

DPD hartoi dhe miratoi Planin e saj të Integritetit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Gjithashtu, u miratua Regjistri i Riskut për Doganat për vitin 2025.

Aktiviteti që kontribuon në rritjen e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar ka qenë në rrugën e duhur. Aplikimet nga operatorët ekonomikë janë në vijim, ashtu si edhe inspektimet dhe miratimet nga Doganat për përfitimin e statusit OEA. Numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar u rrit në 18 në vitin 2025. Aktualisht janë pesë aplikime të reja në pritje të shqyrtimit.

Aktivitetet që kontribuojnë në zbatimin e Dritares së Vetme Kombëtare kanë qenë pjesërisht në rrugën e duhur. Sa i përket zbatimit të saj, procedura e mëparshme e prokurimit u anulua nga Banka Botërore. Banka Botërore është aktualisht në procesin e përzgjedhjes së kompanisë që do të zhvillojë sistemin informatik të Dritares së Vetme Kombëtare. Faza e përzgjedhjes ende nuk ka përfunduar dhe kompania që do të fitojë kontratën është ende në pritje të përcaktimit.

Të dy aktivitetet që kontribuojnë në përmirësimin e përdorimit të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transistit (SRKT) kanë qenë në rrugën e duhur. Me qëllim rishikimin dhe përditësimin e dispozitave ligjore për SRKT, në vitin 2020 nisi një reformë në kuadër të SRKT-së, si pjesë e projektit të mbështetur nga Banka Botërore “Shërbime Mbikëqyrjeje dhe Kontrolli të Cilësisë”¹⁷ për zbatimin e plotë të SRKT-së në Shqipëri. Konsulenti fitues u përzgjedh dhe u kontraktua nga CFCU dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Kompania përgjegjëse për zbatimin e sistemit ka instaluar ERMIS (SRKT) P5 në mjedisin e testimit, ka përfunduar ngritjen e infrastrukturës, ka zhvilluar artefaktet e nevojshme, ka krijuar llogaritë e përdoruesve dhe ka prezantuar DEMO-n në ambientet e doganës. Sa i përket termave të referencës/specifikimeve teknike për përmirësimin në fazën 6 sipas opsionit OPT-Out, ato janë përgatitur nga Njësia e Zbatimit të Projektit dhe janë miratuar nga Banka Botërore. Ministria e Financave do të nisë negociatat me kompaninë për fazën përfundimtare. Sistemi ERMIS (SRKT) P5 është instaluar në mjedisin e testimit dhe përdoruesit janë krijuar. Fillimi i SRKT P5 të përbashkët është planifikuar për datën 01.07.2027, por në fund Shqipëria duhet të përmirësojë sistemin në fazën 6.

Për zhvillim i mëtejshëm i mjedisit të TI-së të SRKT-së, Administrata Doganore Shqiptare ka ngritur një grup pune për zbatimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transistit. Ky grup përbëhet nga ekspertë të ndryshëm të fushave të ndryshme, si procedurat doganore, çështjet ligjore, garancitë, pagesat, IT-ja dhe menaxhimi i riskut.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Gjatë vitit 2025 u hasën disa sfida. Projektligji për taksën mbi pasurinë e paluajtshme parashikohet të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave brenda muajit qershor 2026. Pas miratimit të projektligjit nga Kuvendi dhe hyrjes së tij në fuqi, do të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse.

Sa i përket zbatimit të Dritares së Vetme Kombëtare, procedura e mëparshme e prokurimit u anulua nga Banka Botërore. Banka Botërore është aktualisht në procesin e përzgjedhjes së kompanisë që do të zhvillojë sistemin e informacionit të Dritares së Vetme Kombëtare. Faza e përzgjedhjes ende nuk ka përfunduar dhe kompania që do të fitojë kontratën është ende në pritje të përcaktimit.

3.4 Progresi në Shtyllën 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”

Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit ka treguar përmirësim të ndjeshëm, me shumicën e **objektivave të TP-ve** të planifikuara për vitin 2025 që janë arritur. Deri në fund të vitit **2025, 63.64%** e objektivave të treguesve të performancës për Shtyllën 4 u arritën, **27.27%** u arritën pjesërisht dhe **9.09%** nuk u arritën. Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 4.

¹⁷ Shërbime mbikëqyrjeje dhe kontrolli të cilësisë për zbatimin e plotë të SRKT-së në Shqipëri, nr. ref. WBTF-ALB-121D, datë 03.06.2022.

Tabela 5. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të shtyllës 4


Treguesi		Viti bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë				
1	Sistemi i shkëmbimit të informacionit (<i>web service</i>) i krijuar për të lehtësuar shkëmbimin e të dhënave ndërmjet MF-së, INSTAT-it dhe BSH-së	-	Zhvillimi i sistemit të shkëmbimit të informacionit (<i>web service</i>)	Sistemi jo i zhvilluar
2	Të dhëna për PPP-të dhe kontratat koncesionare përfshihen në SFQ.	-	PPP-të dhe kontratat e koncesioneve janë përfshirë në SFQ	INSTAT-i po nxjerr informacion mbi PPP-të dhe kontratat koncesionare.
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.2 Kontabiliteti				
2	Prodhimi i kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor bazuar në SNKSP sipas planit.	-	Kuadri ligjor i hartuar	Kuadri ligjor i hartuar
4	Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP	-	80%	80%
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.3 Prokurimi Publik¹⁸				
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.4 Menaxhimi i Borxhit				
1	Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit i SMB-së i përgatitur dhe publikuar	-	Dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të MF-së	Dokumenti i raportit të monitorimit të SMB përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave. Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2026 u përgatit dhe u publikua.
2	Zhvillimi i dokumentit konceptual mbi instrumentet e financimit të gjelbër/alternativë		Raporti i vlerësimit i përgatitur	Ministria e Financave është angazhuar me ministrinë e linjës për ngritjen e grupit ndërmënytor të punës.
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit				
1	Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit	88% (2022)	93%	94%
2	Zërat e detajuara të hyrjeve dhe daljeve në parashikimin e flukseve të likuiditetit të përfshira	0	2	2
3	Rritja e numrit të instrumenteve për menaxhim aktiv të likuiditetit	1	1	1
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.6 Menaxhimi i Aseteve				
1	Krijimi i kuadrit të duhur rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike.	-	Kuadri rregullator i miratuar	Kuadri rregullator i hartuar
2	Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese.	-	Hartuar	Kuadri rregullator i hartuar

Është bërë progres i kënaqshëm drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025. Shumica e aktiviteteve (60.61%) ishin ose në rrugën e duhur ose të përfunduara, 33.33% u

¹⁸ Për komponentin 4.3 Prokurimi Publik, asnjë vlerë e synuar nuk ka qënë vendosur për 2025.

vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur, ndërsa 6.06% e aktiviteteve nuk kishin nisur ende gjatë periudhës raportuese.

Grafiku 9. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në Shtyllën 4



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifik) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Treguesit e Performancës

Gjatë periudhës raportuese, nuk u alokua buxhet për ngritjen e sistemit të shkëmbimit të informacionit (Web service), që synon lehtësimin e ndarjes së të dhënave ndërmjet Ministrisë së Financave, INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë. Pavarësisht rëndësisë strategjike të kësaj nisme për forcimin e koordinimit ndër-institucional dhe mbështetjen e politikëbërjes së bazuar në evidenca, mungesa e burimeve të dedikuara financiare përbëri një pengesë të konsiderueshme. Duke njohur rëndësinë e këtij objekti, INSTAT-i ka përfshirë burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e web service-it në Programin e tij Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026–2028.

Gjatë periudhës raportuese, INSTAT-i vijoi përpjekjet për integrimin e të dhënave mbi Partneritetet Publik Privat (PPP) dhe kontratat koncesionare në Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ). Burimi kryesor i informacionit mbetet faqja e ATRAKO-s, nga e cila INSTAT nxjerr në mënyrë sistematike të dhënat përkatëse dhe i përfshin ato në sistemet e tij të brendshme për përpunim statistikor. Megjithatë, përfshirja e plotë në Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ) është në pritje të përfundimit të vlerësimeve metodologjike.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2025 u arrit progres në forcimin e Statistikave të Financave të Qeverisë (SFQ) dhe raportimit PDT, me një përafrim më të mirë me kërkesat e SELL 2010. Në këtë drejtim, cilësia, mbulimi dhe konsistenca e të dhënave u përmirësuan përmes rakordimit të zgjeruar të njësive buxhetore dhe jashtëbuxhetore, përmirësimit të rregullimeve mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe integritetit më të mirë të të dhënave burimore. Për më tepër, tabelat PDT dhe SFQ u transmetuan në kohë për raundet e njoftimit të prillit dhe tetorit, në përputhje me Programin e Transmetimit SELL 2010. Për herë të parë, në tetor 2025, seritë kohore 2021–2024 u transmetuan me statusin “*të autorizuar për publikim*”. Në dhjetor 2025, INSTAT-i paraqiti pyetësorët vjetorë mbi njësitë e kontrolluara nga qeveria, të klasifikuara jashtë sektorit të qeverisjes së përgjithshme, si dhe mbi taksat dhe kontributet shoqërore, duke mbështetur përmirësimin e transparencës dhe plotësisë së të dhënave. Zhvillimi i web service-it, i synuar për të lehtësuar shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Ministrisë së Financave, INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë, nuk u realizua, pasi buxheti i parashikuar për këtë

zhvillim në vitin 2025 nuk u miratua. Gjithashtu, raportimi i të dhënave nga Ministria e Financave mbi bazë cash dhe mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me SNKSP, është një aktivitet i kushtëzuar nga progresi më i gjerë në raportimin e të dhënave sipas standardeve SNKSP. Duke qenë se të dhënat financiare ende nuk raportohen plotësisht mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në përputhje me SNKSP, INSTAT-i nuk mbështetet në të dhëna sipas standardeve SNKSP për përpilimin e Statistikave të Financave të Qeverisë (SFQ) dhe raportimit EDP. Megjithatë, të dhënat mbi bazë cash dhe mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara përdoren bazuar në sistemin aktual në zbatim nga Ministria e Financave. INSTAT-i ka nisur procesin e mbledhjes sistematike të të dhënave mbi Partneritetet Publike-Private (PPP) dhe koncesionet. INSTAT-i po vlerëson informacionin mbi PPP-të dhe kontratat koncesionare nga burime zyrtare, përfshirë regjistrin ATRAKO. Puna është në vijim për ndërtimin e një inventari të strukturuar dhe vlerësimin e përfshirjes buxhetore dhe shpërndarjes së riskut. PPP-të dhe koncesionet ende nuk janë përfshirë në agregatët kryesorë të PDT/SFQ, në pritje të përfundimit të vlerësimit metodologjik.

Objektivi Specifik 4.2 Kontabiliteti

Treguesit e Performancës

Procesi i reformës që synon përafrimin e kontabilitetit të sektorit publik me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP), me objektivin strategjik të përgatitjes së pasqyrave financiare për institucionet e sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura, ka hyrë në një fazë kritike. Një nga objektivat kryesorë të kësaj faze të dytë të projektit është miratimi i ligjit për kontabilitetin e sektorit publik dhe i akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP, sipas planit. Gjatë vitit 2025, u arrit progres i konsiderueshëm drejt zhvillimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor të nevojshëm për këtë tranzicion. **Banka Botërore kontrakttoi konsulentë ndërkombëtarë për të mbështetur Ministrinë e Financave në hartimin e Ligjit për Kontabilitetin e Sektorit Publik.** Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DHMFKK), konsulentët përgatitën **draftin e parë të ligjit**, i cili më pas u diskutua me stafin e ministrisë për të përcaktuar strukturën dhe fushëveprimin e tij. Në qershor 2025, në ambientet e Bankës Botërore u zhvilluan një sërë takimesh, konsultimesh dhe seminaresh, me pjesëmarrjen e zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Financave dhe Nëpunësve Zbatues nga ministritë e linjës. Gjatë këtyre aktiviteteve u diskutuan sfida dhe çështje të ndryshme që lidhen me udhëzimet e kontabilitetit dhe kuadrin rregullator, së bashku me zgjidhjet më efektive për adresimin e tyre. Gjithashtu, u shqyrtua drafti paraprak i Ligjit për Kontabilitetin e Sektorit Publik. Më pas, u zhvilluan dy takime të tjera ndërmjet përfaqësuesve të DHMFKK-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe konsulentit të Bankës Botërore, ku projektligji u shqyrtua nen për nen. Projektligji i përgatitur nga konsulentët i është vënë në dispozicion nivelit drejtues të Ministrisë së Financave. Pas shqyrtimit nga niveli drejtues, ai do t'u përcillet drejtorive të tjera kryesore të ministrisë për konsultim të mëtejshëm. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, **u përgatit drafti i parë i metodologjisë së kontabilitetit të sektorit publik.** Ky dokument përshkruan të gjitha regjistrimet kontabël që lidhen me elementet e pasqyrave financiare. Projektligji për Kontabilitetin e Sektorit Publik dhe metodologjia e kontabilitetit parashikohet të miratohen brenda vitit 2026. Ngritja e kapaciteteve ka qenë një komponent qendror i agjendës së reformës SNKSP, me fokus të veçantë në **pajisjen e kontabilistëve të sektorit publik me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zbatimin e kontabilitetit mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me SNKSP.** Gjatë fazës së parë të projektit SNKSP, një nga objektivat kryesorë ishte ngritja e kapaciteteve të kontabilistëve të sektorit publik në institucionet e sektorit publik. Gjatë fazës së parë u zbatua qasja “trajnimi i trajnerëve”, me qëllim ndërtimin e një modeli të qëndrueshëm trajnimi. Në këtë kontekst, u përzgjedhën 28 ekspertë nga institucione kyçe të financave publike, përfshirë

Ministrinë e Financave, Thesarin, Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), botën akademike dhe Organizatat Profesionale të Kontabilitetit (OPK). Këta ekspertë përfunduan një program intensiv trajnimi, i cili u mbyll me një provim certifikimi më 10 dhjetor 2021. Gjithashtu, gjatë periudhës 2021–2022, për herë të parë u realizua pilotimi i trajnimit të 100 nëpunësve të financës dhe kontabilistëve nga rreth 17 institucione të ndryshme të sektorit publik. Duke u mbështetur në suksesin e pilotimit, ndërmjet muajve shtator dhe dhjetor 2022 u realizua një shtrirje më e gjerë e trajnimit, duke përfshirë rreth 400 kontabilistë të sektorit publik në institucione të ndryshme. Gjatë vitit 2024, përpjekjet për trajnim u zgjeruan duke përfshirë rreth 380 auditues të brendshëm nga sektori publik, të cilët u njohën me parimet dhe konceptet bazë të kontabilitetit mbi bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara sipas SNKSP, si pjesë e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP). Gjithashtu, në bashkëpunim me ASPA-n, në gjysmën e parë të vitit 2025 u zhvillua një trajnim online me titull “Bazat e Kontabilitetit”, me pjesëmarrjen e mbi 250 punonjësve të administratës publike. Temat kryesore të trajtuara ishin ato mbi “Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar në Sektorin Publik”. Po ashtu, në ambientet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike u zhvilluan dy trajnime me temë “Hyrje në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP)”, me pjesëmarrjen e rreth 50 punonjësve të rinj të administratës publike, të ardhur nga programet e ekselencës. Gjatë vitit 2026, përmes fazës së dytë të projektit SNKSP, trajnimi do të realizohet për të gjithë kontabilistët e sektorit publik në institucionet publike.

Masat dhe aktivitetet

Për të rritur aksesin dhe përdorimin e SIFQ-së, u nënshkrua një kontratë me titull “Përmirësimi i Sistemit të Thesarit” ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur.

Me synimin për të zhvilluar kuadrin ligjor dhe rregullator për reformat e kontabilitetit, gjatë vitit 2025 u arrit progres në vendosjen e bazave për reformat e kontabilitetit të sektorit publik, duke u fokusuar në hartimin ligjor, zhvillimin metodologjik dhe hapat përgatitorë për zbatimin. Në këtë drejtim, gjatë kësaj periudhe u finalizua një draft paraprak i Ligjit për Kontabilitetin e Sektorit Publik. Drafti u diskutua me stafin e Ministrisë për përcaktimin e strukturës dhe fushës së zbatimit të tij, si edhe me ekspertët e Bankës Botërore. Projektligji i përgatitur nga konsulentët i është vënë në dispozicion drejtuesve të lartë të Ministrisë së Financave. Pasi të shqyrtohet nga drejtuesit e Ministrisë, ai do t’u përcillet drejtorive të tjera kryesore të Ministrisë për konsultime të mëtejshme. Në bashkëpunim me konsulentët e Bankës Botërore, DHMFKK hartoi udhëzimin për “*metodologjinë e kontabilitetit të sektorit publik*”. Metodologjia e kontabilitetit është hartuar në bashkëpunim me konsulentët e Bankës Botërore dhe do të diskutohet në mënyrë praktike me kontabilistët publikë të ministrive të linjës. Aktiviteti *për të ndihmuar institucionet buxhetore në hartimin e bilanceve të hapjes dhe zbatimin e kuadrit të ri të kontabilitetit* ende nuk ka nisur. Zbatimi i tij varet nga miratimi i Ligjit për Kontabilitetin Publik dhe i udhëzimit për metodologjinë e kontabilitetit të sektorit publik. Gjatë kësaj periudhe, përmes konsulentëve të Bankës Botërore, Ministria e Financave ka mbledhur informacion lidhur me transaksionet kryesore financiare që ndodhin në ministritë e linjës.

Gjatë vitit 2025, **u përcaktuan hapat përgatitorë për përmirësimin e funksionaliteteve të SIFQ-së, në përputhje me reformat e planifikuara të kontabilitetit.** Megjithatë, zbatimi mbetet i varur nga progresi i aktivitetëve themelore. Zbatimi i aktivitetit “*Përgatitja e dokumentit të kërkesave funksionale dhe planit të përmirësimit të SIFQ-së për të absorbuar reformat e planifikuara të kontabilitetit*” varet nga ecuria e procedurës së prokurimit të kompanisë zbatuese, (lidhur me kontratën me titull “Përmirësimi i Sistemit të Thesarit”), si dhe nga progresi i projektit SNKSP. Progresi i projektit do të përcaktojë afatin kohor për testimin dhe vënien në përdorim. Gjatë vitit 2025, u ndërmorën disa hapa përgatitorë në kuadër të masës **Përgatitja, ofrimi dhe institucionalizimi i zhvillimit të kapaciteteve të kontabilistëve për të absorbuar reformat e kontabilitetit**, por progresi i saj varet nga miratimi i

ligjit për Kontabilitetin e Sektorit Publik. Megjithatë, në projektligjin për kontabilitetin në sektorin publik janë përcaktuar funksionet e metodologjisë së kontabilitetit dhe të thesarit. Gjithashtu, Ministria e Financave ka marrë disa masa për të ndryshuar dhe përshtatur strukturën përgjegjëse për metodologjinë e kontabilitetit.

Objektivi Specifik 4.3 Prokurimi Publik

Treguesit e Performancës

Nuk ka patur objektiva për Treguesit e Performancës për vitin 2025, megjithatë, ka patur progres në nivel aktiviteti, siç përshkruhet më poshtë.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2025, u arrit progres në integrimin e kriterëve të gjelbra në procedurat e prokurimit publik, me fokus në zhvillimin e mjeteve praktike dhe udhëzimeve për autoritetet kontraktore. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kanë përgatitur një draft-manual teknik me titull “*Për përdorimin e mjetit të kostos së ciklit të jetës (KCJ)*”. Ky manual shoqërohet nga një dokument shpjegues në Excel për 14 produkte të përfshira në manualin KCJ, i cili do të publikohet së shpejti në faqen zyrtare të APP-së. Objektivi i kësaj nisme është promovimi i praktikave më efikase, të qëndrueshme dhe të përafruara me BE-në në fushën e prokurimit, duke ofruar mbështetje praktike si për autoritetet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Manuali përfaqëson një hap kyç drejt përfshirjes së kriterëve mjedisore dhe të efikasitetit të kostos në vendimmarrjen për prokurimet. Në kuadër të zbatimit të mjetit të kostos së ciklit të jetës në prokurimin publik, më 5–6 maj 2025, në Hotel Plaza, Tiranë, u zhvillua një seminar teknik dyditor. Seminari u fokusua në prezantimin e manualit KCJ, demonstrimet praktike të mjetit të bazuar në Excel, si dhe diskutimet mbi aspektet ligjore, teknike dhe operacionale që lidhen me aplikimin e kostos së ciklit të jetës në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) ka kontribuar në hartimin dhe zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër përmes miratimit të Planit të Veprimit për Prokurimin e Qëndrueshëm dhe Ekonominë Qarkulluese, duke integruar kriteret mjedisore dhe sociale në procedurat e prokurimit, në përputhje me standardet e BE-së. Dokumenti mund të aksesohet në linkun përkatës

https://obp.al/wp-content/uploads/2025/09/Strategji_Prok_Qendrueshem.pdf.

Gjatë vitit 2025, u ndërmorën hapa për përmirësimin e infrastrukturës digjitale që mbështet procesin e shqyrtimit të ankesave, me fokus në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe përshpejtimin e vendimmarrjes. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), në përputhje me mandatin e tij ligjor sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së KPP-së, ka vijuar përpjekjet për dixhitalizimin e shërbimeve që lidhen me prokurimin publik, koncesionet, ankandet dhe lejet minerare. Kjo nismë është gjithashtu pjesë e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik 2025–2030 dhe fokusohet në modernizimin e sistemit elektronik të ankesave, përfshirë ngritjen e një arkivi dixhital për të gjitha dosjet elektronike të çështjeve. Për më tepër, përdorimi i vazhdueshëm i teknologjisë së nënshkrimit elektronik ka përmirësuar efikasitetin e procedurave të dorëzimit dhe shqyrtimit të dokumenteve, duke kontribuar në shkurtimin e kohës së përpunimit.

Gjatë vitit 2025, u ndërmorën hapa të rëndësishëm legjislativë për përafrimin e kuadrit kombëtar për koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP) me standardet e BE-së. Në këtë drejtim, projektligji për koncesionet dhe PPP-të përfundoi me sukses fazën e konsultimit publik më 11 qershor 2025. Pas kësaj, më 30 qershor 2025, Këshilli i Ministrave miratoi projektvendimin për përcjelljen e ligjit në Kuvend për shqyrtim të mëtejshëm. Ligji nr. 88/2025 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-

privat” u miratua në vitin 2025¹⁹. Kjo nismë legislative përfaqëson një moment të rëndësishëm në harmonizimin e kuadrit ligjor të Shqipërisë me *acquis communautaire* të BE-së, duke synuar përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në menaxhimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare.

Objektivi Specifik 4.4 Menaxhimi i Borxhit

Treguesit e Performancës

Ministria e Financave ka përgatitur **Planin Vjetor të Huamarrjes dhe Raportin e Monitorimit të SAMB-së**. Në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “*Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Ministria e Financave ka vijuar të përmbushë mandatin e saj për menaxhimin transparent dhe të përgjegjshëm të borxhit. Në mars 2025, **Raporti i Monitorimit (për vitin 2024) i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB)** u përgatit dhe iu paraqit Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Raporti u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave²⁰, duke garantuar aksesin publik dhe duke forcuar angazhimin e qeverisë për transparencë. Ky raport ofron një analizë gjithëpërfshirëse të progresit të zbatimit të SAMB-së për vitin e mëparshëm. Paralelisht, **Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2026** u përgatit dhe u publikua gjithashtu²¹, duke përcaktuar nevojat e financimit të qeverisë dhe strategjinë e huamarrjes për vitin përkatës. Ky dokument shërben si një instrument i rëndësishëm planifikimi për aktorët vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë investitorët, institucionet financiare dhe partnerët për zhvillim. Publikimi i të dy dokumenteve përfaqëson një hap pozitiv drejt forcimit të transparencës fiskale dhe përmirësimit të komunikimit me publikun dhe pjesëmarrësit e tregut.

Në korrik 2024, Ministria e Financave nisi **hartimin e dokumentit konceptual mbi instrumentet e financimit të gjelbër dhe alternativ**, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të financave publike me objektivat mjedisore dhe të qëndrueshmërisë. Një draft i parë iu shpërnda ministrive të linjës, duke propozuar ngritjen e një grupi pune ndërministror të fokusuar në tri fusha kryesore: i) identifikimin e projekteve me ndikim mjedisor dhe social; ii) hartimin e një kuadri për obligacionet e gjelbra, sociale dhe të qëndrueshmërisë për financimin e këtyre projekteve; iii) ngritjen e mekanizmave të raportimit për monitorimin e progresit të projekteve dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare gjatë gjithë ciklit të jetës së instrumenteve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ishte i vetmi institucion që dha komente mbi draftin gjatë fazës fillestare të konsultimit në gusht 2024. Bazuar në këtë kontribut, drafti u rishikua dhe iu dërgua Bankës Botërore për shqyrtim në tetor 2024. Në Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit 2026–2030, miratuar me VKM nr. 743, datë 12 dhjetor 2025, opsionet alternative të financimit që do të merren në konsideratë për periudhën në vijim janë instrumentet e tregut të brendshëm të destinuara për investitorët individualë. Instrumentet alternative të financimit, si obligacionet e gjelbra, nuk janë ende relevante. Vendimi për të përjashtuar instrumente alternative financimi, si obligacionet e gjelbra, ishte i qëllimshëm dhe i diktuar nga një rivlerësim më i gjerë i prioriteteve të financimit të qeverisë. Ky ndryshim strategjik reflekton një preferencë për forcimin e përdorimit të instrumenteve të tregut të brendshëm, të cilat aktualisht ofrojnë thellësi më të madhe të tregut, kërkesë më të parashikueshme nga investitorët dhe efikasitet më të mirë të kostos krahasuar me produktet tematike në zhvillim. Me evoluimin e kushteve të tregut, mundësia e

¹⁹ <https://app.gov.al/legjislacioni/koncesionetppp/ligji/>

²⁰ <https://financa.gov.al/strategjia-afatmesme-e-menaxhimit-te-borxhit/>

²¹ <https://financa.gov.al/plani-vjetor-i-huamarrjes/>

prezantimit të obligacioneve të gjelbra ose tematike mund të rivlerësohet, por për ciklin strategjik aktual, fokusi mbetet te konsolidimi dhe optimizimi i mekanizmave ekzistues të financimit.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2025, **përpjekjet për rritjen e transparencës dhe komunikimit me investorët u konsoliduan përmes raportimit të rregullt dhe publikimit të dokumenteve strategjike.** Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal (DPPMF) ka vijuar publikimin e buletinit informativ çdo tre muaj. Ky buletin, i cili përfshin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe zhvillimet fiskale, vihet në dispozicion në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave²² dhe gjithashtu u shpërndahet drejtpërdrejt investorëve. Kjo nismë mbështet vendimmarrjen e informuar dhe forcon besimin e investorëve në menaxhimin fiskal të Shqipërisë. Gjithashtu, Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB) për vitin 2024 u finalizua në mars 2025. Ai iu paraqit Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave²³. Ky raport ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës së portofolit të borxhit, treguesve të riskut dhe progresit kundrejt objektivave strategjikë, duke kontribuar në përmirësimin e llogaridhënies dhe vlerësimit të politikave.

Është arritur progres në zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës për dhënien e garancive dhe nënkuadrimit. Në këtë drejtim, Drejtoria e Borxhit Shtetëror ka forcuar kapacitetet e saj analitike dhe vlerësuese për risqet dhe ndikimet buxhetore që rrjedhin nga garancitë dhe nënkuadrit, përmes përdorimit të një Modeli për Vlerësimin dhe Kuantifikimin e Riskut të Kreditit, të zhvilluar nga Banka Botërore. Ky model përfshin si të dhëna sasiore (financiare), ashtu edhe tregues cilësorë (të mjedisit të biznesit), për të vlerësuar performancën dhe nivelet e riskut të Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH). Gjatë vitit 2025, Drejtoria e aplikoi këtë model për praktikën e reja të nënkuadrimit dhe garancive, duke vendosur bazat për një kuadr të konsoliduar për transaksionet e ardhshme. Mbështetja e vazhdueshme nga Banka Botërore pritet të përmirësojë më tej metodologjinë dhe të institucionalizojë procesin e vlerësimit të riskut. Gjithashtu, stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Shtetëror (DPBSH) ka nisur zbatimin e paketës metodologjike të Bankës Botërore për vlerësimin e aftësisë paguese dhe, në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, Drejtoria e Borxhit do të vijojë punën për ndërtimin e një kuadri të konsoliduar për dhënien e nënkuadrimit dhe garancive të reja.

Gjatë vitit 2025, u ndërmorën hapa paraprakë për të shqyrtuar fizibilitetin dhe gatishmërinë institucionale për prezantimin e instrumenteve alternative të financimit, përfshirë obligacionet e gjelbra, sociale dhe të qëndrueshmërisë. Në korrik 2024, Ministria e Financave qarkulloi një draft-propozim të parë për ngritjen e një grupi pune ndërmnistror, i cili do të angazhohej në këto fusha kryesore: identifikimin e projekteve me ndikim mjedisor dhe social; hartimin e një kuadri për obligacionet e gjelbra dhe të qëndrueshmërisë, që do të mundësonin financimin e projekteve potenciale; si dhe raportimin mbi progresin e këtyre projekteve me të dhënat e nevojshme, sipas standardeve të kërkuara nga institucionet ndërkombëtare deri në maturimin e instrumentit. Deri në gusht 2024, vetëm Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kishte dhënë komente. Drafti i rishikuar iu dërgua Bankës Botërore për shqyrtim në tetor 2024, por që prej asaj kohe nuk janë raportuar zhvillime të mëtejshme. Në Strategjinë e miratuar të Menaxhimit të Borxhit 2026–2030, miratuar me VKM nr. 743, datë 12 dhjetor 2025, opsionet alternative të financimit që do të merren në konsideratë për periudhën në vijim janë instrumentet e tregut të brendshëm të destinuara për investorët individualë. Instrumentet alternative të financimit, si obligacionet e gjelbra, nuk janë ende relevante. Vendimi për të përjashtuar instrumente

²² <https://financa.gov.al/buletini-makroekonomik-2/>

²³ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-i-Monitorimit-te-Strategjise-Afatmesme-te-Menaxhimit-te-Borxhit-viti-2024.pdf>

alternative financimi, si obligacionet e gjelbra, ishte i qëllimshëm dhe i diktuar nga një rivlerësim më i gjerë i prioriteteve të financimit të qeverisë. Ky ndryshim strategjik reflekton një preferencë për forcimin e përdorimit të instrumenteve të tregut të brendshëm, të cilat aktualisht ofrojnë thellësi më të madhe të tregut, kërkesë më të parashikueshme nga investitorët dhe efikasitet më të mirë të kostos krahasuar me produktet tematike në zhvillim. Me evoluimin e kushteve të tregut, mundësia e prezantimit të obligacioneve të gjelbra ose tematike mund të rivlerësohet, por për ciklin strategjik aktual, fokusi mbetet te konsolidimi dhe optimizimi i mekanizmave ekzistues të financimit. Nga Banka Botërore u zhvilluan disa sesione online, të fokusuara në kuptimin konceptual të instrumenteve të gjelbra, sociale dhe të qëndrueshmërisë. Në këto sesione mori pjesë vetëm stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Shtetëror.

Objektivi Specifik 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit

Treguesit e Performancës

Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave ruajti një nivel të lartë saktësie në parashikimin e gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (LIUTH), duke arritur një mesatare të **normës të saktësisë të parashikimit mujor të likuiditetit prej 94%**. Kjo reflekton një përafrim të fortë ndërmjet gjendjeve të parashikuara dhe atyre faktike të likuiditetit, duke treguar planifikim dhe monitorim efektiv afatshkurtër të likuiditetit. Pavarësisht disa devijimeve mujore, veçanërisht në muajin janar, ku gjendja faktike ishte ndjeshëm më e ulët se parashikimi, saktësia e përgjithshme mbeti brenda një marzhi të pranueshëm, duke dëshmuar qëndrueshmërinë e metodologjisë së parashikimit.

Është arritur progres i konsiderueshëm në **detajimin e zërave të hyrjeve dhe daljeve në parashikimin e fluksit të likuiditetit**. Deri në gjysmën e parë e vitit 2025, ana e hyrjeve të bazës së të dhënave për parashikimin e fluksit të likuiditetit është strukturuar për të përfshirë kategori të detajuara të të ardhurave, përkatësisht: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH); Tatimi mbi Fitimin; Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP); Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore; Taksat e tjera; si dhe të Ardhura Doganore dhe Jo-Tatimore (me plane për t'i ndarë këto në dy kategori të veçanta: Doganore dhe Jo-Tatimore). Për të mbështetur këtë nivel detajimi, është zbatuar një sistem dosjesh të përbashkëta, që u mundëson Administratës Tatimore dhe asaj Doganore të përditësojnë çdo ditë të dhënat mbi hyrjet, duke përmirësuar në këtë mënyrë kohën dhe saktësinë e parashikimeve.

Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave ndërmori hapa të rëndësishëm për të **rritur numrin e instrumenteve për menaxhimin aktiv të likuiditetit**, duke optimizuar përdorimin e **instrumenteve financiare** të disponueshme në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH). Zhvillimi kryesor ishte zbatimi i përllogaritjes ditore të interesit mbi **gjendjen e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (LIUTH) në lekë shqiptare (ALL)**, të mbajtur pranë Bankës së Shqipërisë. Ky ndryshim siguron një kthim më të qëndrueshëm mbi gjendjet e papërdorura dhe ul kompleksitetin operacional. Interesi i përllogaritur transferohet çdo muaj në llogarinë e Ministrisë në ditën e parë të punës të muajit pasardhës. Gjithashtu, **limiti i depozitës në lekë u rrit nga 15 miliardë në 30 miliardë, siç u formalizua përmes Marrëveshjes së rishikuar të Nivelit të Shërbimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë** (Protokolli nr. 3451, datë 7 korrik 2025). Ky rishikim, i cili ndryshon marrëveshjen fillestare të datës 20 janar 2015, zgjeron kapacitetin e Ministrisë për të menaxhuar likuiditetin në mënyrë më aktive dhe efikase.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2025, përpjekjet për përmirësimin e procesit të parashikimit të likuiditetit vijuan me hapa konkretë që synonin forcimin e saktësisë, afateve kohore dhe koordinimit institucional të parashikimeve ditore të fluksit të likuiditetit. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2025 u arrit progres i dukshëm në rishikimin e *procesit të planifikimit të thesarit*. Në bashkëpunim të ngushtë me asistencën

teknike të FMN-së, stafi i Thesarit organizoi sesione trajnimi për Institucionet Buxhetore (IB), përkatësisht gjatë periudhave 17–21 mars dhe 28–31 tetor. Këto sesione u fokusuan në përmirësimin e kapaciteteve për parashikimin ditor të fluksit të likuiditetit, duke përdorur një dosje të përbashkët makro-Excel të prezantuar rishtazi. Ky mjet mbështet një qasje nga poshtë-lart për parashikimin e hyrjeve dhe daljeve në kuadër të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (LIUTH). Hyrjet tashmë kategorizohen në bazën e të dhënave të Parashikimit të Fluksit të Likuiditeit (PFL) si më poshtë: TVSH; Tatimi mbi Fitimin; TAP; Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore; Taksat e tjera; taksat doganore dhe të Ardhetur Jo-tatimore (pjesa e mbetur). Këto kategori përditësohen çdo ditë nga administratat tatimore dhe doganore përmes dosjes së përbashkët makro-Excel. Daljet janë gjithashtu të detajuara në bazën e të dhënave PFL, duke përfshirë: Shpenzimet e Personelit; Shpenzimet Operative; Shpenzimet Kapitale; Të tjera. Kjo qasje e strukturuar dhe bashkëpunuese ka përmirësuar ndjeshëm saktësinë dhe kohën e përgatitjes së parashikimeve të fluksit të likuiditetit. *Për të institucionalizuar dhe forcuar procesin e parashikimit*, Ministria e Financave miratoi Urdhrin nr. 77, datë 29 maj 2025, së bashku me “*Rregulloren për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Teknik për Parashikimet e Fluksit të Likuiditetit (GTPFL)*”, të zhvilluar me mbështetjen e FMN-së. Takimi i parë i GTPFP-së u zhvillua më 25 shtator 2025, me pjesëmarrjen e 12 anëtarëve, përfshirë ministri të linjës, njësi të varësisë dhe Bashkinë Tiranë. Për anëtarët e GTPFL-së u krijua një dosje e përbashkët, në të cilën ata tashmë po ngarkojnë aktivisht të dhënat e tyre. Kjo nismë forcon metodologjinë nga poshtë-lart dhe lehtëson shkëmbimin në kohë reale të të dhënave ndërmjet institucioneve kyçe. Gjatë gjithë vitit 2025, të dhënat mujore të parashikimit të fluksit të likuiditetit u gjeneruan duke përdorur *mjetin Excel të zhvilluar nga FMN-ja*. Ky mjet ka rezultuar efektiv si për analizën e të dhënave, ashtu edhe për përgatitjen e parashikimeve. Pas asistencës teknike të FMN-së për përmirësimin e parashikimit të likuiditetit përmes qasjes nga poshtë-lart, të zbatuar nga institucionet anëtare të Grupit Teknik Ndërinstitucional për Parashikimin e Likuiditetit, në takimin e dytë të GTPFL-së, të mbajtur më 25 nëntor 2025, u finalizua rishpërndarja e planit të papërdorur të likuiditetit të mbetur në fund të periudhës 12-mujore të vitit 2025. **Gjatë vitit 2025, përpjekjet për prezantimin e një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit të performancës për parashikimin e likuiditetit avancuan përmes zbatimit të aktiviteteve kyçe të fokusuara në matjen e saktësisë dhe zhvillimin e treguesve.** Në këtë drejtim, Drejtoria e Thesarit ka vijuar të *masë dhe monitorojë devijimet nga parashikimet mujore të përditësuara*. Gjatë vitit 2025, norma mujore e saktësisë së parashikimit të likuiditetit arriti në 94%, duke treguar një nivel të lartë saktësie në parashikime dhe duke dëshmuar përmirësimin e përafrimit ndërmjet gjendjeve të parashikuara dhe atyre faktike të likuiditetit, si rezultat i efektivitetit të metodologjisë së parashikimit dhe të dhënave të përdorura. Ministria e Financave ka nisur rishikimin e metodologjisë për vlerësimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Si pjesë e këtij procesi, janë përcaktuar *gjashtë tregues kyç të performancës* për të vlerësuar përputhshmërinë dhe cilësinë e menaxhimit të shpenzimeve publike. Këta tregues përfshijnë ekzekutimin në kohë të angazhimeve dhe faturave, trajtimin e duhur të angazhimeve shumëvjeçare, intensitetin e shpenzimeve në fund të vitit, si dhe parashikimin dhe rishikimin e planeve mujore të likuiditetit. Treguesit e rinj të performancës u trajtuan në takimin e dytë të GTPFL-së.

Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave ndërmori hapa konkretë për forcimin e instrumenteve të menaxhimit të likuiditetit, me fokus në përmirësimin e politikës së rezervës së likuiditetit dhe optimizimin e investimit të gjendjeve të papërdorura të likuiditetit. Politika e rezervës së likuiditetit u rishikua përmes pikës 77 të udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit nr. 2, datë 24 janar 2025. Politika e përditësuar parashikon një strukturë me dy komponentë: rezervën transaksionale, të përcaktuar në nivelin 1% të PBB-së së vitit paraardhës, dhe rezervën e sigurisë, e llogaritur bazuar në detyrimet për shërbimin e borxhit për tre muajt e ardhshëm. Kjo përfshin maturimet neto të borxhit të brendshëm, kur është e aplikueshme. Niveli i përgjithshëm i rezervës përcaktohet tashmë në intervalin nga 1% deri në 2% të PBB-së së vitit fiskal paraardhës, duke forcuar qëndrueshmërinë fiskale dhe

planifikimin e likuiditetit. Instrumenti i investimit në depozita në monedhë vendase dhe të huaj përdoret në mënyrë të vazhdueshme, në varësi të gjendjes së llogarisë kryesore të qeverisë, për të ruajtur nivelin e rezervave të likuiditetit të miratuar në udhëzimin e sipërpërmendur. Në koordinim me Bankën e Shqipërisë, Ministria e Financave prezantoi një instrument të ri për menaxhimin më të mirë të likuiditetit: përlllogaritjen ditore të interesit mbi gjendjen e Llogarisë Unike të Thesarit (LIUTH) në lekë, me normën e depozitës së Bankës së Shqipërisë. Interesi i përfituar transferohet çdo muaj në llogarinë e Ministrisë në ditën e parë të punës të çdo muaji. Gjithashtu, kufiri i depozitës në lekë u rrit nga 15 miliardë në 30 miliardë, siç është formalizuar në marrëveshjen e rishikuar të nivelit të shërbimit (Protokolli nr. 3451, datë 7 korrik 2025). Këto ndryshime synojnë përmirësimin e menaxhimit të likuiditetit dhe gjenerimin e të ardhurave shtesë nga fondet e përdorura.

Objektivi Specifik 4.6 Menaxhimi i Aseteve

Treguesit e Performancës

Ngritja e një **kuadri rregullator gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike** është një komponent kyç i reformës më të gjerë që synon përafrimin e raportimit financiar të sektorit publik me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP). Ky objektivi është i përfshirë në fazën e dytë të projektit për zbatimin e SNKSP, i cili nisi zyrtarisht në vitin 2024. Gjatë vitit 2025, u angazhuan konsulentë ndërkombëtarë për të mbështetur Ministrinë e Financave në hartimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të nevojshëm për tranzicionin drejt kontabilitetit të bazuar në SNKSP. Kjo përfshin hartimin e projektligjit për Kontabilitetin e Sektorit Publik, si dhe të udhëzimeve dhe manualeve shoqëruese që do të rregullojnë trajtimin e transaksioneve financiare, përfshirë njohjen, matjen dhe raportimin e aktiveve publike. Ky tregues performance do të konsiderohet i përmbushur kur kuadri rregullator i fushës të miratohet përmes ligjit dhe metodologjisë së kontabilitetit.

Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese është një hap kritik drejt përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së raportimit financiar në sektorin publik. Objektivi përfundimtar strategjik i reformës është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura. Pas përfundimit të fazës së parë të reformës së kontabilitetit të sektorit publik në dhjetor 2022, gjatë vitit 2023 u hartua koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO. Faza e dytë e projektit nisi në vitin 2024. Një nga komponentët kyç të kësaj faze është ngritja e një kuadri ligjor dhe rregullator që do të mbështesë njohjen, vlerësimin dhe raportimin e asetëve publike. Në vitin 2025, u angazhuan konsulentë ndërkombëtarë për të asistuar në hartimin e instrumenteve të nevojshme ligjore, përfshirë Ligjin për Kontabilitetin e Sektorit Publik, si dhe udhëzimet dhe manualët që do të orientojnë transaksionet financiare dhe praktikën e menaxhimit të asetëve. Këto dokumente pritet të ofrojnë bazën për krijimin e një **regjistri të konsoliduar të asetëve**, duke u mundësuar institucioneve qendrore të mbajnë të dhëna të sakta dhe të standardizuara për asetet e tyre në nivelin e njësisë kontrolluese. Ky proces do të konsiderohet i përmbyllur kur kuadri rregullator i fushës të miratohet përmes ligjit dhe metodologjisë së kontabilitetit, dhe kur institucionet qendrore të regjistrojnë transaksionet financiare bazuar në këtë metodologji.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2025, u arrit njëfarë progresi në **forcimin e kuadrit rregullator dhe operacional për regjistrimin e asetëve**, në përputhje me kërkesat e SNKSP dhe reformën më të gjerë të kontabilitetit të sektorit publik. Në këtë drejtim, faza e dytë e projektit për zbatimin e SNKSP nisi në vitin 2024, ndërsa gjatë vitit 2025 u angazhuan konsulentët që janë në procesin e hartimit të kuadrit rregullator bazuar në SNKSP, përfshirë ligjin për kontabilitetin e sektorit publik, si dhe udhëzimet dhe manualët për

transaksionet financiare. Ky aktivitet do të konsiderohet i përmbushur kur kuadri rregullator i fushës të miratohet përmes ligjit dhe metodologjisë së kontabilitetit.

U arrit progres i konsiderueshëm në migrimin e inventarëve të aseteve të qëndrueshme në SIFQ. Një institucion migroi me sukses të dhënat e aseteve të qëndrueshme në SIFQ dhe avancoi punën për një regjistër të konsoliduar të aseteve. Në veçanti, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë finalizoi migrimin e inventarit të saj. Megjithatë, Qendra Spitalore Universitare e Tiranës, për shkak të problematikave të hasura, si mungesa e një inventari të saktë të aseteve të qëndrueshme dhe mungesa e stafit, ende nuk ka dorëzuar informacionin mbi inventarin e aktiveve të qëndrueshme për t'u migruar në SIFQ. Numri total i institucioneve me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ që kanë migruar asetet e tyre të qëndrueshme është 14. Si pjesë e projektit SNKSP, ka nisur puna për *hartimin e një regjistri të konsoliduar të aktiveve në nivel të njërive kontrolluese të institucioneve të qeverisjes qendrore*. Kjo nismë mbështetet nga konsulentët e projektit dhe është e lidhur ngushtë me zhvillimin e kuadrit rregullator të përditësuar. Regjistri i konsoliduar do të përmirësojë transparencën dhe konsistencën në raportimin e aseteve në të gjitha njësitë qeveritare.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Sfidat kryesore në të gjitha aktivitetet që lidhen me komponentin e *Llogarive Kombëtare të Qeverisë* përfshijnë mbështetjen e kufizuar buxhetore dhe mungesën e sistemeve të integruara për shkëmbimin ndërinstitucional të të dhënave. PPP-të dhe koncesionet ende nuk janë përfshirë në agregatët kryesorë të PDT/SFQ, në pritje të përfundimit të vlerësimit metodologjik. Për të vijuar më tej, është thelbësore të sigurohet financimi për infrastrukturën e web service-it, të zbatohen mekanizmat e raportimit në përputhje me SNKSP dhe të forcohet baza e të dhënave për PPP-të dhe koncesionet përmes bashkëpunimit të përmirësuar me ATRAKO-n dhe subjektet e tjera përkatëse. Puna po vijon për ndërtimin e një inventari të strukturuar dhe për vlerësimin e përfshirjes buxhetore dhe shpërndarjes së riskut. Sfidat kryesore që lidhen me komponentin e *Kontabilitetit* mbeten natyra sekuenciale e procesit të reformës, ku progresi në zbatim varet nga miratimet ligjore dhe rregullatore. Hapat e ardhshëm përfshijnë finalizimin dhe miratimin e projektligjit dhe udhëzimit, zhvillimin e konsultimeve me ministrinë e linjës dhe nisjen e përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, me qëllim përgatitjen e institucioneve për tranzicionin. Koordinimi në kohë dhe mbështetja teknike e qëndrueshme do të jenë thelbësore për të ruajtur ritmin e reformës. Një sfidë tjetër që lidhet me përmirësimin e funksionaliteteve të SIFQ qëndron në ndërvlerësinë ndërmjet komponentëve ligjorë, rregullatorë dhe teknikë të reformës. Vonesat në finalizimin e kuadrit të kontabilitetit dhe të procedurave të prokurimit kanë shtyrë përmirësimet e sistemit. Hapat e ardhshëm përfshijnë përshpejtimin e miratimit të manualeve dhe metodologjisë së kontabilitetit, si dhe nisjen e fazës së zhvillimit teknik për përafrimin e SIFQ me standardet e reja të kontabilitetit. Sfidat kryesore që lidhen me komponentin e *Menaxhimit të Borxhit* kanë të bëjnë me nivelin e ulët të përgjigjeve nga ministrinë e linjës, gjë që tregon nevojën për koordinim më të fortë ndërinstitucional dhe rritje të ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e financimit të gjelbër. Në Strategjinë e miratuar së fundmi të Menaxhimit të Borxhit 2026–2030, miratuar me VKM nr. 743, datë 12 dhjetor 2025, opsionet alternative të financimit që do të merren në konsideratë për periudhën në vijim janë instrumentet e tregut të brendshëm të destinuara për investitorët individualë. Instrumentet alternative të financimit, si obligacionet e gjelbra, nuk janë ende relevante. Sfidat kryesore në komponentin e *Menaxhimit të Likuiditetit* lidhen me forcimin e disiplinës institucionale për përditësimin ditor të të dhënave, zgjerimin e trajnimeve dhe përmirësimet metodologjike në parashikimin e fluksit të likuiditetit sipas qasjes nga poshtë-lart. Sfida të tjera përfshijnë sigurimin e takimeve të rregullta dhe të orientuara drejt rezultateve të GTPFL-së, forcimin e rolit të Komitetit të Menaxhimit të Likuiditetit dhe Borxhit në monitorimin e performancës së parashikimeve, si dhe rritjen e përdorimit të treguesve kyç të performancës dhe analizës së të dhënave të bazuar në inteligjencën artificiale për të përmirësuar saktësinë dhe vendimmarrjen. Sa i përket *Menaxhimit të Aseteve*, sfidat përfshijnë vonesat në mbledhjen

e të dhënave dhe verifikimin e inventarit, veçanërisht në institucionet me kapacitete të kufizuara administrative. Mungesa e të dhënave të sakta për asetet dhe e burimeve njerëzore ka penguar migrimin e plotë në disa raste. Hapat e ardhshëm përfshijnë finalizimin e kuadrit rregullator, përfundimin e migrimit të të dhënave të aseteve për institucionet e mbetura dhe vënien në funksion të regjistrit të konsoliduar të aseteve. Asistenca teknike e vazhdueshme dhe koordinimi institucional do të jenë thelbësore për të siguruar përputhshmërinë e plotë me SNKSP dhe përfundimin me sukses të reformës.

3.5 Progresi në Shtyllën 5 “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është profesionalizuar më tej në të gjitha Institucionet Buxhetore në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat e integritetit në BE. Deri në fund të vitit 2025, 58.33% e objektivave të TP-ve nën Shtyllën 5 janë arritur, 16.67% nuk janë arritur, dhe për 25% të objektivave, të dhënat nuk ishin të disponueshme në kohën e raportimit. Tabela e mëposhtme paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës të Shtyllës 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik.

Tabela 6. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 5


Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli				
1	Përqindja e institucioneve publike që përmbushin kërkesat e MFK-së.	69% (2022)	75%	ND
2	Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale.	68% (2022)	75%	ND
3	Ligji dhe aktet nënligjore të MFK-së janë ndryshuar dhe miratuar.	ND (2022)	Metodologjia për monitorimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme është miratuar	Metodologjia për monitorimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme është miratuar
4	Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut.	68% (2022)	75%	ND
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.2 Auditimi i Brendshëm				
1	Numri i institucioneve publike që mbulohen nga auditimet e brendshme vjetore	136	Trend rritës	155
2	Numri i institucioneve publike që kanë një komitet funksional auditimi	6	Trend rritës	10
3	Përqindja e audituesve të brendshëm aktivë që janë plotësisht të certifikuar ²⁴ .	80%	Trend rritës	76%
4	Përqindja e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC-në, në përputhje me standardet në fuqi.	52%	Trend rritës	89%
5	Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP-së.	100%	100%	100%

²⁴ Të gjithë audituesit e brendshëm duhet të certifikohen brenda 3 viteve, në përputhje me ligjin.

Objektivi Specifik (Komponenti) 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit				
1	Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit (SKKM) për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është miratuar dhe monitoruar.	-	SKKM raportuar dhe monitoruar	SKKM miratuar, raportuar dhe monitoruar
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së				
1	Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III.	-	Zbatohet paketa për marrjen e besimit IPA-III	Zbatohet paketa për marrjen e besimit IPA-III
2	Prezantohet Udhëzuesi për Përshtatjen dhe Rikuperimin (UPR) e fondeve të BE-së	-	UPR zbatohet	UPR nuk është miratuar

Progres i kënaqshëm është bërë edhe në drejtim të zbatimit dhe përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025. Shumica e aktiviteteve (76.19%) ishin në rrugën e duhur ose të përfunduara, 14.29% e aktiviteteve u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur, dhe për 9.52% të aktiviteteve, të dhënat nuk ishin të disponueshme në kohën e raportimit.

Grafiku 10. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në Shtyllën 5



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Treguesit e Performancës

Të dhënat nuk ishin të disponueshme në momentin e raportimit²⁵ për objektivat e përcaktuara në planin e veprimit për MFP 2023-2026 për treguesit: (i) Përqindja e institucioneve publike që përmbushin kërkesat e MFK-së, (ii) Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale dhe (iii) Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut.

Ndërkohë, objektivi për ndryshimin e ligjit për MFK-në dhe akteve nënligjore është arritur. Metodologjia për vlerësimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm është rishikuar dhe miratuar me Urdhrin nr. 49/1, datë 21 tetor 2025 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive të qeverisjes së përgjithshme”. Metodologjia përcakton treguesit e performancës për vlerësimin e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, përcakton procesin e vlerësimit që do të kryhet nga strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë

²⁵ Të dhënat do të jenë të disponueshme pas miratimit të raportit vjetor të KBFP-së për vitin 2025, i cili do të përgatitet deri në maj 2026.

së Financave, si dhe vendos një qasje standarde për titullarët e institucioneve gjatë monitorimit dhe përgatitjes së deklaratës vjetore mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në tërësi, kuadri i përditësuar forcon përgjegjshmërinë dhe nxit një proces vlerësimi më të strukturuar dhe të orientuar drejt performancës në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Masat dhe aktivitetet

Ministria e Financave (DHMFKK) ka vijuar të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për MFK-në. Rishikimi dhe përditësimi i akteve nënligjore, së bashku me përmirësimet në manualin e MFK-së, ka përfunduar. Urdhri nr. 49, datë 10 mars 2025, me të cilin u ngrit grupi i punës, u miratua, dhe grupi zhvilloi mbledhjen e parë për përgatitjen e draftit paraprak të metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme. Një version fillestar u dakordësua deri në mesin e muajit maj. Më pas, u zhvilluan një sërë takimesh me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, DHAB-n dhe DHMFKK-në, në bashkëpunim me një ekspert vendas të financave, me fokus zhvillimin e treguesve të rinj të performancës. Kjo çoi në finalizimin e urdhrat dhe metodologjisë për vlerësimin e performancës së njësive publike në kuadër të sistemit të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë pasaportat e detajuara të treguesve dhe një aneks të rishikuar të treguesve. Një takim për diskutimin e draftit përfundimtar u zhvillua më 17 shtator 2025 me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Sekretarin e Përgjithshëm. Më 22 shtator 2025, drafti iu përcoll ministrive të linjës për një periudhë shqyrtimi prej 15 ditësh.

Urdhri nr. 49/1, datë 21 tetor 2025, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive të qeverisjes së përgjithshme” është hartuar dhe miratuar. Kjo metodologji përcakton një qasje të strukturuar për vlerësimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme, duke u fokusuar në cilësinë, organizimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Ajo përcakton gjithashtu procesin e vlerësimit që do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ofron një kuadër metodologjik të standardizuar, që do të zbatohet nga nëpunësit autorizues gjatë monitorimit dhe raportimit vjetor mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në autoritetet qendrore, institucionet e varësisë dhe entet publike në pronësi ose nën kontrollin e tyre.

Ka patur progres në forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet publike. Aktiviteti për mbështetjen e institucioneve publike në zbatimin e rregullave të delegimit të detyrave, si vijim i kuadrit ligjor dhe rregullator të zhvilluar për MFK-në dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, ka përfunduar. Udhëzimi nr. 4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” mbetet një instrument kyç për forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale në subjektet e sektorit publik. Zbatimi i tij është ndjekur në mënyrë aktive përmes procesit të Vlerësimit të Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, i cili është kryer në 20 njësi të përzgjedhura. Në vijim të rekomandimeve të përcaktuara në Raportin e Progresit, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025 iu kushtua vëmendje e veçantë rritjes së numrit të vendimeve të delegimit dhe forcimit të kuptimit institucional të delegimit si një parim themelor i kuadrit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Ky dimension mori vëmendje të shtuar gjatë vlerësimeve të cilësisë, ku zbatimi efektiv, dokumentimi dhe aplikimi praktik i marrëveshjeve të delegimit u shqyrtuan dhe u përforcuan në mënyrë specifike.

Aktiviteti për rritjen e ndërgjegjësimit mbi përgjegjshmërinë menaxheriale dhe shpërndarjen e përvojave të drejtuesit e lartë të institucioneve publike, përmes trajnimeve dhe asistencës teknike gjatë vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm, ka përfunduar. Pas vlerësimit të cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, DHMFKK përzgjodhi pesë institucione për të përfituar asistencë teknike të dedikuar. Gjatë këtij procesi mbështetjeje, institucionet e vlerësuara si më të dobëta u asistuan në zbatimin teknik të instrumenteve të KBFP-së. Me institucionet u zhvillua një takim online, me fokus instrumentet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe zhvillimin dhe përgatitjen e tyre në përputhje me Manualin e MFK-së.

Përpyjekje gjithashtu janë bërë për forcimin e praktikave të menaxhimit të riskut. Aktiviteti për rritjen e ndërgjegjësisë dhe ofrimin e asistencës teknike mbi menaxhimin e riskut, veçanërisht për zhvillimin e instrumenteve për menaxhimin e riskut strategjik dhe operacional, ka përfunduar. Në mars 2025, me kërkesë të një institucioni publik, u zhvillua një trajnim i dedikuar mbi menaxhimin e riskut dhe delegimin e detyrave, ku morën pjesë 30 punonjës. Në prill, në bashkëpunim me ASPA-n, u organizua një sesion informues online mbi menaxhimin e riskut, me pjesëmarrjen e 56 personave, i cili përfshiu diskutime të fokusuara mbi përgjegjshmërinë menaxheriale dhe delegimin e detyrave. Gjithashtu, në qershor, u organizua një trajnim mbi MFK-në për institucionet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku u trajnuan gjithsej 17 punonjës. Në tetor 2025, u zhvillua një program trajnimi në shkallë të gjerë me temë “Roli dhe rëndësia e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe planifikimit buxhetor”, ku morën pjesë gjithsej 300 punonjës.

Ministria e Financave (DHMFKK) ka vijuar të përmirësojë vlerësimin e cilësisë dhe përmirësimin e MFK-së në institucionet publike. MF (DHMFKK) ka vijuar të përmirësojë vlerësimin e cilësisë dhe përmirësimin e MFK-së në institucionet publike. Ky është një aktivitet në vijim, i cili do të pasqyrohet në raportin vjetor të KBFP-së për vitin 2025, që pritet të miratohet deri në maj 2026.

Objektivi Specifik 5.2 Auditimi i Brendshëm

Treguesit e Performancës

Deri në fund të vitit 2025, u finalizuan gjithsej 155 raporte vjetore të auditimit të brendshëm që mbulonin institucionet publike, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm”, i ndryshuar. Nga këto institucione, 135 kishin ngritur njësi të Auditimit të Brendshëm (AB) si funksion të përhershëm, që raporton drejtpërdrejt tek Bordi ose tek Titullari i Institucionit. Ndërkohë, 20 njësi të AB-së iu nënshtruan ciklit të dytë të vlerësimit.

Që nga viti 2025, 10 institucione publike kanë ngritur Komitetet e tyre funksionale të Auditimit, nga nëntë që ishin deri në fund të vitit 2024. Aktualisht, një Komitet Auditimi është ngritur në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit. Ky numër pritet të rritet më tej me miratimin e VKM-së, e cila përcakton kriteret për njësitë publike që duhet të ngrejë një Komitet Auditimi. Kjo nismë synon të forcojë mirëqeverisjen dhe të ofrojë garanci shtesë për pavarësinë e audituesve të brendshëm.

Deri në fund të vitit 2025, përqindja e audituesve të brendshëm aktivë që janë plotësisht të certifikuar mbeti e njëjtë si në vitin 2024²⁶. Gjatë vitit 2025, DHAB vijoi punën për përditësimin e legjislacionit dytësor për auditimin e brendshëm. Procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për ciklin e vitit 2026 u hap me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 159, datë 22 dhjetor 2025. Aktualisht, 307 kandidatë kanë aplikuar për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm, nga të cilët 200 kandidatë u përzgjedhën për të vijuar procesin (126 prej tyre janë auditues të brendshëm). Në këtë proces do të angazhohen gjithashtu 9 trajnerë, të përzgjedhur nga Komiteti i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik, përmes një procedure të përcaktuar në kuadrin rregullator. Procesi i zhvillimit të moduleve të certifikimit do të nisë në prill 2026 dhe cikli i plotë i certifikimit do të përfundojë në nëntor 2026. Gjatë gjithë këtij procesi, DHAB siguron që audituesit e brendshëm të fitojnë njohuri dhe kompetenca në përputhje me Standardet Globale të

²⁶ Neni 11, shkronja “ç”: “Rekrutimi i audituesve të brendshëm” i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm”, i ndryshuar, përcakton se: “Nëpunësi civil ose punonjësi që është i punësuar në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si ‘Auditues i Brendshëm’, gjatë 3 viteve të para, punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me përvojë.”

Auditimit të Brendshëm (SGAB), etikën profesionale dhe praktikën e mira ndërkombëtare, duke rritur kështu cilësinë dhe besueshmërinë e punës audituese. Arritja e një kualifikimi më të lartë profesional, siç është certifikimi, forcon pavarësinë dhe objektivitetin e audituesve të brendshëm. Audituesit e certifikuar janë më të aftë për të identifikuar risqet, për të evidentuar dobësitë në kontrollet e brendshme dhe për të mbështetur përmirësimet në proceset organizative, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e qeverisjes dhe në menaxhimin më efektiv të riskut.

89% e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar Programet e Përmirësimit të Sigurimit të Cilësisë (PPSC), në përputhje me standardet në fuqi, duke treguar një trend në rritje. Të dhëna më të detajuara do të jenë të disponueshme pas përfundimit të Raportit Vjetor të KBFP-së për sektorin publik për vitin 2025, i cili është planifikuar të finalizohet në maj 2026.

100% e audituesve të brendshëm kanë përmbushur kërkesat për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)²⁷. Programi i Trajnimit për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik, i miratuar çdo vit nga Ministri i Financave, organizohet dhe zbatohet nga DHAB për të gjithë audituesit e brendshëm aktivë, si ata të certifikuar ashtu edhe ata të pacertifikuar. Si rezultat, në vitin 2025, të gjithë audituesit e brendshëm aktivë morën pjesë në më shumë se 40 orë trajnim profesional. Në këtë kuadër, DHAB organizoi disa aktivitete të ZHVP-së në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë:

- *Projekti i BE-së për Mirëqeverisje* i Qendrës për Reformën e Raportimit Financiar zhvilloi një program “Trajnim i Trajnerëve” për 22 auditues të brendshëm.
- Projekti i Bankës Botërore ofroi trajnim mbi “*Përmirësimin e praktikave të raportimit financiar dhe monitorimit të performancës së ndërmarrjeve shtetërore në Shqipëri*” për 27 auditues të brendshëm nga shoqëritë aksionare.
- PEMPAL IA/COP – një nismë e Bankës Botërore – zhvilloi një trajnim online mbi “*Sfidat e Njesisë Qendrore të Harmonizimit dhe auditimi në praktikë*”, me pjesëmarrjen e 227 audituesve të brendshëm
- Projekti i SECO-s për Financat Vendore zhvilloi trajnim mbi “*Auditimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në qeverisjen vendore*” për 31 auditues të brendshëm.

Masat dhe aktivitetet

Mbikëqyrja dhe zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për institucionet publike dhe ekipet e auditimit të brendshëm janë në rrugën e duhur. DHAB ka përmirësuar sistemin e menaxhimit të sigurimit të cilësisë, me qëllim garantimin e monitorimit efektiv të punës së auditimit të brendshëm në të gjitha subjektet e sektorit publik. Në Kapitullin XI të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 134, datë 17 tetor 2025, përcaktohen procedurat për kryerjen e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe metodologjia për vlerësimin e treguesve të performancës për çdo njësi të Auditimit të Brendshëm (AB). DHAB ka zbatuar Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje të plotë me SGAB-në, duke siguruar që vlerësimi i njësive të auditimit të brendshëm të kryhet në mënyrë të qëndrueshme, objektive dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë së auditimit është një komponent themelor për garantimin e profesionalizmit, efektivitetit dhe besueshmërisë së auditimit të brendshëm. Ai përfshin procedura sistematike dhe praktika të vazhdueshme vlerësimi, të hartuara për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e punës audituese, duke siguruar kështu që shërbimet e auditimit të brendshëm të ofrohen në mënyrë të qëndrueshme, të besueshme dhe të orientuar drejt përmirësimit.

²⁷ Të gjithë praktikuesit e auditimit të brendshëm në sektorin publik kanë përfunduar mbi 40 orë trajnim me pjesëmarrje fizike gjatë vitit. Zbatimi i Programit Vjetor të Trajnimit të Vazhdueshëm për audituesit e brendshëm përfshiu jo vetëm audituesit e certifikuar, por edhe stafin e rekrutuar rishtazi në njësitë e auditimit të brendshëm, të cilët ende nuk kanë marrë certifikimin (i lidhur me treguesin 3).

Lidhur me fuqizimin e kapaciteteve të Komiteteve të Auditimit përmes aktiviteteve të personalizuar të trajnimit, në vitin 2025, një anëtar komiteti, i certifikuar si Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik, ka marrë trajnime periodike për të ruajtur dhe përmirësuar kompetencën profesionale. Gjithashtu, si pjesë e programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për audituesit e brendshëm të sektorit publik në vitin 2026, do të zhvillohen sesione trajnimi të dedikuara për temat që lidhen me funksionimin efektiv të Komiteteve të Auditimit, me theks të veçantë në mbështetjen e komiteteve të sapokrijuara. Paralelisht, DHAB vijon përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit të titullarëve të institucioneve publike, me qëllim sigurimin e një kuptimi të qartë të roleve dhe përgjegjësisë të Komiteteve të Auditimit. Nismat në vijim synojnë gjithashtu profesionalizimin e mëtejshëm të praktikave kryesore të auditimit të brendshëm, përmes zhvillimit të materialeve udhëzuese dhe aktiviteteve të synuara për ngritjen e kapaciteteve.

Profesionalizimi i praktikave thelbësore të auditimit të brendshëm përmes zhvillimit të udhëzimeve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve është në rrugën e duhur. Zhvillimi i Manualit të ri të Auditimit të Brendshëm (AB) ka përfunduar dhe është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 134, datë 17 tetor 2025 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Zbatimi i tij nga audituesit e brendshëm do të fillojë më 1 janar 2026. I përafëruar plotësisht me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm, ky dokument kyç u zhvillua nga një grup pune i përbërë nga përfaqësues të DHAB-së, drejtues të njësive të auditimit të brendshëm dhe ekspertë të SIGMA-s. Manuali ofron një kuadër reference të unifikuar për audituesit e brendshëm në institucionet e sektorit publik dhe shërben si një instrument thelbësor koordinimi për të gjithë aktorët e përfshirë në mjedisin dhe metodologjinë e auditimit të brendshëm në Shqipëri.

Aktiviteti për zhvillimin dhe zbatimin e programit të Trajnimit të Trajnerëve (TT), i fokusuar në Manualin e ri të AB-së dhe SGAB, ka përfunduar. Gjatë vitit 2025, DHAB, në bashkëpunim të ngushtë me projektin e SECO-s për *Financat Vendore*, zhvilloi trajnimin mbi “*Auditimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në qeverisjen vendore*”, me pjesëmarrjen e 31 audituesve të brendshëm. Ndërkohë, aktiviteti që synon forcimin e praktikave të auditimit të përputhshmërisë ka përfunduar. Manuali i Auditimit të Brendshëm ofron udhëzime të qarta mbi raportimin e auditimit, formulimin e opinionit të auditimit për sistemet e kontrollit të brendshëm dhe paraqitjen e rekomandimeve në shkresën për nivelin drejtues. Këto tema janë trajtuar në trajnimin e zhvilluar në bashkëpunim me projektin e SECO-s “*Financat Vendore*” mbi “*Auditimin e Efektivitetit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Qeverisjen Vendore*”, me pjesëmarrjen e 31 audituesve të brendshëm. Gjithashtu, gjatë periudhës janar–shkurt 2026 u zhvilluan tre sesione trajnimi me pjesëmarrjen e 88 audituesve të brendshëm. Aktiviteti për zhvillimin e udhëzimeve dhe ofrimin e trajnimeve mbi qasjet e auditimit bazuar në risk, që lidhen me parandalimin, zbulimin ose adresimin e parregullsisë, mashtrimit dhe korrupsionit, është në rrugën e duhur. Këto tema trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe trajnime të mëtejshme do të përfshihen në aktivitetet e ZHVP-së të planifikuara për vitin 2026.

Objektivi Specifik 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit

Treguesit e Performancës

Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit (SKKM) për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025–2030, së bashku me Planin e saj të Veprimit, u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 9 maj 2025, dhe hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 23 maj 2025. Për të mbështetur zbatimin efektiv të Strategjisë, Komiteti Drejtues i SKKM-së u ngrit me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 89, datë 30 qershor 2025, dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit. Ai kryesohet nga Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA)/Zëvendësministri i Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të të

gjitha institucioneve të përfshira. Urdhri i Ministrit u është komunikuar zyrtarisht të gjitha subjekteve përkatëse për të siguruar angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e zbatimit. Më 24 shtator 2025, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik organizoi takimin e parë të Grupit Teknik të Punës dhe, së bashku me institucionet udhëheqëse, shqyrtoi instrumentet e monitorimit, proceset e raportimit dhe përgatiti planet e punës për zbatimin e masave të SKKM-së për periudhën qershor–dhjetor 2025. Gjithashtu, Komiteti Drejtues i SKKM-së zhvilloi mbledhjen e parë më 19 dhjetor 2025, ndërkohë që Drejtoria, në bashkëpunim me institucionet udhëheqëse, po harton Raportin e Monitorimit të SKKM-së për vitin 2025.

Masat dhe aktivitetet

Rritja e bashkëpunimit me auditimin e brendshëm dhe KLSH-në është në rrugën e duhur. Janë ndërmarrë hapa konkretë drejt zbatimit të një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Auditimit të Brendshëm, KLSH-së dhe Inspektimit Financiar. Dy takime të dedikuara janë zhvilluar ndërmjet Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik dhe Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, me fokus përcaktimin e modaliteteve të bashkëpunimit dhe formësimin e strukturës së Memorandumit të Mirëkuptimit. Këto diskutime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt përafrimit institucional, me synim forcimin e koordinimit dhe përmirësimin e harmonizimit të auditimit.

Koordinimi i hartimit dhe monitorimit të strategjisë kombëtare kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është në rrugën e duhur. Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian 2025–2030, së bashku me Planin e saj të Veprimit, u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 9 maj 2025, dhe hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 23 maj 2025. Sa i përket monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, Komiteti Drejtues i SKKM-së është ngritur me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 89, datë 30 qershor 2025 “*Për ngritjen e Komitetit Drejtues për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit*”. Komiteti Drejtues ka për detyrë të mbikëqyrë dhe koordinojë zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të saj të Veprimit. Ky Komitet kryesohet nga ZKA/Zëvendësministri i Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të të gjitha institucioneve të përfshira në zbatimin e Strategjisë. Urdhri i Ministrit u është komunikuar zyrtarisht të gjitha subjekteve përkatëse përmes korrespondencës zyrtare, duke siguruar informimin dhe angazhimin e tyre në procesin e zbatimit. Më 24 shtator 2025 u zhvillua takimi i parë i Grupit Teknik të Punës për zbatimin e SKKM-së, i organizuar nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik. Takimi u fokusua në identifikimin dhe diskutimin e instrumenteve ekzistuese të monitorimit, proceseve në vijim të raportimit dhe vlerësimit, si dhe hapave të ndërmarrë nga strukturat përkatëse në rolin e tyre si institucione udhëheqëse për zbatimin e SKKM-së gjatë periudhës qershor–dhjetor 2025. Institucionet udhëheqëse, në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat e tjera të përcaktuara në dokumentin strategjik, përgatitën plane pune me qëllim sigurimin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve përkatëse të Planit të Veprimit deri më 31 dhjetor 2025. Gjithashtu, më 19 dhjetor 2025 u zhvillua mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të SKKM-së, e kryesuar nga Zyrtari Kombëtar Autorizues në Ministrinë e Financave, me qëllim mbikëqyrjen e progresit në zbatimin e SKKM-së për vitin 2025. Ndërkohë, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat përkatëse udhëheqëse, është në proces të hartimit të Raportit të Monitorimit mbi zbatimin e SKKM-së për vitin 2025.

Objektivi Specifik 5.4 Menaxhimi Fondeve të BE-së

Treguesit e Performancës

Sa i përket menaxhimit të fondeve të BE-së, paketa e besimit për IPA III është zbatuar. Një arritje e rëndësishme gjatë periudhës së raportimit ishte ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë i Marrëveshjeve

të Financimit për tre Programe Operacionale shumëvjeçare (2024–2027)²⁸, me një vlerë totale prej 182 milionë eurosh. Gjithashtu, në datat 16–17 qershor 2025, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore (DG-ENEST) zhvilloi një mision auditimi vijues lidhur me procesin e besimit për Programet Operacionale të nisura në vitin 2024. Raporti përfundimtar i auditimit u dorëzua më 30 korrik 2025. Në dritën e këtyre zhvillimeve, institucionet shqiptare përgjegjëse për zbatimin e programeve IPA po ndërmarrin hapat e nevojshëm për të nisur veprimet në përputhje të plotë me detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të Partneritetit Financiar (MKPF). Këto përpjekje synojnë të sigurojnë që të gjitha strukturat IPA të funksionojnë në mënyrë efikase, transparente dhe në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe atë kombëtar.

Ndërkohë, **Udhëzuesi për Përshtatjen dhe Rikuperimin (UPR) e fondeve të BE-së ende nuk është miratuar**. Aktiviteti fillimisht ishte kërkuar të financohej përmes projektit IPA “Mbështetje për Menaxhimin e Asistencës Financiare të BE-së në Shqipëri”, për zbatim gjatë vitit 2025. Megjithatë, ai ende nuk është realizuar. Për këtë arsye, kërkesa do të ridërgohet për t’u përfshirë në planin e punës për vitin 2026.

Masat dhe aktivitetet

Lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe procedurave për menaxhimin e IPA III dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave IPA III, aktiviteti që lidhet me kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore është në rrugën e duhur. Me mbështetjen e projektit EUSFAM, u zhvillua një metodologji gjithëpërfshirëse për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim (VNT), e cila u miratua zyrtarisht nga Zyra Mbështetëse e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZM ZKA). Një pyetësor online për VNT-në u shpërnda dhe u plotësua nga 77 punonjës të 10 strukturave IPA. Gjetjet u konsoliduan në një raport të detajuar, i cili shërbeu si bazë për një plan trajnimi të strukturuar dhe me orientim drejt së ardhmes. Mbi këtë bazë, Plani i Konsoliduar i Trajnimeve për periudhën 2025–2026 u miratua nga ZKA-ja (Memo nr. 8780 prot., datë 2 qershor 2025), dhe zbatimi i tij nisi pak kohë më pas.

Që prej tetorit 2024, janë zhvilluar gjithsej 13 sesione trajnimi, secili me pjesëmarrjen e më shumë se 30 personave. Këto sesione mbuluan një gamë të gjerë temash, duke përfshirë orientimin fillestar, kuadrin ligjor, përgjegjësitë institucionale, funksionet ndërsektoriale (p.sh. menaxhimin e riskut, parregullsitë, burimet njerëzore) dhe detyrat operacionale (p.sh. opsionet e kostove të thjeshtuara, prokurimin, mbikëqyrjen). Përveç sesioneve të trajnimit, u organizuan disa seminare të synuara për të thelluar njohuritë institucionale dhe për të promovuar praktikën më të mira. Këto përfshijnë seminare për VNT-në në janar 2025, seminar për Marrëveshjen me Përfituesin Fundor (MPF) në shkurt, seminar për Menaxhimin e Riskut në mars, si dhe trajnimet mbi Udhëzuesin Praktik për procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve (PRAG) në maj. ZM ZKA organizoi gjithashtu katër seminare të fokusuara në udhëzimet e reja të OLAF-it për menaxhimin e parregullsive, si dhe një workshop të brendshëm mbi procedurën e sapoprezantuar të Treguesve Kyç të Performancës (TKP).

Lidhur me përmirësimin e procedurave të rregullimit financiar dhe/ose rikuperimit për fondet e BE-së, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe IPA III, aktivitetet janë pjesërisht në rrugën e duhur, pavarësisht se aktiviteti që lidhet me zhvillimin e moduleve të trajnimit për stafin e përfshirë në zbatimin e procedurave është në rrugën e duhur. Aktivitetet fillimisht u kërkuar dhe u planifikuan të mbuloheshin gjatë vitit 2025 në kuadër të projektit IPA “Mbështetje për Menaxhimin e Asistencës Financiare të BE-së në Shqipëri” (NEAR/TIA/2023/EA-RP/0136). Gjatë vitit, u zhvilluan

²⁸ PO “BE për Ekonominë dhe Shqipërinë Digjitale” – ratifikuar me ligjin nr. 35/2025, datë 05.06.2025; PO “BE për Eficiencën e Energjisë” – ratifikuar me ligjin nr. 36/2025, datë 05.06.2025; PO “BE për Punësimin e të Rinjve” – ratifikuar me ligjin nr. 34/2025, datë 05.06.2025.

disa takime dhe konsultime me ekipin e Asistencës Teknike (TA). Megjithatë, Udhëzuesi për Përshtatjen dhe Rikuperimin (UPR) nuk është zbatuar ende dhe, për rrjedhojë, do të riparaqitet për t'u mbuluar në kuadër të planit të punës për vitin 2026. Sa i përket moduleve të trajnimit, gjatë vitit 2025, ekipi i Asistencës Teknike EUSFAM zhvilloi një sërë trajnimesh mbi procedurat e prokurimit dhe ato financiare. Module të tjera trajnimi parashikohet të përshtaten dhe të zhvillohen më tej gjatë vitit 2026.

Lidhur me marrjen parasysh të kërkesave të ardhshme për menaxhimin e fondeve të BE-së pas anëtarësimit dhe zhvillimin e një plani veprimi, në kuadër të kapitullit 22, i cili do të përcaktojë nevojat për përmirësimin e kuadrit ligjor të menaxhimit të fondeve, informacioni nuk është i disponueshëm.

Sa i përket zhvillimit të Opsioneve të Thjeshtuara të Kostove (SCO), aktiviteti është pjesërisht në rrugën e duhur. Gjatë vitit 2025 u zhvilluan takime dhe sesione trajnimi mbi SCO-të. Megjithatë, metodologjia për SCO-të ende nuk është zhvilluar nga ekipi i Asistencës Teknike EUSFAM dhe do të vijojë të përpunohet gjatë vitit 2026.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk pati sfida kryesore, me përjashtim të aktiviteteve që lidhen me përmirësimin e procedurave të rregullimit financiar dhe rikuperimit të fondeve të BE-së, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe ato të IPA III, si dhe me zhvillimin e Opsioneve të Thjeshtuara të Kostove. Megjithatë, këto aktivitete do të prioritetizohen për t'u përfunduar gjatë vitit 2026.

3.6 Progresi në Shtyllën 6 “Mbikëqyrja e Jashtme”

Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat vazhduan të forcojnë mekanizmin e mbikëqyrjes së jashtme. Të dy institucionet po punojnë në mënyrë aktive për të përmbushur treguesit e performancës, në përputhje me planin e veprimit dhe pasaportën e treguesve. Deri në fund të vitit 2025, 66.67% e objektivave të treguesve të performancës në kuadër të Shtyllës 6 janë arritur, ndërsa 33.33% nuk janë arritur.

Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 6: Mbikëqyrja e Jashtme.

Tabela 7. Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 6

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi Specifik (Komponent) 6.1: Auditimi i Jashtëm				
1	Treguesi PEFA 30.1 Mbulimi dhe standardet e auditimit	B (2017)	A	B ²⁹
2	SIGMA Treguesi 4.3.1.5: Efektiviteti i kontrollit të autoriteteve publike nga institucionet e pavarura mbikëqyrëse (zbatimi i rekomandimeve të ISA)	4/8	5/8 ³⁰	7.22/11 ³¹

²⁹ Vlera për këtë tregues është marrë nga Vlerësimi PEFA 2024.


³⁰ Për të përcaktuar nëse treguesi është arritur, objektivi i vendosur sipas metodologjisë së vjetër (5 nga 8) fillimisht konvertohet në shkallën e metodologjisë së re (11 pikë). Vlera ekuivalente llogaritet si: $5/8 \times 11 = 6.875$. Krahasimi i këtij objektivi të konvertuar (6.875/11) me rezultatin faktik të vitit 2025 (7.22/11) tregon se performanca e tejkalon nivelin e synuar. Për rrjedhojë, treguesi konsiderohet i arritur.

³¹ Në Vlerësimin SIGMA 2024, treguesi që vlerëson efektivitetin e shqyrtimit/mbikëqyrjes së autoriteteve publike nga institucionet e pavarura të mbikëqyrjes (Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së) pësoi një ndryshim të rëndësishëm. Më parë, ai konsiderohej si nëntregues në kuadër të Treguesit 4.3.1 – “Efektiviteti i kontrollit të autoriteteve publike nga institucionet e pavarura mbikëqyrëse” dhe vlerësohej me 8 pikë, ndërsa sipas metodologjisë së re është riklasifikuar si kriter në kuadër të

3	Përgatitet dhe zbatohet udhëzimi për auditimin e institucioneve buxhetore		Udhëzimi zbatohet	Udhëzimi jo i zbatuar
4	Mjet i auditimit me ndihmën e kompjuterit (softuer) është në përdorim		Trajnimi i ofruar	Trajnimi i ofruar
5	Metodologjia e auditimit të PPP-ve dhe koncesioneve e institucionalizuar		Metodologjia zbatohet	Metodologjia zbatohet
Objektivi Specifik (Komponent) 6.2: Mbikëqyrja Parlamentare				
1	Plani zhvillimor i përgatitur dhe zbatuar.		Miraturar	Miraturar

Progres i kënaqshëm është bërë edhe në drejtim të zbatimit dhe të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025. Në përgjithësi, 83.34% aktiviteteve ishin në rrugën e duhur ose të përfunduara plotësisht dhe 16.67% nuk janë në rrugën e duhur.

Grafiku 11. Statusi për vitin 2025 të aktiviteteve në Shtyllën 6



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2025

Objektivi Specifik 6.1 Auditimi i Jashtëm

Treguesit e Performancës

Treguesi PEFA 30.1 – Mbulimi dhe standardet e auditimit nuk është arritur. Plani vjetor i auditimit, i miraturar me Vendimin e Kryetarit nr. 218, datë 15.11.2024, u zgjerua për të rritur numrin e auditimeve në të gjitha llojet. Ky zgjerim reflekton një angazhim strategjik për të forcuar mbikëqyrjen dhe për të siguruar një llogaridhënie më të gjerë institucionale. Megjithatë, sipas Raportit Përfundimtar të Vlerësimit PEFA 2024, ky tregues është vlerësuar me B. Edhe pse mbulimi i auditimit gjatë ciklit trevjeçar arrin pothuajse 100 për qind të të ardhurave dhe shpenzimeve totale, vlerësimi thekson se aktivitet dhe detyrimet nuk janë përfshirë në objektin e auditimit. Për rrjedhojë, rezultati për këtë dimension mbetet B, sa vlera bazë.

Treguesi për forcimin e efektivitetit të kontrollit të autoriteteve publike nga institucionet e pavarura mbikëqyrëse (zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit) është arritur. Pas ngritjes së Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin Publik (Vendimi nr. 70, datë 25.07.2024),

Treguesit 16.1 “Efektiviteti i kontrollit të autoriteteve publike nga institucionet e pavarura të mbikëqyrjes”, me një maksimum prej 11 pikësh.

gjatë periudhës raportuese u zhvilluan dy seanca dëgjimore. Më 11.02.2025, Nënkomisioni u informua mbi rekomandimet e KLSH-së nga auditimet e Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (2022–2023), ndërsa më 09.06.2025 u miratua raporti mbi zbatimin e rekomandimeve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe zyrat e saj vendore. Gjithashtu, KLSH i ka paraqitur dy raporte përmbledhëse mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve: një Kuvendit të Shqipërisë dhe një Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, të dyja me datë 25.02.2025. Përveç kësaj, KLSH ka nxjerrë raportin e ndjekjes mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2024. Verifikimi tregon se 99% e rekomandimeve janë pranuar. Sa i përket progresit në zbatimin e tyre, 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, janë zbatuar pjesërisht ose janë aktualisht në proces zbatimi; konkretisht, 37% janë zbatuar plotësisht, 15% janë zbatuar pjesërisht dhe 17% janë në proces. Bazuar në metodologjinë e re të SIGMA, treguesi vlerësohet me 7.22 pikë (duke reflektuar vetëm rekomandimet e dhëna në vitin 2024). Është e rëndësishme të theksohet se KLSH ka kërkuar zbatimin e plotë të masave të mbetura të pazbatuara, si dhe përshejtimin e përpjekjeve për ato që janë ende në proces.

Nuk është bërë progres i ri në përgatitjen apo zbatimin e udhëzuesit për auditimin e institucioneve buxhetore.

Treguesi për përdorimin e Teknikave të Auditimit të Ndihmuara nga Kompjuteri (CAAT) është arritur. Janë organizuar disa sesione trajnimi, kryesisht online, me pjesëmarrjen e mbi 100 audituesve. Këto sesione u fokusuan në fusha tematike kryesore, si analiza e të dhënave të mëdha, siguria e informacionit etj. Nismat e trajnimit synuan forcimin e kapaciteteve teknike të audituesve dhe promovimin e integritetit efektiv të CAAT në proceset e auditimit.

Objektivi për institucionalizimin e metodologjisë së auditimit për Partneritetet Publike Privat (PPP) dhe koncesionet është arritur. Pas miratimit të metodologjisë së auditimit të PPP-ve në dhjetor 2024, gjatë muajve korrik dhe shtator 2025 u zhvilluan disa sesione trajnimi, në kuadër të projektit SECO. Këto sesione u fokusuan në zbatimin praktik të metodologjisë së sapomiratur të auditimit për koncesionet dhe u ndoqën nga rreth 48 auditues. Metodologjia tashmë zbatohet plotësisht në të gjitha auditimet e PPP-ve dhe kontratave koncesionare. Trajnimet synuan ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe sigurimin e zbatimit të njëtrajtshëm të metodologjisë në angazhimet përkatëse të auditimit.

Masat dhe aktivitetet

KLSH ka vijuar përpjekjet për të përmirësuar kuadrin e saj ligjor, rregullator dhe fleksibël, si dhe zgjerimin e përdorimit të mjeteve të auditimit. Janë bërë përpjekje për pjesëmarrje të rregullt në vlerësime nga homologët mbi funksionimin e KLSH-së dhe zbatimin e planit të saj strategjik të zhvillimit. Pas diskutimeve të zhvilluara me partnerët strategjikë, procesi i vlerësimit nga homologët me SIGMA-n u zhvillua gjatë javës së datës 3 shkurt 2025. Në përgjigje të draft-raportit të SIGMA-s, KLSH paraqiti sugjerimet e saj në korrik 2025, duke kontribuar në dialogun e vazhdueshëm që synon përmirësimin e performancës institucionale. Proces i vlerësimit nga homologët pritet të sjellë përmirësime në metodologjinë dhe proceset e auditimit, veçanërisht në fushat e dokumentimit dhe cilësisë së auditimit. Ndërkohë, nuk ka pasur zhvillime të reja lidhur me aktivitetin për përcaktimin në Ligjin Organik të KLSH-së të dispozitave që do të forconin më tej pavarësinë dhe mandatin kushtetues të KLSH-së. KLSH ka bërë progres në forcimin e bazës për përdorimin e CAAT në lloje të ndryshme auditimesh. Janë organizuar disa sesione trajnimi, kryesisht online, me pjesëmarrjen e mbi 100 audituesve. Këto sesione u fokusuan në tema kyçe, si analiza e të dhënave të mëdha dhe siguria e informacionit, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe rritjen e ndërgjegjësisimit mbi potencialin e mjeteve të TI-së në rritjen e efektivitetit të auditimit.

Është bërë progres i konsiderueshëm në profesionalizimin e raportimit dhe komunikimit, në përputhje me strategjinë e komunikimit të KLSH-së, parimet dhe standardet përkatëse. KLSH ka bërë progres të dukshëm në zgjerimin e monitorimit, raportimit dhe komunikimit lidhur me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga subjektet e audituara. Pas ngritjes së Nënkomisionit

Parlamentar për Auditimin Publik me Vendimin nr. 70, datë 25.07.2024, u zhvilluan dy seanca dëgjimore. Më 11.02.2025, Nënkomisioni u informua mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në auditimet e kryera në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitet 2022–2023. Më pas, më 09.06.2025, u miratua raporti i Nënkomisionit “Për zbatimin e rekomandimeve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë e saj vendore për periudhën 2022–2023”. Gjithashtu, KLSH vijoi praktikën e përgatitjes së dy raporteve përmbledhëse vjetore mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Gjatë kësaj periudhe raportimi, këto raporte iu dërguan Kuvendit të Shqipërisë (Shkresa nr. 282, datë 25.02.2025) dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin (Shkresa nr. 282/1, datë 25.02.2025). Pavarësisht progresit të bërë, plani i punës ende nuk është miratuar.

Objektivi Specifik 6.2 Mbikëqyrja Parlamentare

Treguesit e Performancës

Treguesi “Plani zhvillimor i përgatitur dhe zbatuar” është arritur. Plani i Zhvillimit u hartua nga kryesia e Komisionit Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Punësimin (KEFP), në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar Demokratik (IDK). Si pjesë e procesit të përgatitjes, u zhvillua një takim i dedikuar konsultimi për të përcaktuar strukturën, prioritetet dhe rezultatet e pritshme të planit. Pas këtyre konsultimeve, versioni përfundimtar i Planit të Zhvillimit u miratua formalisht në dhjetor 2025 nga Kryetari i Komisionit. Përgatitja dhe miratimi i këtij plani reflekton një qasje të strukturuar dhe bashkëpunuese, duke siguruar që objektivat strategjikë të Komisionit të jenë të artikuluar qartë dhe të harmonizuara me nevojat për zhvillim institucional.

Masat dhe aktivitetet

Komisioni Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Punësimin ka punuar drejt profesionalizimit të strukturave të tij mbështetëse. Gjatë vitit 2025, Komisioni punoi për hartimin e Planit të Zhvillimit në bashkëpunim të ngushtë me IDK-në. Si pjesë e procesit të përgatitjes, Komisioni organizoi një takim të dedikuar konsultimi për të përcaktuar strukturën, prioritetet dhe rezultatet e pritshme të planit. Pas këtyre konsultimeve, versioni përfundimtar i Planit të Zhvillimit u miratua formalisht në dhjetor 2025 nga Kryetari i Komisionit. Përgatitja dhe miratimi i këtij plani dëshmojnë një qasje të strukturuar dhe bashkëpunuese, duke siguruar që objektivat strategjikë të Komisionit të jenë të përcaktuara qartë dhe të harmonizuara me prioritetet e zhvillimit institucional. Plani i Zhvillimit përfshin disa aktivitete kryesore, si hartimi dhe miratimi i rishikimit pasligjor të Ligjit për Akcizat në Republikën e Shqipërisë; si dhe ringritja e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 dhe riorganizimit pasues të Komisionit. Për vitin 2026, Komisioni ka planifikuar dy vizita studimore: një në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar dhe një në Senatin Italian, me qëllim përvetësimin dhe shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira. Gjithashtu, Komisioni dhe stafi i tij mbështetës morën pjesë në disa trajnime të organizuara në bashkëpunim me IDK-në dhe ekspertë ndërkombëtarë, me qëllim forcimin e njohurive të tyre në fushën e menaxhimit të financave publike.

Ndërkohë, pas miratimit të Planit të Zhvillimit, Komisioni punoi për zbatimin dhe monitorimin e tij. Në këtë kontekst, dhe në përputhje me përfundimin e ciklit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, komisionet parlamentare u riorganizuan, përfshirë ish-Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, i cili u riemërtua Komisioni Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Punësimin. Si rezultat i këtij riorganizimi, u rithemelua Nënkomisioni për Auditimin e Sektorit Publik, duke përmbushur një nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Zhvillimit.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk janë hasur sfida kryesore gjatë vitit 2025.

4 Risqet dhe hapat për adresimin e tyre

Janë materializuar disa risqe që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e Planit të Veprimit, duke përfshirë vonesat në ndryshimet ligjore dhe rregullatore, parashikimet e pamjaftueshme financiare, disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore të kualifikuara, zhvillimin jo të qëndrueshëm të kapaciteteve, sfidat në zhvillimin e sistemeve të TI-së dhe në prokurim, aksesin e kufizuar dhe jo në kohë të asistencës teknike, si dhe koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet aktorëve të përfshirë. Për të menaxhuar në mënyrë efektive reformat, dhe bazuar në përvojën gjatë periudhës 2014–2024, risqet që ndikojnë negativisht në zbatimin e Planit të Veprimit menaxhohen në mënyrë aktive.

Shtylla 1 “Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut Fiskal”. Nuk ka risqe të identifikuar apo materializuara.

Shtylla 2 “Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent”. Në fushën e Planifikimit Strategjik të Integruar, gjatë vitit 2025 u materializua risku në lidhje me zhvillimin e sistemeve TI ose sfidat e prokurimit. Sa i përket Planifikimit Strategjik të Integruar, SIPI ende nuk është operacional, duke krijuar sfida të konsiderueshme për monitorimin dhe raportimin sistematik të strategjive. Kjo rrit varësinë nga proceset manuale dhe kufizon konsistencën dhe besueshmërinë e të dhënave ndërmjet institucioneve. Lidhja ndërmjet strategjive dhe buxhetimit afatmesëm mbetet e dobët. Për shkak të mungesës së një sistemi funksional SIPI, monitorimi i objektivave strategjike dhe lidhja e tyre me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) mbetet e dobët, duke krijuar risqe për raportimin e bazuar në performancë dhe vendimmarrjen e informuar brenda kuadrit të MFP-së. Vizioni i mëtejshëm për SIMAJ është që ai të zhvillohet nga një bazë të dhënash raportuese në një platformë strategjike për vendimmarrje dhe koordinim, me integrim të plotë në sistemin kombëtar të planifikimit dhe buxhetimit, në angazhimin dhe besimin e donatorëve, kapacitetet dhe qëndrueshmërinë. SASPAC ka qenë në koordinim të vazhdueshëm me AKSHI-n për të mbështetur zhvillimin dhe operacionalizimin e Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI). SASPAC mban komunikim të rregullt me OECD/SIGMA për të forcuar lidhjet metodologjike dhe operationale ndërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Sfidat e SIMAJ u diskutuan në Konferencën e Donatorëve të organizuar nga SASPAC më 30 shtator 2025. Që SIMAJ të arrijë potencialin e tij të plotë, Shqipërisë i nevojiten ende cilësi dhe plotësi e të dhënave, koordinim ndërmjet donatorëve dhe qeverisë, si dhe funksionalitet i sistemit. Masa zbutëse për vitin 2026 është: ndjekje e plotë dhe më intensive me AKSHI-n dhe institucionet/përfituesit kombëtarë, në lidhje me mirëmbajtjen dhe zgjidhjet operationale. Në fushën e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm, u materializuan dhe ndikuan në procesin e zbatimit risqet e lidhura me vonesat në ndryshimet ligjore dhe rregullatore, krahas disponueshmërisë së pamjaftueshme të burimeve njerëzore. Pas materializimit të këtyre risqeve, u miratuan masa korrigjuese për të kufizuar efektet e tyre negative në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi. Në mënyrë të veçantë, strukturat e brendshme rritën angazhimin për të përshpejtuar ndryshimet e mbetura pezull, si dhe ndërmorën rialokime të brendshme afatshkurtra të stafit për të mbuluar funksionet thelbësore analitike dhe koordinuese. Masat zbutëse për vitin 2026 janë: rialokimi i stafit të brendshëm drejt drejtimeve prioritare të punës; përcaktimi i një afati të qartë dhe i një matrice përgjegjësie

për çdo akt ligjor, përfshirë procedurat e përshkallëzimit në rast vonese. Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve (trajnime, seminare, të mësuarit ndërmjet kolegëve) për të forcuar aftësitë analitike dhe të hartimit rregullator të stafit ekzistues. Koordinim më i strukturuar me ofruesit e asistencës teknike, duke siguruar që ekspertiza të jetë e disponueshme në kohën e duhur. Në fushën e Menaxhimit të Investimeve Publike, gjatë vitit 2025 u materializuan risqet e lidhura me zhvillimin e sistemeve TI ose sfidat e prokurimit. Masa e ndërmarrë dhe e planifikuar për adresimin e kësaj çështjeje është përmirësimi i modulit të MIP-it në SIMFSh, në bashkëpunim me Bankën Botërore (GovTech2). Sa i përket Financave Vendore, risku i materializuar lidhej me mungesën e kapaciteteve në burimet njerëzore për përdorimin e sistemit të ri për përgatitjen e PBA-së 2026-2028. Masat zbutëse përfshijnë trajnime rajonale me të gjithë drejtorët e buxhetit dhe disa drejtues të programeve, si dhe trajnime që mbulojnë të gjitha fazat e procesit të buxhetor. Në fushën e Monitorimit dhe Raportimit të Zbatimit të Buxhetit, gjatë vitit 2025 u materializuan risqet e lidhura me zhvillimin e sistemeve TI ose sfidat e prokurimit. Masa e ndërmarrë dhe e planifikuar për adresimin e kësaj çështjeje është përmirësimi i modulit të MIP-it në SIMFSh, në bashkëpunim me Bankën Botërore (GovTech2).

Shtylla 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave”. Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u përball me një nivel të ulët angazhimi të njësive të vetëqeverisjes vendore në Sistemin Informatik të Kadastrës Fiskale; ndërsa nga shqyrtimi i vendimeve të këshillave bashkiakë të paraqitura nga bashkitë, rezultoi se, në përgjithësi, bashkitë nuk kanë një kuptim të mirë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe i zbatojnë këto dispozita ligjore dhe nënligjore në mënyrë të pasaktë. Ministria e Financave nuk e dërgoi për miratim në Këshillin e Ministrave projektligjin “*Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme*”, në mënyrë që projektligji më pas t’i dërgohej Kuvendit për shqyrtim përfundimtar dhe miratim ose rrëzim.

Gjatë vitit 2025, u ndërmorën disa masa pas materializimit të risqeve. Për minimizimin e risqeve, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP) ka zhvilluar në vijimësi trajnime për stafin e njësive të vetëqeverisjes vendore; ka përgatitur dhe publikuar manuale mbi dispozitat ligjore dhe nënligjore që lidhen me taksën mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe mbi përdorimin e Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale, të cilat shërbejnë si materiale informuese dhe mjete praktike reference për njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme; ka vijuar bashkëpunimi me institucionet partnere si Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKShI), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (AShK) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC), lidhur me procesin e ndërveprimit të të dhënave dhe finalizimin e tij, me qëllim popullimin e Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale. Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 39, datë 11.02.2025, “*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit ‘Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme’*”, është ngritur një grup pune, i cili do të shqyrtojë versionin e mëparshëm të projektligjit (të hartuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe projektin “*ProTax Albania*”, të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA)), dhe do të bëjë ndryshimet e nevojshme në të, si dhe do të hartojë ndryshimet që mund të pësojë ky projektligj pas vendimmarrjes përfundimtare të Ministrisë së Financave dhe pas përfundimit të procesit të konsultimit të brendshëm me institucionet shtetërore. Ndërkohë, me qëllim përmirësimit dhe qartësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor aktual në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë hartuar ndryshime në aktet nënligjore në fuqi. Deri në fund të vitit 2025, u miratua vetëm një nga projektvendimet ndryshuese të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që projektvendimet e tjera ndryshuese ishin në proces miratimi. Risqet e përmendura mbeten relevante edhe për vitin 2026. Masat zbutëse për këtë vit përfshijnë hartimin e stimuljeve efektive për mobilizimin e pjesëmarrjes së

NjVV-ve në përdorimin e SIKF-së për gjenerimin e faturave duke filluar nga viti tatimor 2026, ofrimin e trajnimeve, vijimin e takimeve dhe diskutimeve me palët e interesit, si dhe komunikimin e reformës, rëndësisë së saj dhe qartësimin e përgjegjësive të secilës palë të interesuar. Bazuar në vendimet e niveleve më të larta vendimmarrëse brenda Ministrisë së Financave, projektligji pritët t'i paraqitet Këshillit të Ministrave për shqyrtim deri në qershor 2026. Pasi të miratohet nga Kuvendi dhe hyrjes në fuqi, procesi do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve përkatëse nënligjore. Ndërkohë, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor aktual në fushën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë hartuar ndryshime në aktet nënligjore në fuqi. Deri në fund të vitit 2025, u miratua vetëm një nga projektvendimet ndryshuese të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që projektvendimet e tjera ndryshuese ishin në proces miratimi.

Lidhur me Menaxhimin Doganor, i vetmi risk i materializuar lidhet me sfidat dhe vonesat në prokurim për SRKT dhe DVK, megjithëse prokurimi po menaxhohet nga Ministria e Financave. Në vitin 2026, koordinimi brenda institucionit dhe me partnerët do të vijojë për të siguruar planifikimin e duhur buxhetor dhe për t'u fokusuar në përfundimin në kohë të procedurave të prokurimit.

Shtylla 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”. Lidhur me këtë Shtyllë, gjatë vitit 2025 u identifikuan disa risqe. Gjatë periudhës së raportimit, disa risqe ndikuan në progresin dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me komponentin *Llogaritë Kombëtare të Qeverisë*. Mungesa e një alokimi buxhetor të miratuar për vitin 2025 çoi në parashikime të pamjaftueshme financiare, duke kufizuar drejtpërdrejt aktivitetet që kërkonin financim kombëtar. Kufizimet në burimet njerëzore ndikuan gjithashtu në performancë: përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve u penguan nga qarkullimi i stafit dhe varësia nga ekspertiza e bazuar në projekte, ndërsa disponueshmëria e kufizuar e burimeve njerëzore rriti ngarkesën e punës dhe kontribuoi në vonesat në disa produkte specifike. Për më tepër, u shfaqën sfida në koordinim, veçanërisht në harmonizimin e aktiviteteve paralele ndërmjet institucioneve, gjë që ndikoi në zbatimin e qetë të detyrave të planifikuara. Masat zbutëse të ndërmarra për të tejkaluar risqet e identifikuara lidhur me këtë komponent ishin: prioritizimi i aktiviteteve thelbësore që mund të zbatoheshin pa burime financiare kombëtare; rishikimi i kalendarit të zbatimit dhe shtyrja e aktiviteteve që kërkonin mbështetje buxhetore; shkëmbimi i brendshëm i njohurive dhe trajnimit në vendin e punës për të ruajtur njohuritë institucionale; dokumentimi i metodologjive dhe procedurave; rishpërndarja e përkohshme e detyrave dhe prioritizimi i produkteve kritike; përfundimi i procesit të rekrutimit për plotësimin e vendeve vakante ekzistuese dhe forcimin e disponueshmërisë së stafit; si dhe zhvillimi i takimeve koordinuese dhe qartësimi i roleve dhe përgjegjësive. Në këtë drejtim, masat zbutëse të planifikuara për vitin 2026 janë: përgatitja e skenarëve alternativë të zbatimit për të siguruar vijimësinë në rast të vonesave të mëtejshme në miratimin e buxhetit; integrimi më i fortë i rezultateve të trajnimeve në përsëkrimet e përhershme të punës dhe në proceset institucionale; përmirësimi i menaxhimit të ngarkesës së punës dhe prioritizimi më i qartë i aktiviteteve kryesore; si dhe forcimi i mekanizmave të koordinimit.

Lidhur me komponentët e *Menaxhimit të Borxhit* dhe *Prokurimit Publik*, gjatë vitit 2025 nuk u materializuan risqe. Risqet e identifikuara në kuadër të komponentit të *Menaxhimit të Likuiditetit* përfshinin disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore, vonesat në ndryshimet ligjore dhe rregullatore, si dhe progresin e ngadaltë në zhvillimin e sistemeve të TI-së. Ndërkohë që plotësimi i përkohshëm i vendeve vakante dhe trajnimet e synuara mbështetën zbutjen e këtyre risqeve gjatë periudhës së raportimit, për vitin 2026 janë planifikuar masa shtesë. Këto përfshijnë emërimin dhe trajnimin e stafit të ri, zgjerimin e përdorimit të mjetit të dosjes së përbashkët Makro-Excel me institucionet me buxhet më të lartë, për të siguruar përditësime ditore të flukseve të likuiditetit nga poshtë-lart, si dhe përfitim të asistencës së mëtejshme teknike nga FMN-ja për të forcuar përputhshmërinë metodologjike dhe për të përmirësuar përdorimin e CFAT-it dhe të dosjes së përbashkët për parashikimin dhe menaxhimin më të mirë të flukseve të likuiditetit. *Sa i përket*

komponentëve të Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aseteve, risqet kryesore të identifikuar gjatë vitit 2025 ishin: burimet njerëzore, përfshirë stafin, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin; organizimi i brendshëm, përfshirë menaxhimin, rolet, përgjegjësitë dhe misionet; komunikimi me palët e interesuara; partnerët e huaj, përfshirë kompanitë konsulente dhe partnerët/donatorët e huaj; sfidat në zhvillimin e sistemeve të TI-së ose në prokurim; si dhe koordinimi i përshtatshëm. Masat e ndërmarra për zbutjen e këtyre risqeve ishin: rishikimi i prioritetëve dhe planeve operacionale të punës për t'i përshtatur me burimet e disponueshme; komunikimi i vazhdueshëm për të rritur ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe menaxherëve të njëjësive publike mbi rëndësinë e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të SNKSP; ngritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të SNKSP; si dhe dërgimi i përsëritur i shkresave zyrtare dhe email-eve drejt institucioneve që ende nuk kanë dorëzuar inventarin e aktiveve të tyre afatgjata në SIFQ. Këto masa zbutëse do të ndiqen edhe gjatë vitit 2026.

Shtylla 5 “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”. Nuk u identifikuan risqe në kuadër të Komponentit 5.3. Në fushën e KBFP-së (Komponenti 5.1), risku që lidhet me disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore u materializua gjatë vitit 2025. Në janar 2025, sektori u përball me një mungesë të përkohshme për shkak të mungesës së një specialisti, boshllëk i cili u plotësua në shkurt 2025. Për më tepër, nga fundi i muajit tetor deri në fund të vitit, pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit mbeti vakant. Këto boshllëqe në staf ndikuan në përpjekjet koordinuese dhe në efikasitetin e përgjithshëm të proceseve të punës brenda sektorit. Për të siguruar vijimësinë, u ndërmorën masa të përkohshme. Stafi ekzistues rishpërndau ngarkesën e punës dhe mori përsipër përgjegjësi shtesë për të kompensuar vendet vakante, ndërsa u aplikua prioritizimi i detyrave për të garantuar realizimin në kohë të aktiviteteve kritike. Koordinimi dhe mbikëqyrja u ruajtën përmes masave të përkohshme menaxheriale, me qëllim minimizimin e vonesave dhe sigurimin e kryerjes së pandërprerë të funksioneve kyçe deri në rikthimin e plotë të kapaciteteve me staf. Për të zbutur riskun e disponueshmërisë së pamjaftueshme të burimeve njerëzore në vitin 2026, janë planifikuar masa për forcimin e qëndrueshmërisë së stafit dhe vijimësisë operacionale.

Në fushën e auditimit të brendshëm (Komponenti 5.2), janë materializuar vonesa në ndryshimet ligjore/rregullore. Për të zbutur këtë risk, është thelbësor forcimi i koordinimit ndërinstitucional, për të siguruar që të gjithë aktorët të kontribuojnë dhe të harmonizohen rreth përditësimeve të nevojshme. Hartimi i një Udhërrëfyese të qartë Rregullator do ta mbështesë më tej këtë proces, duke përcaktuar prioritetet dhe duke ofruar një afat kohor të strukturuar për miratimin e masave të nevojshme rregullore. Gjithashtu, janë evidentuar sfida në menaxhimin e fondeve të BE-së në kuadër të Komponentit 5.4, konkretisht lidhur me zhvillimin jo të qëndrueshëm të kapaciteteve të burimeve njerëzore, disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore dhe disponueshmërinë në kohë të asistencës teknike/mbështetjes. Për adresimin e këtyre çështjeve, gjatë vitit 2025 u ndërmorën masa, si kërkimi i asistencës teknike për trajnime të mëtejshme, riorganizimi i strukturës së burimeve njerëzore dhe shpallja e pozicioneve vakante në faqen e internetit të DAP-it. Për vitin 2026, masat zbutëse do të fokusohen në zbatimin e një plani të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës trajnimi, i cili mbështetet në qasjet e ndryshme të të nxëniet të zhvilluara gjatë viteve 2024–2025, krahas përgatitjes së një Politike të Mbajtjes së Stafit, për të siguruar vijimësi dhe forcim të kapaciteteve. Përveç kësaj, gjatë gjithë vitit 2025 u zhvilluan trajnime të shumta mbi procedurat e prokurimit dhe ato financiare, të organizuara nga ekipi i Asistencës Teknike (AT) EUSFAM. Modulet e trajnimit pritët të përmirësohen dhe përshtaten më tej gjatë vitit 2026. Gjatë vitit 2025 u zhvilluan gjithashtu disa takime dhe sesione trajnimi mbi SCO-të. Ndërkohë, produktet që fillimisht ishin planifikuar të përfundonin në vitin 2025, tashmë janë planifikuar të finalizohen në vitin 2026, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Asistencës Teknike.

Shtylla 6 “Mbikëqyrja e Jashtme”. Nuk janë identifikuar risqe në Shtyllën 6.

Tabela 8. Risqet kryesore të materializuara

Vlerësimi i riskut (probabiliteti dhe ndikimi):	Faktorët Kryesorë të Risqeve						
L = i Lartë							
M = i Moderuar							
U = i Ulët	Ndryshi me të vonuara ligjore/r regullatore	Siguri mi i pamjaftueshëm financiar	Zhvillimi i paqëndrueshëm i kapaciteteve të burimeve njerëzore	Disponueshmëria e pamjaftueshme e Burimeve Njerëzore	Sfidat e zhvillimit të TI-së ose prokurimit	Disponueshmëria në kohë e AT / mbështetjes	Koordinim i papërshtatshëm
Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut							
1.1 Programimi makroekonomik i matur dhe realist							
1.2 Krijimi i një analize gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë së borxhit							
1.3 Menaxhimi i risqeve fiskale							
1.4 Këshilli Fiskal							
Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent							
2.1 Planifikimi strategjik i integruar					L		
2.2 Planifikimi buxhetor afatmesëm	U			M			
2.3 Menaxhimi i investimeve publike					U		
2.4 Financat vendore			M				
2.5 Raportimi dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit					U		
Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave							
3.1 Menaxhimi i taksave							
3.2 Menaxhimi i taksës së pasurisë	M		M				
3.3 Menaxhimi doganor					L		
Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit							
4.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë	U	L	M	M	U	U	M
4.2 Kontabiliteti			M	M	L	M	U
4.3 Prokurimi publik							
4.4 Menaxhimi i borxhit							
4.5 Menaxhimi i likuiditetit	U			M	M		
4.6 Menaxhimi i asetëve	M	M	M	M	M	M	U
Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik							
5.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli				M			
5.2 Auditimi i brendshëm	U						
5.3 Inspektimi financiar publik dhe shërbimet e koordinimit kundër mashtrimit							
5.4 Menaxhimi i fondeve të BE-së			M	M		U	
Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme							
6.1 Auditimi i jashtëm							
6.2 Mbikëqyrja parlamentare							

5 Kostoja e strategjisë të MFP-së

Më poshtë është një përmbledhje e burimeve të përdorura për zbatimin e reformës gjatë vitit 2025, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilës shtyllë të kategorizuar në buxhetin e qeverisë dhe financimin e donatorëve në Euro.

Tabela 9. Burimet e përdorura për zbatimin e Strategjisë së MFP-së³²³³³⁴³⁵³⁶

Shtyllat e MFP-së	Shpenzimet faktike 2025			Vlerat në Euro	
	PBA	Financimi nga	Totali 2025	Planifikuar 2025	% e ndryshimit
Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Ris	11,000	-	11,000	17,228	-36%
1.1 Programimi makroekonomik i matur dhe realist	-	-	-	-	
1.2 Krijimi i një analize gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë së borxhit	-	-	-	-	
1.3 Menaxhimi i risqeve fiskale	11,000	-	11,000	17,228	-36%
1.4 Këshilli Fiskal	-	-	-	-	
Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent	-	285,090	285,090	300,000	-5%
2.1 Planifikimi strategjik i integruar	-	-	-	-	
2.2 Planifikimi buxhetor afatmesëm	-	24,390	24,390	25,000	-2%
2.3 Menaxhimi i investimeve publike	-	-	-	-	
2.4 Financat vendore	-	260,700	260,700	275,000	-5%
2.5 Raportimi dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit	-	-	-	-	
Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave	120,029	646,830	766,859	2,552,653	-70.0%
3.1 Menaxhimi i taksave	-	-	-	-	
3.2 Menaxhimi i taksës së pasurisë	-	642,945	642,945	-	
3.3 Menaxhimi doganor	120,029	3,885	123,914	2,552,653	-95%
Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit	-	35,000	35,000	40,000	-13%
4.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë	-	-	-	40,000	-100%
4.2 Kontabiliteti	-	35,000	35,000	-	
4.3 Prokurimi publik	-	-	-	-	
4.4 Menaxhimi i borxhit	-	-	-	-	
4.5 Menaxhimi i likuiditetit	-	-	-	-	
4.6 Menaxhimi i aseteve	-	-	-	-	
Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	-	67,000	67,000	122,000	-45%
5.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	-	-	-	-	
5.2 Auditimi i brendshëm	-	37,000	37,000	87,000	-57%
5.3 Inspektimi financiar publik dhe shërbimet e koordinimit kundër mashtrimit	-	-	-	5,000	-100%
5.4 Menaxhimi i fondeve të BE-së	-	30,000	30,000	30,000	0%
Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtëme	-	-	-	-	-
6.1 Auditimi i jashtëm	-	-	-	-	
6.2 Mbikëqyrja parlamentare	-	-	-	-	
TOTALI	131,029	1,033,920	1,164,949	3,031,881	-62%

³² Aktiviteti që përfshin monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, në kuadër të Komponentit 5.3, mbulohet plotësisht nga buxheti i shtetit.

³³ Aktivitetet në kuadër të Komponentit 5.2 “Auditimi i Brendshëm” (5.2.1.2; 5.2.1.4; 5.2.2.3; 5.2.2.4) u mbuluan plotësisht nga buxheti i shtetit.

³⁴ Aktivitetet që lidhen me hartimin e ligjit të ri për kontabilitetin publik, si dhe akteve nënligjore në kuadër të Masës “4.2.2. Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për reformat në kontabilitet” nuk ishin planifikuar fillimisht në Strategjinë e MFP-së për t’u mbuluar nga mbështetja e donatorëve. Megjithatë, gjatë zbatimit për vitin 2025, aktivitetet u financuan nga Banka Botërore në vlerën 35,000 EUR.

³⁵ Lidhur me komponentin 3.2 “Menaxhimi i Taksës së Pasurisë”, bazuar në dokumentacionin buxhetor të financuar nga SIDA, për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara, me qëllim zgjatjen e Fazës II të Fazës Fillestare të Projektit ProTax Albania deri më 31 mars 2025, si dhe zbatimin e Fazës Tranzitore të Fazës II të ProTax Albania nga 1 prilli 2025 deri më 31 dhjetor 2025, është alokuar një fond total prej 7.38 milion SEK ose 642,945 Euro. Kostot e vlerësuara janë për mbulimin e aktiviteteve të parashikuara për zgjatjen e Fazës II deri më 31 mars 2025, si dhe për Fazën Tranzitore nga 1 prilli deri më 31 dhjetor 2025, dhe reflektojnë përfshirjen e kostove të konsulencës të ofruara nga projekti për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të komponentit të Menaxhimit të Taksës së Pasurisë.

³⁶ Lidhur me Masën 3.3.5 “Përmirësimi i përdorimit të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit (SRKT)”, kostoja totale e projektit është **938,000 Euro**, e financuar nga **Banka Botërore**, dhe lidhet gjithashtu me projekte të tjera, përfshirë **SRKT**.

6 Përfundimet dhe Rekomandimet

Zbatimi i strategjisë së MFP-së - udhëhequr nga Ministria e Financave - tregon progres të kënaqshëm me pothuajse të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2025 të arritura dhe shumicën e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2025 në rrugën e duhur ose të përfunduara.

Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut

Për periudhën në vijim, konsolidimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i metodologjisë së monitorimit dhe raportimit mbi detyrimet e prapambetura do të jetë një përparësi. Në përputhje me Udhërrëfyesin për Qeverisje të Mirë, do të krijohet një këshill fiskal. Do të zhvillohet një plan i kostos për Këshillin Fiskal.

Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent

Prioritetet për periudhën në vijim përfshijnë operacionalizimin e plotë të SIPI, i cili është thelbësor për të siguruar monitorim dhe raportim të standardizuar, të integruar dhe të besueshëm të strategjive kombëtare dhe sektoriale, si dhe për të forcuar lidhjen ndërmjet planifikimit strategjik dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Në të njëjtën kohë, rekomandohet zhvillimi i mëtejshëm i SIMAJ, në mënyrë që të shndërrohet në një platformë të integruar që mbështet koordinimin e asistencës së jashtme dhe vendimmarrjen strategjike, duke përmirësuar kështu koherencën ndërmjet prioritetëve të politikave, burimeve financiare dhe rezultateve të arritura. Në fokus duhet të jetë përmirësimi dhe përditësimi i modulit të PIM-it në SIMFSH, në përputhje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887/2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. Për më tepër, duhet të zhvillohet një sistem i dedikuar informacioni për monitorimin e kontratave PPP dhe koncesionare, së bashku me trajnimin e nëpunësve civilë përgjegjës, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale, transparencës dhe llogaridhënies.

Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave

Me qëllimin e përgjithshëm për të përmirësuar të ardhurat tatimore të bashkive, konsiderohet e rëndësishme të monitorohet nga afër procesi i reformave të taksës së pasurisë dhe zbatimi i Dritares së Vetme Kombëtare.

Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit

Prioritetet kryesore për periudhën në vijim përfshijnë përmirësimin e mëtejshëm të statistikave SFQ dhe PDT në përputhje me standardet e BE-së (SELL 2010). Në këtë kontekst, për herë të parë në tetor 2025, seritë kohore 2021–2024 u transmetuan me statusin “të autorizuar për publikim”. Përdorimi i vazhdueshëm i teknologjisë së nënshkrimit elektronik ka rritur efikasitetin e procedurave të dorëzimit dhe shqyrtimit të dokumenteve, duke kontribuar në shkurtimin e kohës së përpunimit. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje shtesë për të përmirësuar efektivitetin e sistemit të shqyrtimit të ankesave, me qëllim përshpejtimin e vendimmarrjes. Prioritete të tjera të rëndësishme përfshijnë zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës për garancitë dhe huadhënien e mëtejshme, eksplorimin e instrumenteve alternative të financimit, si instrumentet e gjelbra ose sociale, si dhe forcimin e menaxhimit të likuiditetit përmes përgatitjes dhe dorëzimit të planeve të thesarit nga Institucionet Buxhetore dhe përdorimit të mjetit të ri të Excel, të zhvilluar nga FMN-ja, për parashikimin dhe analizën e të dhënave. Gjithashtu,

Për vitin 2025, ishte parashikuar një disbursim prej **450,000 Euro**; megjithatë, ai nuk u realizua për shkak të procedurave të vazhdueshme të prokurimit. Shuma prej **733,328 Euro** përfaqëson koston totale të përgjithshme që do të përfitohet nga Doganat për këtë projekt.

puna duhet të vijojë drejt miratimit të ligjit të ri për kontabilitetin publik, me qëllim prezantimin e reformave në kontabilitet, si dhe drejt përfundimit të reformave për regjistrimin e aktiveve për qëllime kontabël dhe përmirësimit të funksionaliteteve të SIFQ për të akomoduar këto reforma.

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Me legjislacionin e ndryshuar për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe për auditimin e brendshëm, tashmë të konsoliduar, prioriteti duhet të zhvendoset drejt forcimit të kapaciteteve institucionale për të siguruar zbatimin e duhur dhe përputhshmërinë e plotë me kërkesat e reja. Përpjekjet duhet të fokusohen në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të MFK-së të identifikuara përmes procesit të vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm.

